Gjorgji Jovançevski
Silvija Nikollovska

BAZAT

E

PROGRAMIMIT

TEKST PËR VITIN II
DREJTIMI ELEKTROTEKNIK

Shkup, 2023

Gjorgji Jovançevski
Silvija Nikollovska

BAZAT E PROGRAMIMIT

TEKST PËR VITIN II

DREJTIMI ELEKTROTEKNIK

Shkup, 2023

BAZAT E PROGRAMIMIT

TEKST PËR VITIN II
DREJTIMI ELEKTROTEKNIK

Autorë:
Gjorgji Jovançevski
Silvija Nikollovska

Recensentë:
Dejan Spasov
Biljana Pejovska
Viktorija Dokaza

Titulli i origjinal:
ОСНОВИ НА ПРОГРАМИРАЊЕ
УЧЕБНИК ЗА II ГОДИНА ЕЛЕКТРОТЕХНИЧКА СТРУКА
Ѓорѓи Јованчевски
Силвија Николовска

Përkthyer nga gjuha maqedonase: Muzafer Beqiri

Redaktor profesional i botimit në gjuhën shqipe: Xhevair Beqiri

Lektor: Refail Sulejmani

REDAKTOR:
Refail Sulejmani

REDAKTIMI GRAFIK DHE TEKNIK:
Magdalena Avramovska, Evgenija Pavllova - ARS STUDIO

Botues: MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS EREPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Rr. "Shën Kirili dhe Metodi" nr. 54, 1000 Shkup

Vendi dhe viti i botimit: Shkup, 2023

Me vendimin nr 26-548/1 prej dates 19.08.2022 të komisionit nacional për tekste, lejohet përdorimi i këtij

CIP:

PËRMAJTJA

Hyrje

Ky tekst paraqet kurs fillestar për mësimin e programimit. Ai është konceptuar t'i përfshin bazat e të shprehurit algoritmik të problemeve, nëpërmjet pseudo-gjuhës në maqedonisht, si edhe kodimin e algoritmeve në gjuhën programore C++.

Teksti është përafruar me Programin arsimor për lëndën „Bazat e programimit", për vitin II drejtimi elektroteknik. Ai është shkruar sipas programit modular për këtë lëndë, qëpërbëhet prej tre njësive modulare.

Në njësinë e parë modulare „Hyrje në gjuhën programore C++", nxënësi njihet me algoritmet dhe të shprehurit e tyre tekstuale dhe grafike, me gjuhët programore dhe rrethinat për programim. Më tutje, njihet me elementet themelore të gjuhës C++, sikurse: ndryshore, lloj i të dhënave, urdhëra për lexim dhe shtypje dhe struktura e programit te gjuha C++.

Te njësia modulare e dytë „Kontrolli i rrjedhjes dhe funksioneve në C++", janë sqaruar strukturat kontrolluese algoritmike për kontrollin e rrjedhjes së realizimit të algoritmeve: strukturat kontrolluese për zgjedhje dhe strukturat kontrolluese për përsëritje. Ato janë të mjaftueshme për të shprehur çdo algoritëm dhe të kontrollohet rrjedhja e realizimit të tij. Implementimi i tyre është sqaruar dhe ilustruar nëpërmjet urdhërave kontrolluese përkatëse në gjuhën programore C++. Gjithashtu, në këtë njësi modulare, janë përpunuar nënalgoritmet, si edhe implementimi përkatës me funksione te gjuha C++. Janë përpunuar funksionet e bibliotekës në C++, por vëmendja më e madhe është përkushtimi të funksioneve përdoruese të përkufizuara.

Te njësia e tretë modulare „Llojet e përbëra të të dhënave në C++", nxënësi futet në shfrytëzimin e vargjeve numrike, të treguesve dhe të stringeve gjatë programimit në C++.

Mendojmë se materijali i parashtruar është i mjaftueshëm për çd nxënës fillestar në programim, por përvetësimi i tij nuk është i vështirë pasi tentuam ta parashtrojmë në mënyrë të lehtë dhe të kapshëm, me shumë shembuj, ushtrime dhe detyra të zgjidhura. Pas çdo njësia mësimre, janë parashtruar pyetje për kontroll të njohurive dhe detyra për zgjidhje të pavaur.

Autorët

Vërejtje: *Në bashkëpunim me lektorin, autorët u përpoqën ta shprehim në gjuhë maqedone disa terma informatike, por edhe terma prej gjuhës programore C++. Ato, ndoshta, do të tingëllojnë jo të zakonshme për disa lexues, por mendojmë se është koha e fundit të punohet në problemin e përdorimit të termave informatike në gjuhën maqedone.*

Konkretisht, për shkak të specifikave të kësaj gjuhe programore, por edhe të gjuhës që përdoret në informatikë te ne, në përgjithësi, terme të caktuara vetëm janë transkriptuar në gjuhën maqedone. Te teksti respektohet mendimi i autorëve se disa koncepte, për shkak të shumë domethënies së tyre, në këtë gjuhë programore duhet të shkruhen në formë e cila nuk korrespondon me rregullat për përdorimin e tyre në gjuhën maqedonase.

MODULI

HYRJE NË GJUHËN PROGRAMORE C++

1

Në këtë kapitull do të njiheni me këtë:

- Programi, programimi dhe gjuha programore.
- Softueri dhe ndarja e tij.
- Algoritmi, hapat algoritmike, algoritme të përgjithshme dhe detale.
- Paraqitja e algoritmeve.
- Programimi strukturor.
- Pseudo-gjuhë, bllok-diagrame, program burimor dhe programi i ekzekutushëm.
- Rrethina integruese zhvillimore për C++.
- Historia e C++.
- Elementet e gjuhës C++.
- Madhësitë, të dhënat, konstantat, ndryshoret dhe lloj i ndryshores.
- Lloj i të dhënës.
- Formatet për paraqitjen e numrave dhjetorë.
- Riemërtimi i llojit, caktimi automatik i llojit.
- Leximi dhe shtypja e të dhënave.

Fjalët kyçe

bool	Gjykimi
char	Fjalë kyçe
cin	Kodimi
Code::Blocks	Koment
cout	Programi përdorues
double	Literal
endl	Shprehje logjike
enum	Gjuhë logjike
enum	Operator logjik
float	Lloj logjik i të dhënës
int	Gjuha makinerike
iomanip	Gjuhë makinerike e pavarur
iostream	Programimi modular
istream	Lloj i numërueshëm i të dhënës
long	Dhëmbëzimi
long double	Pika e palëvizshme
long long	Lloj i pastrukturuar i të dhënës
Microsoft Visual Studio	Gjuhë objekti i orientuar
namespace	Operatori për dekreminim −−
ostream	Operatori për inkrementim ++
return	Operatori me bit
short	Operatori për futje (insertim)
string	Operatori për ndarje (ekstrahim)
Unified Modeling Languge – UML	Algoritmi i përgjithshëm
unsigned char	Lloj themelor i të dhënës
unsigned int	Lidhës
unsigned long	E dhëna
unsigned long long	Pika lëvizëse
unsigned short	Përkthyes (kompajler)
Caktimi automatik i llojit	Riemërtimi i llojit të të dhënës
Lloj i adresës të dhënës	Mbushje
Algoritmi	Gjuha e orientuar problemore
Struktura kontrolluese algoritmike	Programimi prej lart poshtë
Hapi algoritmik	Gjuha programore

Programi aplikativ	Ndryshorja
Aplikimi	Lloj i thjeshtë i të dhënës
Asembler	Gjuhë procedurale programore
Bllok-diagram	Pseudo-gjuhë
Funksionet e Bulit	Lloj real i të dhënës
Lloj i ndërtuar i të dhënës	Struktura kontrolluese rendore (sekuenca)
Madhësia	Fjala e rezervuar
Gjuha programore e lartë	Operatori i relacionit
Përrua hyrëse e të dhënave	Biblioteka standard e C++
Funksioni kryesor	Semantika e gjuhës programore
Gramatika e gjuhës programore	Gjuha simbolike
Gjuhë programore deklarative	Sintaksa e gjuhës programore
Ndryshorja deklarative	Programe sistemore
Algoritëm detal	Forma e shkurtër e operatorit (operatori i përbërë)
Përkufizimimi i ndryshores	Gjuhë skripte
Diabager	Lloj i përbërë i të dhënës
Konversioni i llojit eksplicit (hedhja e llojit)	Softuer
Shenja për vijë të re	Specifikator i llojit
Lloj i shenjës të të dhënës	Lidhja e stringeve
Identifikator	String
Programi burimor	Lloj i strukturuar i të dhënës
Programi i ekzekutueshëm	Programimi i strukturuar
Përrua dalëse e të dhënave	E dhëna tekstuale
Sekuenca dalëse (eskejp)	Redaktor tekstual editor
Konstanta e emërtuar	Lloj
Gjuha programore imperative	Funksioni
Konversioni implicit (lloj i detyrimit)	Gjuha funksionale
Inicializimi i ndryshores	Heder - datoteka
Integrimi i rrethinës zhvillimore	Lloj numër i plotë i të dhënës
Interpretaor	

1.1 Programet

Kompjuteri nuk është i aftë për asnjë punë të pavarur. Që të mund kompjuteri të realizojë çfarëdo pune, është e nevojshme t'i jepen urdhëresa përkatëse me të cilat aktivizohet dhe realizohet ndonjë **program** (angl. program). Nëse programi është drejt i shkruar, kompjuteri do ta realizojë dhe do të jep rezultatet përkatëse.

Puna e përgjithshme e kompjuterit realizohet nën kontrollin e veçantë të ashtuquajtur **programe sistemore** (angl. sistem programs), të cilët mund të ndahen në tre grupe:

- **Sisteme operative** (angl. operating sistems).
- **Programe kontrolluese** (angl. control programs).
- **Programe shërbyese** (angl. utility programs).

Programet të cilat realizojnë punë të caktuara për shfrytëzuesit quhen **programe aplikative** (angl. application programs) ose **programe përdoruese** (angl. user programs).

Të gjitha programet aplikative të cilat i kemi në kompjuterin tone zgjidhin detyra të caktuara, përkatësisht me ato realizojmë punë të caktuar. Për shembull, programe aplikative të njohura prej pakos Microsoft Office: MS Word, MS Excel, MS PowerPoint etj.

Të gjitha programet të cilët mund t'i realizojë kompjuteri, me një emër quhen **softuer** (angl. software). ***Te figura 1.1.1*** është dhënë një ndarje e mundshme e softuerit.



Figura 1.1.1

Programi[1] paraqet tekst të cilin kompjuteri mund ta kupton dhe realizon. Programet shkruhen në ndonjë **gjuhë programore** (angl. programming language), që shërben komunikimi ndërmjet njeriut dhe kompjuterit. Programet shkruhen me urdhëra që kompjuteri t'i „kuptojë" dhe, më tutje, t'i realizojë veprimet të cilat janë „treguar" me ato urdhëra.

Programet mund të redaktohet (shkruhen dhe ndryshojnë) me ndonjë redaktues të tekstit, të mbahen mend si datoteka dhe të realizohen.

Të shkruarit e programit është proces të quajtur **programim** (angl. programming), por njerëzit që i shkruajnë programet (programojnë) quhen **programues** (angl. programuess).

1.2 Algoritmet

Çdo njeri e di saktë çka duhet të bëjë kur duhet të ziejë kafe, të përgatitë ushqim të caktuar, të vozitë automobil, të instalojë program në kompjuter, ta përgatitë çantën për ditën e ardhshme etj.

Aktivitetet njerëzore, në pjesën më të madhe, mund të realizohen si renditje të numrit të caktuar të aktiviteteve të vogla (elementare), d.m.th., aktivitetet për të cilat nuk është i nevojshëm sqarim për të qenë të realizuara.

Për shembull, aktivitet elementare gjatë zierjes së kafes mund të jenë:

- Vendosja e ujit në xhezve.
- Futja kafe në xhezve.
- Vendosja e xhezves te shporeti.
- Kyçja e shporetit ku është venduar xhezvja.
- Pritja që kafja të vlon.
- Hekja e xhezves prej shpretit.
- Çkyçja e shpretit.

Që një realizues (sikurse ai që përgatit kafe) të mund të kryejë aktivitet të dhënë (zierja e kafes), ai duhet të dijë aktivitete elementare dhe mënyra (renditja) e realizimeve të tyre. Vargu i atillë prej aktiviteteve elementare quhet mënyra ose **algoritëm** (angl. algorithm).

Mund të themi se:

algoritmi është mënyrë prej numrit të fundshëm në mënyrë rigoroze të përkufizuar të aktiviteteve dhe saktë të dhënë renditja e realizimeve të tyre.

Konceptin algoritëm do ta sqarojmë më detalisht te shembulli për gjetjen e numrit më të madh prej tre numrave, me këtë mënyrë:

- Krahasimi të çfarëdo qoftë dy numra dhe caktimi i numrit më të madh të tyre.
- Krahasimi i numrit më të madh prej krahasimit të parë me numrin e tretë dhe caktimi i më të madhit prej tyre.

[1] Një program i shkruar në gjuhën programore C++ është dhënë te ***figura 1.3.4.***

Numri më i madh prej krahasimit të dytë është numri më i madh prej tre numrave.

Është e qartë se mënyra përbëhet prej vetëm dy aktivitete saktë të përkufizuara.

Për t'u zbatuar kjo mënyrë mbi çfarëdo tre numra, është e nevojshme ato të jenë të dhënë paraprakisht. Rezultati prej mënyrës është numri më i madh. Kjo do të thotë se zgjidhja e ndonjë detyre qëndron në caktimin e *rezultateve dalëse* me zbatimin e mënyrës së caktuar – algoritmi në bazë të *të dhënave hyrëse.*

Prandaj, mund të thuhet se:

algoritëm ***është mënyrë prej numrit të fundshëm në mënyrë rigoroze veprime të përkufizuara aktivitete, të zbatuara mbi të dhënat hyrëse sipas renditje rigoroze të shkruar, me të cilat arrihen rezultatet dalëse.***

Fjala *algoritëm* është marrë prej gjuhës latine dhe paraqet përkthim latin të mbiemrit Al–Khwarizmi të matematikanit arab të shekullit IX Abu Ja'far Muhammad ibn Musa al–Khwarizmi, i cili i pari i ka formuluar rregullat për realizimin e katër operacioneve me shifra arabe.

Hapat algoritmike

Veprimet prej të cilave përbëhet një algoritëm quhen **hapa algoritmike** (angl. algorithms steps). Varësisht prej asaj se hapat a janë më të përgjithshme ose më detale, algoritmi mund të jetë **i përgjithshëm** ose **detal**.

Për shembull. Algoritmi i përgjithshëm për detyrën prej pikës paraprake (caktimi i numrit më të madh prej tre numrave të dhënë), mund ta shkruajmë si te ***figura 1.2.1.***

hapi 1: Dhënia e tre numrave.
hapi 2: Krahasimi i çfarëdo dy numrave dhe gjetja e më të madhit prej tyre.
hapi 3: Krahasimi i numrit më të madh i gjetur në hapin 2 me numrin e tretë dhe gjetja e më të madhit prej tyre.
hapi 4: Shtypja e rezultatit.

Figura 1.2.1

Nëse i shënojmë numrat me a, b dhe c, më i madhi prej a dhe b me p, por më i madhi prej p dhe c me n, atëherë mund të shkruajmë algoritëm më detal, si te ***figura 1.2.2.***

hapi 1: Dhënia e numrave a, b dhe c.
hapi 2: Nëse a është më i madh se b, atëherë p = a, përndryshe p = b.
hapi 3: Nëse p është më i madh se c, atëherë n = p, përndryshe n = c.
hapi 4: Shtypja e n.

Figura 1.2.2.

Treguam se në çdo algoritëm ka të dhëna hyrëse dhe rezultate dalëse. Rezultatet dalëse fitohen me „transformimin" e të dhënave hyrëse gjatë realizimit të algoritmit hap pas hapi.

Poashtu, ai transformim nuk kryhet gjithmonë direkt, por me ndihmën e **ndërmjet rezultateve**. Kështu, te algoritmi i sipërm ndërmjet rezultat është p, të dhëna hyrëse janë a, b dhe c, por rezultat dalës është n.

Për ta kontrolluar korrektësinë e algoritmit, kryhet testimi mbi çfarëdo të dhëna hyrëse. Për shembull, ta testojmë algoritmin për numrat: a = 37, b = 12, c = 44.

hapi 1: a = 37, b = 12, c = 44.
hapi 2: a (= 37) është më i madh se b (= 12), atëherë p = a (= 37).
hapi 3: p (= 37) nuk është më i madh se c (= 44), pasi n = c (= 44).
hapi 4: shtyp n (= 44).

Detyra për ushtrime

1. Shkruani algoritmin për të bërë torte.
2. Shkruani algoritmin për përgatitje të mëngjesit të dilni prje shtëpie.
3. Shkruani algoritmin për kopjim të datotekave prej disku në uesbe.
4. Cilat janë hapat e mundshëm për caktimin e vlerës mesatare të tre numrave?
5. Përpiquni të shkruani algoritëm (me hapa algoritmike) për ndarjen e shifrës së mesme prej numrit treshifror të dhënë.
6. Shkruani algoritëm për të konstatuar ndonjë numër natyror n a është çift ose tek. (Nëse numri është plotpjesëtueshëm me 2, atëherë është çift, ndryshe është numër tek.
7. Shkruani algoritëm me të cilin do të gjeni cilën ditë me radhë në vit është sot. Për shembull, nëse sot është viti 01.09.2020, sot është dita 245 e vitit.
8. Shkruani algoritmin e përgjithshëm të pjesëtuesit më të madh të përbashkët (PMP) për dy numra natyrorë.
9. Shkruani algoritmin e përgjithshëm për gjetjen e shumëfishit më të vogël të përbashkët (SHVP) për dy numra natyrorë.
10. Shkruani algoritmin me të cilin do të njehsoni sa vjet, muaj dhe ditë keni sot.

1.3 Paraqitja e algoritmeve

Algoritmet mund të paraqiten në tri mënyra

- Paraqitja tekstuale.
- Paraqitja grafike.
- Me gjuhë programore

Paraqitja tekstuale e algoritmeve kryhet me hapa, sikure që është treguar te nënpika **1.2 Algoritme**. Poashtu mund të shfrytëzohet edhe e ashtuquajtura **pseudo-gjuhë** për përshkrimin e algoritmeve.

Ne do të shfrytëzojmë pseudo-gjuhë (me fjalë të reja të gjuhës shqipe), që përbëhet prej fjalëve: **algoritëm, nënalgoritëm, fillimi, fundi, nëse, atëherë, përndryshe, rast, ndërsa, realizo, përsërit, deri, për, hap, zmadho, zvogëlo, lexo, shtyp, vazhdo, ndërprerje, dalje, kërcim, dalje.**

Këto fjalë do t'i shkruajmë të zeza (të trasha) që të potencojmë se ato janë fjalë të rezervuara prej pseudo-gjuhës.

Shembulli për paraqitje tekstuale të algoritmit me pseudo-gjuhë të këtillë është dhënë te ***figura 1.3.1***, ku është paraqitur algoritmi për gjetjen e më të madhit prej tre numrave prej ***figura 1.2.2***. Në atë, me shigjetë shprehet veprimi me të cilën ndryshores p i ***shoqërohet*** vlera e ndryshores a.

```
algoritëm Më i madh
fillimi
        lexo a, b, c;
        nëse a > b
                atëherë
                        p ← a
                ndryshe
                        p ← b
      fundi_nëse {a > b}
        nëse p > c
                atëherë
                        n ← p
                ndryshe
                        n ← c
        fundi_nëse {p > c}
        shtyp n;
fundi {Më i madh}
```

Figura 1.3.1

Paraqitja grafike e algoritmeve kryhet me të ashtuquajturën **bllok-diagrame** (angl. flowchart). Te bllok-diagrame shfrytëzohen simbole grafike të veçanta (blloqe) për veprime të caktuara (operacione) të dhëna te ***figura 1.3.2***. Paraqitja e këtillë quhet **paraqitja standarde grafike**.

Algoritmi për detyrën për caktimin e më të madhit prej tre numrave të dhënë të paraqitur grafikisht me bllok-diagramin prej ***figura 1.3.1*** është dhënë te ***figura 1.3.3.***

Paraqitja grafike e algoritmeve ka përparësitë e tija dhe mungesa të tija. Përparësia është në dukshmërinë më të madhe të rrjedhjes së aktiviteteve te algoritmi pasi njeriu më lehtë e percepton figurën prej tekstit. Nga ana tjetër, bllok-diagrami për algoritëm më të madh mund të zen më shumë faqe dhe algoritmi të jetë i pakontrolluar.

Paraqitja e algoritmit mund të jetë edhe direkt nëpërmjet gjuhës programore. Poashtu, algoritmin e „shprehim", d.m.th., **kodojmë** (angl. code) me urdhrin prej ndonjë gjuhe programore. Kështu algoritmi i koduar me urdhër prej ndonjë gjuhe

programore quhet **program burimor** (angl. source program). Që të mund të realizohet program burimor, ai patjetër duhet të përkthehet në **program realizues** (angl. executive program).



Figura 1.3.2



Figura 1.3.3

Për shembull, algoritmi i shqyrtuar për gjetjen e më të madhit prej 3 numrave të dhënë, të koduar në gjuhën programore C++ është dhënë te ***figura 1.3.4.***

```
1   #include <iostream>
2   using namespace std;
3
4   int main() {    // Më i madhi prej tre numrave.
5
6       double a, b, c, p, n;
7       cout <<"futni numrin e parë:";
8       cin >> a;
9       cout <<"futni numrin e dytë:";
10      cin >> b;
11      cout << "futni numrin e tretë:"
12      cin >> c;
13      if (a > b)
14          p = a;
15      else
```

Figura 1.3.4

```
16          p = b;
17      if (p > c)
18          n = p;
19      else
20          n = c;
21      cout <<"Më i madhi prej numrave"<< a << ", "
22          << b << " i " << c << " e " << n << endl;
23
24      cout << endl;
25      system("Color 17");
26      system("pause");
27      return 0;
28  }
```

Figura 1.3.4 (vazhdim)

Pas realizimit të programit, dalja është:

```
futni numrin e parë : 123
futni numrin e dytë : 321
futni numrin e tretë :234
Më i madhi prej numrave  123, 321, 234 është  321
```

Algoritmet e strukturuara

Algoritmet për detyrat më të ndërlikuara mund të jenë shumë të gjata dhe jo të dukshme. Prandaj edhe programet që do të shkruhen sipas atyre algoritmeve mund të jenë të vështira të kuptueshme. Kjo është në veçanti e rëndësishme kur do të paraqitet nevoja prej ndonjë ndryshimi ose plotësimi te ato. Për gjetjen më të lehtë te programet e mëdha, sot ato shkruhen me teknikë për programin të njohur me emrin **programimi i strukturuar** (angl. struktured programming).

Emri programimi i strukturuar është fituar sipas shfrytëzimit të ashtuquajturave **strukturat algoritmike të kontrolluara** (angl. algorithm control strukturës), nëpërmjet të cilave menaxhohet (kontrollohet) gjatë realizimit të algoritmeve.

Te programimi i strukturuar shfrytëzohen dy teknika për programim:

- **Programimi prej lart** (angl. top-down programming).
- **Programimi modular** (angl. modular programming).

Programimi prej lart poshtë kryhet me ndarjen (zbërthimin) e detyrës në detyra më të vogla dhe më të thjeshta të ashtuquajtura **nëndetyra**. Nëse është e nevojshme, edhe ato nëndetyra më tej ndahen akoma në nëndetyra më të thjeshta deri sa nuk fitohen detyra që lehtë programohen.

Çdo nëndetyrë prej detyrës së zbërthyer mund të shqyrtohet si tërësi e veçantë, e pavarur prej të tjerave. Për çdonjërën në veçanti mund të shkruhet algoritëm, por pastaj dhe të programohet si pjesë e veçantë programore. Pjesët (tërësitë) e atilla të programit quhen **module** (angl. modules).

Çdo modul ka vetëm një pikë hyrëse (fillim) dhe vetëm një pikë dalëse (fund), ***figura 1.3.5.*** Të gjitha modulet te programi janë renditur në mënyrë sekuenciale (njëri pas tjetrit) dhe asnjëri prej tyre nuk mund të kapërcejë. Funksionin që e realizon një modul nuk guxon të përsëritet në tjetër modul, përkatësisht nuk guxon të ketë puthitje të moduleve. Gjithashtu, një modul mund të përbëhet prej më shumë moduleve të tjera, por mund të jetë edhe pjesë prej modulit më të madh.



Figura 1.3.5

Programimi modular është në veçanti i dobishëm gjatë ndryshimit të programeve ose gjatë përmirësimit të gabimeve. Nëse duhet të ndryshojë programi ose të përmirësohet ndonjë gabim te ai, atëherë ndryshon vetëm moduli te i cili është paraqitur gabimi, por nuk ndryshojnë modulet e të tjera.

Paraqitja grafike e algoritmeve gjatë programimit të strukturuar, dallohet prej paraqitjes gjatë programimit të pa strukturuar, e cila quhet **paraqitje standarde**.

Algoritmet e strukturuara paraqiten me blloqe drejtkëndore. Çdo drejtkëndësh shpreh tërësi (modul) të veçantë me fillimin dhe mbarimin e vet. Nëse ndonjë modul ndahet në pjesë më të thjeshta, ai paraqitet me drejtkëndësha më të vegjël te më i madhi. Për shembull, algoritmi për gjetjen e më të madhit prej tre numrave të dhënë, i paraqitur në mënyrë standarde te ***figura 1.3.3***, në mënyrë të strukturuar është paraqitur te ***figura 1.3.6***.

Pyetje për kontroll të njohurive

1. Çka është programi, kurse çka është programimi?
2. Si quhen gjuhët te të cilat programohet?
3. Cilat janë programet sistemore, kurse cilat janë programet aplikative?
4. Si grupohen programet sistemore?
5. Cila është ndarja kryesore e softuerit?
6. Microsoft Windows a është program aplikativ?
7. Në cilin grup programet aplikative do ta vendojë programin Microsoft Excel?
8. Përmend tre programe aplikative të cilat punon kompjuteri Juaj. Përpiquni ta vendojë në kategorinë përkatëse prej nivelit të dytë te ***figura 1.1.1.***
9. Përpiquni të jepni shembull për program për çdonjërën prej grupeve softuer prej nivelit të tretë te ***figura 1.1.1.***

```
lexo a, b, c
nëse a > b
        atëherë
                p ← a
        ndryshe
                p ← b
nëse p > c
        atëherë
                n ← p
        ndryshe
                n ← c
shtyp n
```
Figura 1.3.6

10. Çka është algoritëm? Përmend një përkufizim.
11. Çka është hap algoritmik?
12. Si mund të jetë algoritmi sipas detalizimit?
13. Si mund të paraqitet një algoritëm?
14. Me cilat diagrame grafike janë paraqitur algoritmet?
15. Përmend simbolet (blloqet) grafike për paraqitje standarde grafike të algoritmeve.
16. Çka është programi burimor?
17. Kompjuteri a mund të realizojë direkt program burimor?
18. Çka është programim i strukturuar?
19. Cilat teknika shfrytëzohen gjatë programimit të strukturuar?
20. Si paraqiten grafikisht algoritmet e strukturuara?
21. Çka paraqet moduli programor?
22. Pse është e dobishme teknika modulare për programim?
23. Sqaroni (ose kërkoni t'u sqarohen) teknikat për programim prej lart poshtë.

1.4 Programimi

Që të mund ndonjë të shkruajë program për zgjidhjen e detyrës së caktuar me ndihmën e kompjuterit, është e nevojshme të dijë të programojë.

Programimi ***është proces i të shkruarit e programit.***
Njerëzit që programojnë quhen programuesë.

Fazat e programimit

Që të zgjidhet ndonjë detyrë me ndihmën e kompjuterit, nuk është e mjaftueshme vetëm të dimë të programojmë dhe të shkruajmë program. Programimi është një pjesë e atij procesi, që përbëhet prej disa fazave:

- Parashtrimi i detyrës.
- Përkufizimi i algoritmit (mënyra) për zgjidhjen e detyrës.
- Të shkruarit e programit.
- Testimi i programit.

Faza I: Vendosja e detyrës

Gjatë parashtrimit të detyrës, saktë duhet të përkufizohen dhe të precizohen kushtet nën të cilat ai do të zgjidhet. Prandaj, së pari duhet të kuptohet drejt detyra. Ajo bëhet me analize të natyrës së saj, por nëse është e nevojshme edhe me hyrje te fusha profesionale e të cilës i takon.

Për ta sqaruar atë që u përmend lart, do të parashtrojmë disa detyra dhe do t'i analizojmë.

1. Të gjendet shuma e 10 numrave natyrorë.
2. Të zgjidhet sistemi prej dy barazimeve lineare me dy të panjohura.
3. Të bëhet lista e artikujve në një shitore sipas sasisë dhe sipas vlerës dhe të njehsohet vlera e përgjithshme e mallit.
4. Prej 16 fijeve të shkrepëses dy lojtarë A dhe B marrin në mënyrë alternative nga 1, 2, 3 ose 4 fije. Fiton ai i cili i fundit do të marrë fije. Njëri prej tyre a mund të fitojë?

Për detyrën e parë çdonjëri do të thotë se nuk është e vështirë – pasi di të mbledhë di edhe të shkruajë program.

Për detyrën e dytë duhet të dihet ndonjë metodë për zgjidhjen e sistemit prej dy barazimeve lineare me dy të panjohura, sikurse janë: metoda e zëvendësimit ose metoda e koeficientëve të kundërt.

Për detyrën e tretë duhet të dihet:

- Emri i çdo artikulli.
- Sasia e çdo artikulli.
- Çmimi për njësi, për litër ose sipas paketimit.

Për detyrën e katërt nuk do të vendojmë fije në kompjuter, por prej numrit 16 në mënyrë alternative do të zbresim nga aq fije sa do të tregojë çdo lojtar - 1, 2, 3 ose 4. Thelbi i detyrës është të mendohet nga sa fije të shkrepëses duhet të merren, duke ditur sa kanë marrë kundërshtarët edhe sa kanë ngelur për të marrë të fundit dhe të fitojë.

Faza II: Përkufizimi i algoritmit për zgjidhjen e detyrës

Pas kryerjes së analizës së detyrës është e nevojshme të përkufizohet (gjendet/ mendon) ose të zgjedhë (nëse di më shumë) algoritme për zgjidhjen e saj. Më së shpeshti mënyra del prej analizës së bërë të detyrës dhe prej literaturës profesionale të konsultuar te e cila përfshihen relacione, formula dhe metoda të caktuara për zgjidhjen e saj. Po ashtu, duhet pasur llogari mënyra të jetë e zbatueshme për kryerje në kompjuter. Tek ai qartë duhet të përmenden të gjitha operacionet që duhet t'i kryejë kompjuteri për të dhënë rezultate të sakta. Çdo operacion duhet të jetë njëvlerësisht i përkufizuar, por edhe renditja e operacioneve duhet të jetë saktë e dhënë. Kuptohet, gjithë mënyra duhet të jetë e fundshme, përkatësisht të mbarojë pas numrit të fundshëm të operacioneve d.m.th., pas kohës së fundshme të realizimit. Mënyra e këtillë e përkufizuar për zgjidhjen e ndonjë detyre, sikurse që ishte edhe paraprakisht e përmendur, quhet **algoritëm.**

Të përmendim se për zgjidhjen e detyrës së njëjtë mund të shkruhen më shumë algoritme të ndryshme.

Faza III: Të shkruarit e programit

Të shkruarit e programit paraqet të shkruarit (të shprehurit, kodimit) të algoritmit me elementet e ndonjë gjuhe programore. (Për gjuhët programore do të flasim në nënpikën vijuese).

Faza IV: Testimi i programit

Te faza e katër kryhet testimi i programit për të kontrolluar a jep rezultate të sakta. Testimi kryhet më së shpeshti me vlerat e zgjidhjeve për të cilat i dimë ose mundemi (në ndonjë mënyrë) t'i kontrollojmë.

Gjuhët programore

Njerëzit ndërmjet veti kuptohen dhe komunikojnë me ndihmën e gjuhës. Kështu, pa dallim se a është paraqitur me shenja, me simbole ose duke folur, gjuha paraqet mjet themelor për komunikim.

Gjuhët mund të jenë:

- **Natyrore.**
- **Artificiale.**

Për komunikimin ndërmjet veti njerëzit i shfrytëzojnë gjuhët natyrore, si për shembull, shqipen, maqedonishten, anglishten, rusishten etj. Për komunikim ndërmjet njerëzve dhe makinave (ose ndërmjet dy makinave), shfrytëzohen gjuhët artificiale.

Lloj i veçantë i gjuhëve artificiale janë gjuhët programore, të cilat janë të zhvilluara për komunikim ndërmjet njeriut dhe kompjuterit. Me gjuhët programore shprehet mënyra (algoritmi) për zgjidhjen e ndonjë detyre të shkruar në formë tekstuale të quajtur **program**. Programet shkruhen me urdhëra të cilat kompjuteri i „kupton" dhe i realizon ato veprime të cilat janë „shprehur" me ato.

Prej paraqitjes së kompjuterit deri më sot janë zhvilluar një numër i madh i gjuhëve programore. Ato ndahen në tre grupe:

- **Gjuha makinerike.**
- **Gjuha simbolike.**
- **Gjuhë e programimit të lartë.**

Gjuhë makinerike

Gjuha makinerike (angl. machine language) është gjuha e kompjuterit. Ajo është gjuhë e zakonshme që çdo kompjuter e kupton dhe te e cila kompjuteri punon menjëherë. Përbëhet prej numrit të caktuar **instruksionesh makinerike** (angl. machine

[2] Mendohet se deri më tani janë zhvilluar mbi 3 000 gjuhë programore.

instructions), të cilat shprehen vetëm me zero dhe njëshe, d.m.th., vetëm me shifra binare[3], ***figura 1.4.1.***

Megjithatë, shënimi me numra binarë është shumë i madh dhe i pa shqyrtuar. Prandaj, programet makinerike (në letër më së shpeshti shkruhen në *sistemin numerik heksadhjetor*[4], ***figura 1.4.1.***

Instruksione makinerike

Shënimi binar	Shënimi heksadhjetor
10111000110101100001011O	B8D616
1000111011011000	8ED8
10100000000000000000000	A00000
00000010000001100000000100000000	02060100
10111011000100001000000O	BB1080
1000100000000111	8807
1011010001001100	B44C
1100110100100001	CD21

Figura 1.4.1

Gjuhë simbolike

Gjuha simbolike (angl. assembly language) është në nivel më të lartë prej gjuhës makinerike. Te kompjuterët e parë, programet janë shkruar vetëm me gjuhë makinerike. Me kohë, për më lehtë dhe për më shpejt paraqitja e zgjidhjes së detyrës së parashtruar, programuesit kanë filluar të shërbehen me fjalë të shkurtëra të thjeshta të quajtura **simbole** ose **mnemonikë**[5] për të shënuar instruksionet makinerike. Kështu kanë ndërtuar gjuhët simbolike. Emrin e kanë marrë pikërisht për shkak të asaj që me ato instruksione makinerike dhe të dhënat shprehen në mënyrë simbolike.

Për shembull, programi makinerik prej ***figurës 1.4.1*** ka shënim simbolik sikurse te ***figura 1.4.2***[6].

[3] Shifrat binare janë 0 dhe 1. Ato janë shifra të ashtuquajtura *sistemi numerik binar*. Ne e kemi të njohur *sistemin numerik dekad* te i cili ka 10 shifra – 0, 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8 dhe 9.

[4] *Sistemi numerik heksadhjetor* ka 16 shifra, edhe atë: 0, 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, A, B, C, D, E dhe F.

[5] Mnemonika është teknikë për mbajtje mend.

[6] Në fillim të çdo urdhri te ***figura 1.4.2*** është treguar adresa te e cila gjendet në memorie.

Gjuhët simbolike kanë shkallë më të madhe të kuptueshmërisë prej gjuhës makinerike. Për shembull, prej ***figura 1.4.2*** shikohet se MOV është shkurtesë për zhvendosje (angl. move), ADD do të thotë zhvendosje, d.m.th., mbledhje (angl. add) etj.

Por gjuhët simbolike janë të pakuptueshme për kompjuterin, që do të thotë se program i shkruar me gjuhën simbolike nuk mund të realizohet menjëherë në kompjuter. Prandaj, janë përpunuar programe sistemore të veçanta të quajtura **përkthyes** (angl. compilers), të cilat programin prej gjuhës simbolike e përkthen në program të gjuhës makinerike.

```
16D7 : 0000   MOV    AX, 16D6
16D7 : 0003   MOV    DS, AX
16D7 : 0005   MOV    AL, [0000]
16D7 : 0008   ADD    AL, [0001]
16D7 : 000C   MOV    BX, 8010
16D7 : 000F   MOV    [BX], AL
16D7 : 0011   MOV    AH,4C
16D7 : 0013   INT    21
```

Figura 1.4.2

Gjuhët simbolike janë gjuhë **makinerike të orientuara** pasi çdo kompjuter ose familje kompjuterësh ka gjuhë simbolike personale të vet, që varet prej procesorit të kompjuterit.

Gjuhët simbolike më së shpeshti janë të njohura me emrin gjuhë asemble (angl. assembly), por përkthyesit e tyre quhen asemblerë (angl. assemblers).

Gjuhët programore të larta

Gjuhët programore të larta (angl. high-level languages), janë gjuhë te të cilat mendohet kur flasim për programimin. Zhvillimi i tyre fillon në vitet 50 të shekullit XX kur kompjuterët me universalitetin e tyre kanë filluar të hyjnë në shumë fusha të punës njerëzore. Te prodhuesit e kompjuterëve është imponuar pyetja: Se si kompjuterët të afrohen deri te njeriu që të mund t'i shfrytëzojnë edhe njerëzit të cilët nuk e dinë teknikën për programimin makinerik dhe simbolik?

Ideja themelore në zgjidhjen e këtij problemi ka qenë programet të shkruhen në gjuhë të ngjashme me gjuhën natyrore të njeriut. Për një kohë shumë të shkurtër, gjuhët programore të larta kanë qenë përgjithësisht të pranuara prej një numri të madh të shfrytëzuesve.

Pranimi i shpejtë dhe shfrytëzimi masiv i këtyre gjuhëve i përket këtyre fakteve:

- *Programimi dukshëm është lehtësuar për shkak të afërsisë së këtyre gjuhëve me mënyrën natyrore e shkruar të të shprehurit të njeriut edhe me terminologjinë nga fusha të cilës i takon detyra.*
- *Mundësojnë shpejt dhe në mënyrë efikase të shkruarit e algoritmeve.*
- *Nuk kërkojnë njohuri të vetive teknike të kompjuterit te e cila kryhet program, përkatësisht program i njëjtë mund të kryhet në kompjuter të ndryshëm.*
- *Shpejt dhe lehtë mësohen.*
- *Mundësojnë shkëmbim të programeve dhe të përvojave ndërmjet shfrytëzuesve.*

Të gjitha faktet e përmendura bazohen në strukturat e gjuhëve programore të larta, që në mënyrë të dukshme dallohet prej strukturës së gjuhës makinerike dhe simbolike.

Edhe se gjuhët programore të larta janë gjuhë artificiale, ato janë ndërtuar në mënyrë të ngjashme sikurse edhe natyrore. Përkatësisht, çdonjëra prej atyre gjuhëve ka **alfabetin** e vet i përbërë prej shkronjave, shifrave dhe shenjave speciale: shenjat e pikësimit, shenja për operacionet aritmetikore, për krahasim etj[7].

Me kombinimin e shenjave prej alfabetit, formohen konstruksionet elementare të gjuhës – **fjalët**, të cilat e përbëjnë **fjalorin e gjuhës**. Për shembull: read, do, while, new, OPEN, MULTIPLY, STOP, if etj.

Fjalët kanë domethënie të caktuar, por te programet nuk mund të figurojnë sikurse elemente të pavarura direkt do të ndikojnë mbi punën e kompjuterit, por kombinohen me konstruksionet gjuhësore të quajtura **fjali** ose **urdhëresa** (angl. statements). Urdhëresat kanë saktë domethënie të përkufizuar dhe mund te programi të qëndrojnë si tërësi të pavarura, d.m.th., të shkaktojnë aksion të caktuar te kompjuteri.

Qe disa shembuj për urdhëresa:

```
if (ti > unë) System.out.printën("Urime. Ti fitove. ");
throw new UserDefinedException("Është krijuar UserDefinedException! ");
MULTIPLY BROJ1 BY BROJ2 GIVING PRODHIM.
```

Është e rëndësishme të potencojmë (sikurse te gjuhët natyrore) se çdo varg (kombinim) shenjash prej alfabetit nuk paraqet fjalë prej gjuhës, përkatësisht se çdo konstruksion i fjalëve nuk paraqet urdhër. Prandaj, edhe gjuhët programore të larta, si edhe natyrore, kanë **gramatikën** e tyre e cila i përmban rregullat për ndërtimin e fjalëve dhe urdhërave.

Çdo gjuhë përmban bashkësi të caktuar **fjalë të rezervuara** (angl. reserved words). Programuesit mund të shfrytëzojnë edhe fjalë të tjera, të ndryshme prej të rezervuarave, të cilat janë formuar sipas rregullave të caktuara. Ato quhen **identifikator** (angl. identifiers).

Ekzistojnë rregulla rigoroze sipas të cilat konstruktohen urdhërat, të cilat quhen **rregulla sintetike** ose vetëm **sintaksa** (angl. syntax) e gjuhës. Me ato rregulla kontrollohet korrektësia e çdo urdhri te programi.

Çdo rregull te programi patjetër të ketë saktë domethënie të përkufizuar dhe të shkakton saktë veprime të përkufizuara. Domethënia (kuptimi) i urdhërave quhet **semantika** (angl. semantiks) e gjuhës.

Programet e shkruara në gjuhët programore të larta nuk mund direkt të kryhen te kompjuteri. Për këtë qëllim, janë të nevojshme programe sistemore që do të kryejnë përkthimin e tyre në gjuhën makinerike të quajtur **përkthyes**. Çdo gjuhë programore ka përkthyesin e vet.

[7]Te gjuhët programore më së shpeshti shfrytëzohet alfabeti anglez.

Programi i shkruar në gjuhën e lartë programore quhet **programi burimor** (angl. source program), por program i përkthyer makinerik quhet **program i realizuar** (angl. executive program).

Përkthimi në mënyrë skematike është paraqitur në këtë figurë.

Figura 1.4.3 a

Programi i ekzekutueshëm zakonisht mbahet mend si datotekë të ndonjë memorie të jashtme, që prej atje të thirret dhe të realzon sipas nevojës. Por ndonjëherë ajo vetëm memorohet në memorien e brendshme dhe realizohet.

Shpesh shfrytëzohet dhe direkt realizimi i programeve burimore. Ajo bëhet me programe të tjera sistemore të quajtura **interpretatore** (angl. interpreters.

Interpretuesit nuk bëjnë datoteka në formë makine te programi burimor, por në mënyrë sekuenciale i interpretojnë dhe i realizojnë urdhëresat e saja.

Skema e interpretimit të programit është dhënë te figura 1.4.3.b.



Figura 1.4.3 b

Gjuhët programore të larta nuk varen prej makinës te e cila realizohet ndonjë program i shkruar me atë dhe prandaj quhen **gjuhë makinerike të pavarura**. Prandaj, gjatë ndërtimit të gjuhëve programore të larta, nuk mbahet llogari për llojin e kompjuterit te i cili do të realizohen programet të shkruara me ato, por mbahet llogari për llojin e problemit që zgjidhet. Themi se ato janë orientuar kah zgjidhja e llojit të caktuar të problemeve (ekonomike, teknike, statistike etj.) dhe prandaj, quhen **gjuhë problemore të orientuara**.

Zhvillimi i gjuhëve programore të larta ka filluar në vitet 50-ta të shekullit të kaluar. Zhvillimi i tyre në mënyrë figurative është paraqitur me këtë figure, e marrë prej literaturës.



Te ***tabela 1.4.1*** është dhënë paraqitja kronologjike e disa gjuhëve programore më të rëndësishme.

Viti	Gjuhë		
1945	Gjuhë makinerike		
1950	Gjuhë simbolike		
1955	Fortran		
1960	Algol	Cobol	Lisp
1965	Basic	Simula	PL/I
1970	Pascal	Prolog	Logo
1975	Cobol	Scheme	ML
1980	C	Ada	Eiffel
1985	Objective-C	SQL	Perl
1990	C++	Visual Basic	Python
1995	Delphi	HTML	Ruby
	Java	JavaScript	PHP
2000	C#	Scala	R
2007	Go	Clojure	
2010	Swift	Google Dart	Julia
	Hack	Rust	Pixie
2012	TypeScript		
2016	Kotlin		

Tabela 1.4.1

Sot, gjuhët programore bashkëkohore të zhvilluara pas viti 2010 janë të dedikuara për programimin e veb-aplikacioneve të cilat punojnë në internet, por të cilat i integrojnë karakteristikat e mira të disa gjuhëve. Ato janë të ashtuquajturat **gjuhët e shkrimit** (angl. scripting languages), me të cilat janë punuar programe të veçanta – skripte (angl. scripts) të cilat realizohen në veb-faqet, por gjatë realizimit të programeve të tjera. Skriptet nuk përkthehen, por interpretohen. Gjuhët e shkrimit janë dizajnuar, për integrim dhe komunikim me gjuhët programore të tjera, sikurse: HTML, Java, C++ etj.

Gjuhë të shkrimit më të njohura janë: JavaScript, PHP, Python, VBScript etj.

Gjuhët programore më të shfrytëzuara për programin janë dhënë te ***figura 1.4.4***.

Figura 1.4.4

Te ***figura 1.5.5 a, b, c, ç, d*** dhe janë paraqitur programet e thjeshta për zgjidhjen e detyrës te e cila duhet të gjendet shuma e 10 numrave natyrorë të parë të shkruar Ce++, Java, Pascal, Fortran, FORTRAN), Rubby dhe Python.

```
#include <iostream>
using namespace std;

void main()
{
        int n,suma;
        suma = 0;
        n = 1;
        while(n <= 10) {
                suma = suma + n;
                n = n + 1;
        }
        cout << suma << endl;
}
```

a

Programi në C++

```
public class JavaPrimer {
   public static void main(String[] args){
        int n,suma;
        suma = 0;
        n = 1;
        while (n <= 10) {
            suma = suma + n;
            n = n + 1;
        }
        System.out.println(suma);
   }
}
```

b

Programi në Java

```
PROGRAM Suma;
VAR  N,Suma:integer;
BEGIN
     Suma := 0;
     N := 1;
     WHILE N <= 10 DO
        BEGIN
                Suma := Suma + N;
                N := N + 1;
        END;
     WriteLn(Suma);
END.
```

c

Programi në PASCAL

```
      SUMA = 0
      N = 1
      WHILE N <= 10
              SUMA = SUMA + N
              N = N + 1
      ENDWHILE
      WRITE(*, 30)SUMA
 30   FORMAT(I10)
      STOP
```

ç

Programi në FORTRAN

```
suma = 0
n = 1
while n <= 10
  suma = suma + n
  n = n + 1
end
puts suma
```

d

Programi në Ruby

```
suma = 0
n = 1
while n <= 10:
    suma = suma + n
    n = n + 1
print suma
```

dh

Programi në Python

Figura 1.4.5

Të shkruarit e programeve kryhet në ndonjë redaktues të tekstit, por pastaj ato shkruhen (ruhen) në ndonjë memorie të jashtme si datotekë nën ndonjë emër. Programi i atillë nuk mund të kryhet pasi është e nevojshme paraprakisht të përkthehet.

Programet burimore shpeshherë kanë zgjerim pas emrit që është shkurtesa prej gjuhës programore. Zgjerimi është ndarë prej emrit me pika:.pas,.bas,.for,.cpp,.java etj. Për shembull: shuma.pas, e parë.bas, Programime.cpp, rendit.java etj.

Programet e realizuara të cilat fitohen pas përkthimit të programeve burimore ka zgjerim:.exe,.com,.bat,.bin etj. Për shembull: shumë.exe, e para.com etj.

Gjenerata të gjuhëve programore

Sipas zhvillimit historic, gjuhët programore ndahen në pesë gjenerata (angl. Generation Languages – GL), edhe atë:

- Gjenerata e parë (1 GL): gjuhë makinerike.
- Gjenerata e dytë (2 GL): gjuhë simbolike.
- Gjenerata e tretë (3 GL): gjuhë programore të larta (C++, Java, Fortran etj.).
- Gjenerata e katërt (4 GL): shumë gjuhë programore të larta (angl. very high-level languages) (Perl, PHP, Python, SQL etj.).
- Gjenerata e pestë (5 GL): gjuhë programore të larta8 (Mercury, Prolog, OPS5 etj.).

Ndarja e gjuhëve programore

Ndarja e gjuhëve programore mund të bëhet dhe sipas mënyrës në të cilë janë përpunuar të dhënat:

- **Imperative**.
- **Deklarative**.

[8]Disa autor i quajnë gjuhë për inteligjencën artificiale (angl. artificial intelligence languages).

Mënyra imperative e mënyrës së urdhrit, ku programet shkruhen me urdhër për përpunimin e të dhënave.

Mënyra deklarative është mënyrë përshkruese që përshkruan se si arrihet deri te rezultati.

Gjuhët imperative ndahen në:

- **procedurale** (Pascal, C, Fortran, Basic, Ada, Modula dhe të tjera),
- **objektive të orientuara** (C++, Java, C#, Delphi, Smalltalk dhe të tjera).

Karakteristika kryesore e këtyre gjuhëve është shfrytëzimi i ndryshoreve, urdhëra dhe procedura[9]. Në gjuhët procedurale, procedurat me të cilat përpunohen të dhënat në mënyrë të ndarë, por në gjuhët objekte të orientuara procedurat (të quajtura funksione ose metoda) janë fshehur te vet objektet.

Gjuhët deklarative ndahen në:

- **funksionale** (Lisp, Scheme, Miranda, Haskell, ML dhe të tjera)
- **logjike** (Prolog dhe të tjera).

Karakteritika kryesore e gjuhëve funksionale është shfrytëzimi i shprehjeve dhe funksioneve. Programi paraqet funksion (se grup funksionesh) të përbëra prej funksioneve më të thjeshta.

Te gjuhët logjike, baza e njësisë për njehsim është relacioni, që është më e përgjithshme prej pasqyrimit. Programi përbëhet prej: bashkësisë së fakteve, bashkësia e përfundimeve të lejuara (rregulla për vërtetim), metoda për përfundime dhe gjithë vërtetimi.

Diagrami i aktiviteteve

Për paraqitje grafike të punës së programeve, shfrytëzohen diagrame të ndryshme. Për unifikimin e paraqitjes së diagrameve, kah fundi i viteve 90-ta të shekullit të kaluar është rijuar gjuha grafike e quajtur Unified Modeling Languga – UML.

UML ka numër të madh të simboleve grafike. Ne do të shfrytëzojmë këto:



Diagrami prej ***figura 1.3.3,*** i shprehur me gjuhën-UML, do të jetë si te ***figura 1.4.6***.

[9] Për ndryshoren dhe procedurat d të flasim më vonë.

Pyetje për kontrollin e njohurive

1. Çka është programimi?
2. Si quhen njerëzit që programojnë?
3. Sqaroni fazat për zgjidhjen e ndonjë detyre me ndihmën e kompjuterit.
4. Çka duhet të dimë për të mundur të shkruajmë program?
5. Për cilat gjuhë programore keni dëgjuar?
6. Me cilat shifra shkruhen programet në gjuhën makinerike? Pse nuk prograAmohet në gjuhën makinerike?
7. Në cilin sistem numerik shkruhen programet makinerike në letër?
8. A është më e thjeshtë gjuha makinerike ose gjuhët simbolike?
9. Si quhen programet sistemore që kanë detyrë t'i përkthejnë programet prej gjuhëve simbolike në gjuhë makinerike?
10. Në cilat fakte detyrohet shfrytëzimi masiv i gjuhëve të larta programore?
11. A ka dallim ndërmjet alfabetit natyror dhe të gjuhës programore?
12. Fjalët në gjuhët e larta programore a kanë domethënie?
13. Prej çka përbëhet fjalori i një gjuhe të lartë programore?
14. A mund një urdhër programor të përbëhet vetëm prej një fjale?
15. Si quhen fjalët që i formojnë programuesit te programet?



Figura 1.4.6

16. Si quhen rregullat sipas të cilës janë konstruktuar urdhërat te gjuhët programore?
17. Çka është sementika e gjuhës?
18. Si quhet program i shkruar në gjuhën e lartë programore, por si program i përkthyer në gjuhë makinerike? Cilat prapashtesa i kanë datotekat përkatëse?
19. Cili është dallimi ndërmjet përkthyesve dhe interpretuesve?
20. Pse themi se gjuhët e larta programore janë gjuhë të pavarura makinerike?
21. Përmend disa gjuhë të larta programore.
22. Përmend gjeneratat e gjuhëve të larta programore.

23. Përmend një ndarje të gjuhëve të larta programore.
24. Cila është karakteristika kryesore e gjuhëve procedural, por cila e gjuhëve objekte të orientuara?
25. Me cilën gjuhë grafike sot janë paraqitur diagramet? Vizato simbolet e tij themelore grafike.

1.5 Rrethina integruese zhvillimore

Sipas asaj që treguam më lart në nënpikat paraprake, që të mundemi të fillojmë me programim, patjetër të njihemi me ndonjë gjuhë të lartë programore. Pastj, e shkruajmë programin te ndonjë redaktues të tekstit dhe e rajmë si datotekë tekstuale

Që të mund të shikojmë programin që e kemi shkruar a e bën atë që pritet, ne atë duhet ta përkthejmë në gjuhë makinerike dhe ta realizojmë. Theksuam se gjatë përkthimit në gjuhën makinerike, shfrytëzohet ndonjë përkthyes dhe fitohet program/ datotekë realizuese. Programin realizues të fituar duhet ta kryejmë dhe madje atëherë të shikojmë çka bën program ynë. Nëse shfrytëzojmë interpretator, atëherë direkt përkthehet dhe realizohet, d.m.th. integrohet.

Për t'i lehtësuar punën programuesve, të gjitha programet të cilat na mundësojnë funksionet e lartpërmendura funksionet vendohen (integrohen) në një rrethinë, të quajtur ***rrethina e integruar për zhvillim*** RrIP (angl. Integrated Development Environment – IDE). Për programimin në C++, më shumë shfrytëzohen rrethinat integruese zhvillimore, sikurse: Microsoft Visual Studio, Code::Blocks, Netbeans, Eclipse, Visual Studio Code, CLion, CodeLite dhe të tjera.

Çdo rrethinë integruese zhvillimore përbëhet prej bshkësie të aplikimeve të cilat shfrytëzohen gjatë programimit. Ajo bashkësi e aplikimeve varet prej gjuhës programore, por aplikime të detyrueshme janë: **redaktues tekstual** (angl. text editor), **përkthyes** (angl. compiler), **dibager** (angl. debugger) dhe **lidhës** (angl. linker).

Redaktuesi tekstual

Ai është aplikacioni që mundëson futje të tekstit prej tastaturës direkt në programin burimor, sikurse edhe për realizimin e operacioneve themelore për përpunimin e teksteve. Kjo jep mundësi për ruajtjen e programeve në disk dhe hapja e programeve të ruajtura për ripërpunim, d.m.th., për ndryshim.

Redaktori i tekstit i ka të gjitha veglat standarde për futje dhe përpërpunim të tekstit. Gjatë redaktimit të tekstit, mundemi t'i shfrytëzojmë pothuajse urdhërat e njëjta të cilat i kemi në programet për redaktim të tekstit për punë në zyrë, sikurse: Microsoft Office Word, OpenOffice Writer etj. Gjithashtu, vlejnë të gjitha urdhërat për lëvizje të treguesit prej miut.

Urdhërat për selektim, kopjim, bartja dhe fshirja e tekstit janë të njëjta sikurse te redaktuesit e tjerë të tekstit. Poashtu, shfrytëzohen urdhërat prej menysë për redaktim, më shpesh të quajtur Edit.

Në shumicën e rasteve, mund të ketë nevojë prej kërkesës së tekstit të caktuar nëpër program, por pas gjetjes, dhe prej zëvendësimit të tij me tjetër tekst. Kjo realizohet me urdhërat në meny, më shpesh të quajtur Search.

Përkthyes/Interpretator

Përkthyesi është aplikacion special që përkthen program burimor (të shkruar në ndonjë gjuhë programore) te program burimor i gjuhës makinerike që të munduar kompjuteri ta realizojë.

Gjatë përkthimit, përkthyesi e përkthen gjithë programin burimor në programin realizues, që mund të realizohet menjëherë (nëse është në memories punuese) ose të ruhet te datoteka e ndonjë memorie të jashtme dhe më vonë (ose menjëherë) të realizohet, pa u përkthyer përsëri.

Interpretari e përkthen dhe realizon programin pjesë për pjesë (urdhër pas urdhri), d.m.th., pas disa urdhërave menjëherë. Gjatë realizimit përsëri të programit, interpretatori patjetër të përkthen dhe realizon çdo urdhër (ose grup të urdhërave).

Edhe përkthyesi edhe interpretuesit kanë përparësi dhe mangësi. Sot, disa gjuhë programore, sikurse Java dhe Visual Basic, shfrytëzojë kombinim prej përkthimit dhe interpretuesit. Për shembull, përkthyesi java e përkthen programin burimor në të ashtuquajturën ndërmjet kd, të njohur si **bajt-kod** (angl. bytecode). Programi në bajt-kod mund të realizohet me interpretuesin në çfarëdo kompjuter.

Ngjashëm bëhet edhe gjatë përkthimit të programit në C++, vetëm që përkthimi i programit burimor në ndërmjet kod trajtohet si faza e procesimit. Pastaj, forma e fituar e programit përkthehet në gjuhën makinerike, ***figura 1.5.1.***

Përkthyesit dhe interpretuesit janë dizajnuar të kontrollojnë gabimisht në program. Më të shpeshta janë gabime gjuhësore (sintaktike) kur urdhërat janë shkruar gabimisht. Për shembull, nëse në vend close, kemi shkruar cloce. Praqiten edhe gabime programore (semantike) gjatë shfrytëzimit jo të drejtë të urdhërave te gjuha. Për shembull, nëse në vend do {... }while(), emi shkruar do {... }for() dhe të ngjashme.

Dibager

Fatkeqësisht, përkthyesit mund të zbulojnë gabime te programi, për shkak të shfrytëzimit të gabuar të gjuhës programore. Lloj tjetër i gabimeve të cilat shpesh ndodhin, në veçanti prej programuesve fillestar, janë gabime logjike, d.m.th., programin nuk e bën ajo për të cilën është dedikuar edhe pse punon në mënyrë korrekte. Ato gabime zbulohen shumë vështirë dhe prandaj duhet të kontrollohet mënyra në të cilën realizohen programet paraprakisht me të dhënat hyrëse, për të cilat rezultati është i njohur. Të dhënat hyrëse të atilla quhen **test-shembuj**. Dibageri (angl. Debugger).

Dibageri është që ndihmon gjatë kërkimit të gabimeve logjike. Ai mundëson të përcjellim realizimin e programit të test-shembujve hap pas hapi dhe, t'i zbulojmë gabimet logjike. Gjatë kohës së atij procesi, dibageri mund të tregojë edhe disa ndërmjet rezultateve të cilat ndihojnë të caktohet vendi dhe lloj i gabimit.

Lidhësi

Ndonjëherë një program është shumë i madh për t'u shkruar si një datotekë. Përveç kësaj pjesët e ndryshme mund të shkruhen prej programuesve të ndryshëm. Ndonjëherë pjesët prej programit të dhënë mund të jenë të shfrytëzuara edhe në tjetër program. Në rastin e këtillë këto pjesë duhet të jenë formuar si datoteka të pavarura. Nëse ndonjë program duhet të përbëhet prej më shumë programeve të pavarura, ato duhet të bashkohen me lidhjen në datotekën e vetme, d.m.th. në program realizues të vetëm. Kjo bëhet me aplikacion të veçantë të quajtur **lidhës**.

Rol tjetër të lidhësit është t'i „lidh"programet e bibliotekave me programin që e shkruajmë. Çdo gjuhë programore ka bibliotekë (të quajtur edhe module) me programe të gatshme, të cilat mund të shfrytëzohen te çfarëdo program që e shkruajmë. Për shembull, program i bibliotekës për njehsimin e rrënjë katrore prej numrit real x, në shumë gjuhë programore quhet sqrt(x). Nëse te program jonë ka urdhër y=sqrt(x), atëherë lidhësi e lidh programin tone me bibliotekën te e cila gjendet program sqrt(x). (Emri sqrt(x) është shkurtesa prej square root).

Skema më reale e përkthimit të programit burimor, prej asaj të dhënës te ***figura 1.4.3*** a dhe b, është skema prej ***figura 1.5.1***.

Rrethina e integruar për programimin zakonisht duket si bashkësi prej më shumë aplikacioneve me të cilat për çdo ditë punojmë. Ai ka dritare themelore me *fushë punuese*, shirit për meny dhe elemente të tjera të zakonshme: buton për mbylloje dhe ndryshimi madhësisë së dritares, buton për minimizim etj. Në *fushën e punës* hapen dritaret e programeve të veçanta. Te shiriti për meny gjenden (lista prej urdhërave), me të cilën thirren funksionet e rrethinës: menyja për redaktim, menyja për përkthim, lidhja dhe realizimi i programeve, menyja për testim etj.



Figura 1.5.1

Në shumicën e rrethinave të integruara për programim zakonisht ka meny për ndihmë që jep mundësi për kontrolle të lidhura me rregulla të gjuhës programore dhe puna me vet rrethinën për programim.

Në vazhdim, do të sqarojmë rrethina zhvillimore të integruara Micro-soft Visual Studio 2019 dhe Code::Bloks.

Rrethina e integruar për programimin Microsoft Visual Studio 2019

Microsoft Visual Studio 2019 (MVS 2019) mund të merret prej shumë faqeve të internetit.

Pas instalimit dhe startimit, do të fitohet figura e paraqitur e MVS 2019.

Pastaj, paraqitet menyja për zgjedhje të mënyrës së startimit të MVS 2019, ***figura 1.5.3.***



Figura 1.5.2



Figura 1.5.3

Fillestarët shpesh i zgjedhin mënyrën e dytë dhe të katërt të startimit.

Me zgjedhjen e mënyrës së katër, hapet menyja për krijimin e projektit të ri, ***figura 1.5.4***. Për fillestarët më e mire është projekt i zbrazët (Empty Projekt), ose aplikacioni komzol (Console App), ku janë paraqitur edhe shembull të programit në C++. Pastaj, klikohet në butonin Next.



Figura 1.5.4

Hapet dritarja për konfigurim të projektit të ri, ***figura 1.5.5.***



Figura 1.5.5

Te ai e futim emrin e projektit të ri, për shembull ProjetNjë dhe do ta shënojmë (me klikim te ai) katrori para Place solution and projekt in the same direktory.

Pas klikimit të butonit Create, fillon krijimi i projektit dhe hapet dritarja prej rrethinë zhvillimore të integruar të MVS 2019, ***figura 1.5.6***. Në atë tregohen edhe program në C++ nën emrin sikurse edhe projekti, ProjektiNjë.cpp. Mbi dhe nën programin ka më shumë sqarime, të cilat këtu nuk do t'i shqyrtojmë.



Figura 1.5.6

Nëse nuk duam të paraqitet program, atëherë prej menysë të ***figura 1.5.4*** duhet të zgjedhim Empty Projekt.

Programi ProjektiNjë.cpp mbyllet me klikimin mbi shenjën x sipas emrit.

Te dritarja Solution Explorer paraqiten projektet të krijuara në PIRr të MVS 2019. Kështu, te ***figura 1.5.6*** paraqitet direktoriumi i projektit ProjektiNjë me nëndirektoriumet e tij.

Me klikun e djathtë ose mbi nëndirektoriumin Source Files prej dritares Solution Explorer dhe zgjedhjes së komandës New Item… prej nënmenysë Add (***figura 1.5.7***), hapet dritarja Add New Item – ProjektiNjë, ***figura 1.5.8***.



Figura 1.5.77

Te korniza e djathtë klikohet te C++ File (.cpp), por pastaj te fusha Name (te pjesa e poshtme) futet emri i programit, për shembull, Përshëndetje.cpp.



Figura 1.5.8

Me klikimin e butonit Add, hapet dritarja për të shkruar dhe redaktuar të programit Përshëndetje.cpp, ***figura 1.5.9***.

Dritarja kryesore

Te ***figura 1.5.9*** është paraqitur dritarja kryesore d.m.th., rrethina themelore për programim në MVS. Ajo i përmban këto dritare:

- Dritare me projekt (Solution Explorer).
- Dritare për të shkruar dhe redaktuar te programet – redaktues.
- Dritarja për paraqitje të rezultateve – dritare dalëse (Output).



Figura 1.5.9

Elementet themelore të dritares kryesore janë:

a) Shiriti me meny



Shiriti me meny rënëse gjendet te pjesa më e lartë e dritares, menjëherë nën titullin e saj. Në atë gjenden menyja File, Edit, View, Projekt, Bu-ild, Debug, Tools, etj. Çdo meny përmban urdhëra për rrethinën dhe/ose meny të tjera.

b) Shiritat për vegla



Shiritat me vegla (buton për startimin më së shpeshti të komandet e shfrytëzuara të rrethinës) gjenden menjëherë nën shiritin me meny rënëse. Veglat te rrethina për programim janë aktive ose jo aktive (të zbehta). Veglat nëpërmjet të cilave jepen shumë komanda dthtas deri tea to kanë shigjetë poshtë ose me klikim në atë, ndarë në grupe, varësisht prej doethënies së tyre.

hapet menyja rënëse. Nëse klikohet në vet veglën, atëherë hapet dritarja nëpërmjet të cilës jepen komandat e njëjta.

Programi i parë C++

Te redaktimi prej ***figura 1.5.9*** mundemi ta shkruajmë edhe redaktojmë programin Përshëndetje.cpp, ***figura 1.5.10***.

Me komandën Compile prej nënmenysë Build (ose me Ctrl + F7), përkthehet program dhe te dalja e dritares (Output) fitojmë porosinën (***figura 1.5.11***) programi a është përkthyer me sukses.



Figura 1.5.10



Figura 1.5.11

Me komandën Start Without Debugging prej nënmenysë Debug (ose me Ctrl + F5), realizohet program dhe rezultati tregohet te dritarja prej ***figura 1.5.12.***



Figura 1.5.12

Për mbyllojen e dritare me rezultate, shtypet çfarëdo buton prej tastaturës.

Për ta ruajtur programin në disk, e japim komandën Save prej nënmenysë File (se Ctrl + S). Për ta ruajtur programin në disk me tjetër emër, e japim komandën Save As prej nënmenysë File.

Në një projekt mund të ketë më shumë programe të shkruara si datoteka. E dimë se çdo datotekë ka emrin dhe prapashtesën. Programet burimore të shkruara me gjuhën C++ kanë prapashtesë.cpp. Domethënë, emrin e çdo programi në C++ mund të jetë: P1.cpp, prog.cpp, ProjektiNjë.cpp, ProgramiIm. cpp etj.

Ushtrime

Ushtrimi 1.5.1

a) Programi Përshëndetje.cpp plotësoni të shikohet si te ***figura 1.5.15.***

Gjatë startimit të MVS 2019 pas herës së dytë (dhe çdo here vijuese), paraqitet faqeja MVS 2019, ***figura 1.5.3***. Nëse duam të hapim ndonjë projekt ekzistues, duhet të klikojmë te linku Open por projekt or solution. Do të hapet dritarja prej ***figura 1.5.13*** për zgjedhje të projektit.



Figura 1.5.13

Me klikimin e ndonjërit projekt, për shembull ProjektiNjë.sln, ai hapet në dritaren Solution Explorer dhe oven të gjitha programet në atë, ***figura 1.5.14.***

Me klikimin e dyfishtë mbi emrin e ndonjë program (për shembull, të Përshëndetje.cpp), ai do të hapet te redaktuesi. Atë e plotësojmë programin Përshëndetje.cpp, sikurse është treguar te ***figura 1.5.15.***

b) Ruaje programin me komandën Save (ose Ctrl + S).



Figura 1.5.14

```cpp
#include <iostream>
using namespace std;

int main() {

    // Programi im i parë Përshëndetje.cpp

    cout << '"Përshëndetje, si je?" << endl;
    cout << "Ky është shembull për program" << endl;
    cout << "që është shkruar në C++" << endl;
    cout << "Me atë kontrollojmë MVS 2019 a punon mirë" << endl;

    system( "pause" );
    return 0;
}
```

Figura 1.5.15

c) Nëse gjatë shkruarjes të programit keni gabuar ndonjë urdhër, gjatë përkthimit të tij, do të paraqitet porosia për gabime te dritarja dalëse. Për shembull, nëse kemi harruar të vendojmë pikëpresje në fund prej urdhrit të fundit, gjatë përkthimit të programit, do të hapet dritarja me listë me gabime (angl. Error List) dhe me raportin për gabime.



Vërejmë se urdhri pas asaj te e cila ka ndodhur gabimi është nënvizuar me vijë valore. Nëse sjellim treguesin mbi vijën, do të tregohet korniza me porosi për gabim.



Te dritarja dalëse (Output) paraqitet urdhri për llojin dhe vendin e gabimit. Pas vendosjes së pikës, programi do të punojë në mënyrë korrekte.



ç) Vijat te program të cilat fillojnë me dy vija të pjerrëta //, shërbejnë për futjen e komenteve te program dhe ato nuk realizohen. Mirë është çdo program në fillim të

ketë komentim për atë që punon. Këtë do ta praktikojmë edhe ne.

Ushtrimi 1.5.2

a) Krijoni edhe një program në projektin ProjektiNjë, për shembull, me emrin Përshëndetje.cpp.

Programi është krijuar me mënrën e njëjtë sikurse edhe program Përshëndetje.cpp, d.m.th., me klikune djathtë mbi Source Files dhe zgjedhja e Add ▶ New Item… Te dritarja që do të hapet (Add New Item – ProjektiNjë) klikohet te C++ File (.cpp) dhe në fushën Name (te pjesa e poshtme prej dritares) futet emri Përshëndetje.cpp. Në fund, klikohet te butoni Add. Te dritarja Solution Explorer, te nëndirektoriumin Source Files do të tregohet emri i programit të ri. Gjithashtu, te redaktuesi do të hapet programi i ri për të shkruar dhe redaktuar.



Vërejmë se edhe program Përshëndetje.cpp është hapur te redaktuesi.

Kalimi prej një program në tjetër te redaktuesi kryhet me klikimin mbi emrin e programit.

Për të mbyllur ndonjë program të hapur te redaktuesi, jepet komanda Close prej nënmenysë File ose klikohet mbi shenjën x djathtas prej emrit të programit.

b) Klikoni mbi titullin prej programit Përshëndetje.cpp dhe ai do të hapet. Selektoni dy komandat e para,



kopjoni me Ctrl + C, klikoni mbi emrin e programit Përshëndetje.cpp dhe vendosni edhe me Ctrl + V.

Vendoni një vjë të zbrazët me Enter dhe shkruani funksionin kryesor me komandat për komentim dhe për shtypjen e porosisë, ***figura 1.5.16.***

```
1   #include <iostream>
2   using namespace std;
3
4   int main() {
5       // Programi im i dytë
6
7       cout << "Emri im është..." << endl;
8       cout << "Mbiemri im është..."  << endl;
9       cout <<"Datëlindja jeme është më..."<< endl;
10
11      system("pause");
12      return 0;
13  }
```

Figura 1.5.16

Ruani programin me Ctrl + S, përktheni me Ctrl + F7 dhe realizoni me Ctrl + F5.

Do të vëreni se gjatë realizimit, paraqitet porosia për gabim te dritarja vijuese.

[10]

Porosia është për atë se gabimi është paraqitur gjatë ndërtimit të projektit. Në një projekt mund të ketë më shumë programe të cilat lidhen në një program realizues (themi se „ndërtohet projekti“), por patjetër të ketë vetëm një program me të cilin fillon realizimit të projektit. Ky është program që e përmban funksionin main() dhe quhet **aplikacioni** (angl. application). Pasi te projekti jonë ProjektiNjë ka dy programe të cilët e përmbajnë funksion main(), paraqitet gabimi i përmendur.

Kjo zgjidhet në mënyra të ndryshme, por njëra është i lehtë të përjashtohen prej projektit të gjitha programet të cilat e përmbajnë funksionin main(), përveç atij program që duam të jetë aplikimi dhe prej të cilit do të fillon realizimi i projektit.

Për ta përjashtuar programin Përshëndetje.cpp, do të klikojmë mbi atë me klikun e djathtë dhe prej dritares do të hapet (Open) e jep komandën:

[10] Nësese klikohet te Yes, do të kryhet program i fundit i realizuar me sukses. Nëse klikohet te No, do të realizohet program i fundit pa sukses.

Do të hapet dritarja Përshëndetje.cpp Property Pages edhe te menyja Excluded From Build prej kornizës General zgjedhet Yes. Pastaj, klikohet te butonët Apply dhe OK, më poshtë djathtas.



Te dritarja Solution Explorer do të vëreni se shenjat ++ para emrit Përshëndetje.cpp janë ndërruar te+–. 

Kjo do të thotë se programi Përshëndetje.cpp është përjashtuar prej projektit dhe se vetëm program Përshëndetje.cpp është aplikimi dhe mund të realizohet.

Ushtrimi 1.5.3

a) Krijoni projekt të ri (te shembulli, ProjektiDy) dhe te ai një program.

Projekti i ri hapet me komandën File ▸ New ▸ Project…



Do të hapet dritarja prej ***figura 1.5.4*** dhe linkohet te linku Empty Projekt ose Console App, sikurse është sqaruar te ***figura 1.5.4*** dhe ***figura 1.5.5***. Te fusha Name prej figura 1.5.5 (te faqes së poshtme) shkruhet emri i projektit, për shembull, ProjektiDy. Në fund, klikhet te butoni Create.

Te dritarja Solution Explorer do të hapet projekti dytë, por i pari do të mbyllet.

Programi te projekti hapet, sipas mënyrë së përmendur te ***Ushtrimi 1.5.2 a.***

Nëse duam të kalojmë te projekti parë (ose te ndonjë tjetër i hapur), atë e zgjedhim prej listës me projekti të krijuara me komandat:

File ▶ Recent Projects and Solutions

Prej listës që do të paraqitet e zgjedhim projektin e dëshiruar.



Rrethina zhvillimore e integruar Code::Blocks

Rrethina e integruar për programimin Code::Blocks mund të gjendet në adresën e internetit: http://www.codeblocks.org/downloads.

Në pjesën qëndrore të faqes ka tre linke: **Download the binary release, Download the source code** dhe **Retrieve source code from SVN**. Për instalimin e thjeshtë, preferohet të zgjedhet linku i parë **Download the binary release**. Pas klikimit të këtij linku,hapet faqeja e re te e cila ka ofruar marrjen e Code::Blocks për sistemin operativ nën të cilin punon kompjuteri Juaj.Për fillestarët preferohet ta shkarkojnë versionin që kyç MinGW setup. Në kohën e të shkruarit e këtij teksti, ai është linku codeblocks-20.03mingw-setup.exe i cili është dedikuar për shfrytëzuesit e të gjithë sistemeve operative Windows. Pas klikimit te lokacioni prej ku duani ta merrni Code::Blocks (për shembull **Sourceforge.net**), hapet faqeja e re, e cila pas kalimit të 5 sekondave vet ofron opsion të ruhet datoteka në lokalitetin të zgjedur prej shfryëzuesit. Pas ruajtjes së datotekës, duhet të përcillen instruksionet për instalim.

Startimi

Gjatë instalimit të Code::Blocks te menyja Programs prej menysë themelore Start, krijohet grupi i programeve me emrin CodeBlocks. Për të startuar rrethina e integruar për programim, duhet të zgjedhet CodeBlocks prej këtij grupi.

Dritarja kryesore

Te dritarja kryesore (***Figura 1.5.17***) e CodeBlocks ka vegla për ruajtje, kërkim, përkthim dhe realizim të programeve, vegla për dibagim etj. Dritarja punuese do t'i sqarojmë në vazhdim.

a) Shiriti me meny

Shiriti me meny gjendet te pjesa më e madhe e dritares, menjëherë nën titullin e tij. Në atë gjenden menyja File, Edit, View, Search, Projekt, Bu-ild, Debug, Fortran, wxSmith, Tools, Tools+, Plugging, Settings, DoxyBlocks dhe Help. Çdo meny përmban urdhëra për rrethinën dhe/ose meny të tjera. Domethënia e shumicës së tyre do të shqyrtohet më tutje.

b) Shiritat për vegla

Shiritat me vegla (buton për startimin më së shpeshti të komandave të shfrytëzuara të rrethinës) gjenden menjëherë nën shiritin me meny rënëse. Veglat te rrethina për programim Code::Blocks janë ndarë në grupe, varësisht prej domethënies

domethënies së tyre.Të treguarit dhe fshehja e grupeve të veglave të ndryshme janë realizuar në mënyrë të ngjashme sikurse te programet e Microsoft Office, me zgjedhjen e opsioneve View ▸ Toolbars. Çdo grup ka emrin e vet dhe nëse para emrit e ka shenjën për shënim, grupi shikohet në ekran, por nëse nuk e ka atë shenjë, ajo nuk shikohet. Çdo vegël korrespondon në disa prej komandave të menys.

Te dritarja kryesore gjendet dritaret e aplikacioneve të rrethinës. Më të rëndësishmet prej tyre janë:

- Te dritarja për redaktim të tekstit – redaktues. Te ai mund të ketë disa programe, varësisht prej asaj në sa programe punon programuesi në momentin e dhënë. Emri i programit është treguar te pjesa e sipërme e dritares për redaktim. Emri i programit që është aktiv në moment është shënuar ndryshe prej emrave të programeve të tjera.
- Dritarja për rezultate – dritare dalëse. Te ai programet japin informata për punën e vet gjatë përkthimit, lidhja, startimi etj. Nëse gjatë përkthimit të jenë zbuluar gabime, atëherë ato tregohen te korniza Build messages të kësaj dritare.
- Dritarja për organizim të punës së programit.
  Dritaret mund të mbyllen, të zmadhohen ose zvogëlohen etj.



Figura 1.5.17

Redaktuesi i tekstit

a) Futja dhe përpunimi i tekstit

Redaktuesi i tekstit i ka të gjitha veglat standarde për futje dhe redaktim të tekstit. Gjatë redaktimit të tekstit, mund t'i shfrytëzojmë pothuajse të njëjtat urdhëra të cilat i kanë redaktuesit e tekstit te programet për punë në zyrë, (sikurse Microsoft Office Word, OpenOffice Writer dhe të tjera). Gjithashtu, vlejnë urdhërat e njëjta për lëvizje të treguesit prej miut.

b) Selektimi, kopjimi dhe zhvendosja e tekstit

Këto operacone janë dhënë nëpërmjet komandës menysë Edit.

c) Kërkimi dhe zëvendësimi

Në shumicën e rasteve mund të ketë nevojë prej kërkesës së tekstit të caktuar nëpër programin, por pas gjetjes, dhe zëvendësimi i tij me tjetër tekst. Ajo realizohet me ndihmën e urdhërave te menyja Search, Find, Replace etj.

Përkthimi dhe realizimi i programeve

Menyja Build përmban urdhëra për përkthim dhe realizim të programeve. Programi përkthehet me komandën Build ▸ Build (ose Ctrl + F9). Si rezultat te dosja te e cila gjendet datoteka me program burimor, krijohet program përkatës. Programi i realizuar starton Run (ose F9).

Për ta realizuar programin, sistemi operativ hap dritare tekstuale, te e cila futen të dhënat hyrëse dhe tregohen rezultatet prej realizimit të programit.

Datotekat të krijuara prej rrethinës

- Datotekat me prapashtesë.cpp i përmbajnë programet burimore dhe fitojnë pas realizimin e komandës File ▸ Save ose Ctrl + S.
- Datotekat me prapashtesë.exe përmbajnë program realizuese ekuivalent të burimores. Ato krijohen gjatë përkthimit të programit burimor.

Vijimi i realizimit të programit

Vijimi i realizimit të programit është mënyrë shumë e rëndësishme për kërksë për gabime logjike te programi. Rrethina Code::Blocks jep mundësi për vijim të atillë. Për këtë qëllim, mund të tregojë rreshta në tekst (të ashtuquajtura pika kontrolluese), te të cilat duam të ndalon realizimi i programit, si edhe ndryshoret përmbajtjen e të cilës duam ta vështrojmë. Kur fillojmë me realizimin e programit në regjim të vijimit, ai punon normalisht ndërsa nuk arrin deri te pika kontrolluese, por pastaj ndalon.

Në atë moment, programuesit mund ta shqyrtojnë përmbajtjen e ndryshoreve të zgjedhura për vështrim. Pastaj, vazhdon realizimi i programit, dhe programuesi mund t'i përcjell vlerat e ndryshoreve të vështruara dhe të kontrollojë se a u përgjigjen vlerave të pritura. Gjithashtu, programuesi mund të len programin të realizojë në mënyrë rregullore deri te pika kontrolli vijuese. Të gjitha komandat e lidhura me vijimin e programit gjatë realizimit janë te menyja Debug.

Vendosja e pikës së kontrollit bëhet kur do të vendoset tregusi i miut te vija e zgjedhur dhe kur do të jepet urdhri Debug ▸ Toggle Breakpoint (ose F5). Do të vëreni se majtas prej vijës vendoset pika e kuqe. Me klikimim e miut te pika e kuqe, ajo largohet. Vijimi i programit fillon me dhënien e urdhrin Debug -> Start. Programi realizohet drejtë deri sa pika kontrolluese ku do të ndalohet, duke vendosur një shigjetë të verdhë te vija. Prej atje vijimi i programit vazhdon nëpërmjet urdhërave të tjera prej menysë, edhe atë:

Debug – Next Step (realizohet vetëm urdhri, pasi që shigjeta e verdhë kalon në vijën vijuese).

Continue (realizohet program deri te pika kontrolluese vijuese ose deri në fund nëse nuk ka pikë kontrolluese).

Step into (shfrytëzohet vetëm për urdhëra te të cilët thirret funksioni dhe është e nevojshme vijimi i funksionit të thirrur).

Vijimi ndërpritet me urdhrin Debug ▸ Stop Debugger.

Gjatë vijimit të realizimit të programir, kjo vijë nuk do të jetë pika kontrolluese, përveç nëse nuk e vendosim treguesin e miut përsëri te ajo dhe nuk e japim komandën Debug ▸ Run to Cursor. Më tej para se të jepet komanda, treguesi duhet të vendoset në fillim të vijës prej të cilës duam të vazhdon vijimi i realizimit të programit.

Ushtrimi

Ushtrimi 1.5.4

Startoni CodeBlocks. Prej menysë zgjedhni krijimin e projektit të ri: File ▸ New ▸ Project ▸ Empty Project ▸ Go, ***figura 1.5.18***.



Figura 1.5.18

Te dritarja vijuese (***figura 1.5.19***) futni „Projekt Titëe", „Folder", „Projekt filename" dhe „Resulting file Name". Për shembull, për titull të projektit futni Projektiparë, por të tjerët fusha leni sikurse që janë.

Pas klikimit Next, te dritarja që hapet (***figura 1.5.20***) zgjidhni GNU GCC Compiler dhe shëno (me klikim

te katrorët (✓)) këto dy opsione për të krijuar konfiguracione „debug“ dhe „release“. Klikoni te butoni Finish.



Figura 1.5.19

Shtoni datotekë burimore te projekti: File ▸ New ▸ File ▸ C/ C++ Source. Pastaj futni emrin e datotekës me shtegun e plotë (për shembull Ushtrimi1) te dosja e veçantë ku është projekti dhe mos harroni ta kyçni „Add file to aktive projekt“.

Për çdo projekt, duhet të vendoset n këto opsione: „Project ▸ Build Options.. ▸ Compiler Flags“.

Me këtë krijuat një projekt që në veti (për tani) përmban një datotekë të zbrazët, e cila është e gatshme në atë ta shkruani Programi juaj i parë.



Figura 1.5.20



Figura 1.5.21

Ushtrimi 1.5.5

a) Te datoteka e hapur prej **Ushtrimit 1.5.4.** futni tekstin e këtij programi:

```
#include <iostream>
using namespace std;

int main()
{
	cout << "Ky është shembull për program";
	cout << "e cila është shkruar në C++.";
	cout << "Me atë e kontrolloj CodeBlocks a punon!\n";
	return 0;
}
```

Figura 1.5.22

b) Ruaje programin me urdhrin File ▸ Save, për shembull, me emrin Ushtrimi1.cpp.

c) Përktheni programin Ushtrimi1.cpp me kontrollin e butonit Ctrl + F9.

ç)) Nëse gjatë futjes së programit Ushtrimi1.cpp, keni lëshuar diçka në lidhje me tekstin e dhënë a), largoni gabimet dhe ruani ndryshimet me shtypjen e Ctrl + S. Pastaj realizoni programin me shtypjen e butonit F9.



Figura 1.5.23

Ushtrimi 1.5.6

a) Krijoni projekt të ri dhe përsëri vendosni programin paraprak. Realizoni.
b) Me qëllim bëni ndonjë gabim te programi. Për shembull, në vend cout, shkruani caut në njërën prej urdhërave për shtypje. Përpiquni tani ta programin. Çka ndodh? Përmirësoni gabimin dhe përsëri realizoni programin.

c) Kopjoje vijën e katërt prej programit dhe vendosni sikurse te vija e pestë. Realizoni programin. Cili është rezultati prej realizimit?

Ushtrimi 1.5.7

Krijoni projekt të ri, shkruani këtë program (***figura 1.5.24***) dhe realizoni:

```
#include <iostream>
using namespace std;

int main()
{
	// Programi im i dytë në C++

	cout << "Emri im është... " << endl;
	cout << "Mbiemri është... " << endl;

	cout << "Ditëlindja ime është... " << endl;

}	return 0;
```

Figura 1.5.24

1.6 Hyrje në C++

Historia e shkurtër e C++

Në vitin 1972 laboratorët „AT&T Bell Labs“ është dizajnuar gjuha C nga ana e Dennis Ritchie (Denis Riçi). Te ai janë inkorporuar veti të cilat nuk i kanë pasur gjuhët programore të atëhershme:

- Lejon qasje deri te resurset në nivel shumë të ulët.
- Është i përshtatshëm për programim sistematik[11].
- Mund të realizohet në platformë të ndryshme kompjuterike.
- Punon nën sistemeve të ndryshme operative.

Në vitin 1980 te gjuha C janë mundësi të shtuara me të ashtuquajturën **klasa** dhe ai version i gjuhës C quhet „C me klasa“.

Zhvillimi i mëtejshëm i këtij versioni, përkatësisht përmirësimi i tyre, ka sjellë deri te gjuha e re në vitin 1983 që quhet C++, pasi paraqet përmirësim të C. C++ paraqet gjuhë për të ashtuquajturën **programimi objekt i orientuar** (angl. objekt-oriented programming).

C++ është dizajnuar prej Bjarne Stroustrup (Bjarne Stroustrup), por qëllimi është:

- të jetë gjuhë për qëllim të përgjithshëm prej gjuhës C,
- të mbështet **të dhëna të llojeve abstrakte**[12] (angl. abstract data types),
- të mbështet programimi objekt i orientuar.

Sot, C++ bën pjesë ndërmjet gjuhëve më të shfrytëzuara për përpunimin e programeve të llojeve të ndryshme, të cilët mund të ndryshojnë prej aplikimeve të dobishme për qëllime të ndryshme, pra deri te veglat sistemore.

Elementet e gjuhës C++

Gjuha C++ ka alfabet, i cili është bashkësia e simboleve të lejuara dhe atë:

- Shkronjat e vogla prej alfabetit anglez: a – z.
- Shkronjat e mëdha prej alfabetit anglez: A – Z.
- Shifrat: 0 – 9.
- Shenjat speciale: ~ ! @ # $ % ^ & * ( ) – + = { } [ ] : ; '...' "..." < > ? /.

[11] Programim në nivel të hardverit.

[12] Këto janë struktura me të cilat mund të pasqyrohet bota reale në program. Për shembull, në një program nund të përkufizon nxënësi, qarqe, drejtkëndësh etj., dhe me ato të realizohen operacione përkatëse, sikurse: njehsim të suksesit të nxënësit, syprina e drejtkëndëshit etj. Me lloje abstrakte të të dhënave punohet në programim objekt të orientuar.

Prej alfabetit të C++ formohen fjalët të cilat mund të jenë:

- Fjalë kyçe (angl. keywords)
- Numerike, simbolike dhe tekstuale konstante,
- Emra (identifikator),
- Operator.

Lloj i veçantë i simboleve janë ndarësit (separatorët) me të cilët ndahen fjalët njëra prej tjetrës. Ato janë:

- Vend i zbrazët (blanko).
- Rresht i ri.
- Tabulator.

Sikurse edhe të gjitha gjuhët e larta programore, ashtu edhe C++ e ka **gramatikën** e vet e cila i përmbana rregullat për ndërtimin e fjalëve dhe urdhërave. C++ Ka bashkësi të caktuar **fjalë të rezervuara**. Disa prej tyre kanë domethënie të veçantë për C++ dhe ato quhen **fjalë kyçe**. Programuesit mund të formjnë fjalë sipas rregullave të caktuara të quajtura **identifikator**. Fjalët e rezervuara nuk mund të jenë identifikator.

Me kmbinime saktë të përkufizuara të fjalëve dhe simboleve, konstruktohen urdhëra të gjuhës. Poashtu, shfrytëzohen rregulla rigoroze të quajtura rregulla sintaksore ose vetëm **sintaksa e** gjuhës. Poashtu përkthimi i programit, me rregullat sintaksore kontrollohet korrektësia e çdo rregulle.

Çdo rregull te program patjetër të ketë saktë domethënie të përkufizuar dhe të shkakton saktë veprime të përkufizuara. Domethënia (kuptimi) i urdhërave quhet **semantika**) e gjuhës.

Për shembull, rregulla sintaksore në C++ për funksionin kryesor (main()) është:

```
int main() {
        urdhër;
        ...
        urdhër;
}
```

Programi në C++

Te ***figura 1.6.1*** është dhënë programi Përshëndetje.cpp që e krijum te pika **1.5 Rrethina zhvillimore e rientuar**, ***figura 1.5.10***.

Programi shtyp në ekran:



Do ta sqarojmë çdo vijë prej programit.

Vija 1: Dirktiva

Direktiva me të cilën kyçet biblioteka **iostream**, e cila përmban funksione për operacione hyrëse dhe për dalëse te programi.

Vija 2: Direktiva

Direktiva për formimin e hapësirës emërore (varg) të emrave.

Vija 3, 7 dhe 9: Vija e zbrazët.



Figura 1.6.1

Vijat e zbrazëta shërbejnë për pamje më të madhe të programit, por përkthyesi i injoron.

Vija 4: Funksioni kryesor.

Programet në C++ përbëhen prej **funksioneve**[13]. Çdo program në C++ patjetër të ketë vetëm një funksion kryesor të quajtur main() dhe patjetër të jetë deklaruar, sikurse që është te shembulli. Fjala int do të thotë se funksioni main() kthen rezultatin numër të plotë. Më vonë do të shikojmë se mund të deklarohen edhe funksionet të cilat nuk kthejnë rezultat.

Vija 4: Pjesa hyrëse e kllapave të mëdha – fillimi i funksionit.

Pjesa hyrëse e kllapave të mëdha sipas funksionit main(), paraqet fillim zë **trupit të funksionit**. Trupi i çdo funksioni mbaron me pjesën dalëse prej kllapave të mëdha, në shembullin tonë, ai është pjesa dalëse prej kllapave te *Vija 12*. Vijat e trupit të funksionit (*Vija 6 deri te Vija 11*) futen djathtas dhe atë e quajmë **dhëmbëzim** (angl. indentation).

Pjesa hyrëse prej kllapave të mëdha me të cili fillon funksioni mund të vendohet edhe te kjo *Vijë 5*.

Vija 6: Komentim

```
// Programi im i parë Përshëndetje.cpp
```

Praktikë e mire programore është programet të komentohen. Prandaj, është e preferueshme në fillim të çdo programi të vendohet **komenti** për atë që punon program. Komentet janë të dobishme edhe në fillim të çdo funksioni.

Te program i dhënë, *Vija 6* nuk i tregon asgjë përkthyesit dhe ai nuk e përkthen. Prandaj, ajo vijë quhet komentim. Komentimi është tekst i cili është shfrytëzuar për atë i cili e lexon programin dhe është dedikuar për pamje më të madhe dhe të kuptuarit.

[13] **Funksioni** te gjuha programore është program i cili pas realizimit jep rezultate. Për shembull, funksioni për shumëzim të dy numrave, për pjesëtim të dy numrave, për gjetje të rrënjës katrore prej numrit etj.

Gjithashtu, komentimet shfrytëzohen edhe për programues të tjerë të cilët duhet ta përmirësojnë, ndryshojnë ose përmirësojnë programin. Shpesh ndodh programuesi të fut koment te program me qëllim të mund më lehtë ta kupton kur më vonë vet ai do ta shqyrton.

Vëreni se çdo koment fillon me dy viza të pjerrta //. Domethënë, çdo gjë që do të shkruhet pas // deri në fund të vijës paraqet koment.

Gjatë përkthimit të programit, përkthyesi i injron (nuk i përkthen) komentet.

Vija 8: Urdhri për shtyp.

```
cout << "Përshëndetje, si jeni? " << endl;
```

`cout`	– urdhri për shtypje
`<<`	– operatori për shtypje
`"Përshëndetje, si jeni?`	– tekst i cili shtypet
`" endl`	– urdhër për fund të vijës aktuale
`;`	– shenja për fund të urdhrit, përkatësisht ndarës të urdhërave.

Vërejmë se atë që e dum të shtypet e vendojmë në thonjëza. Shpesh, në kllapa vendohet ndonjë tekst, që paraqet **varg prej shenjave** dhe quhet **string**[14] (angl. string).

Vija 10: Urdhri për pause.

Urdhri për pause para së gjithash të mbyllet dritarja me rezultate. Ky urdhër nuk është i detyrueshëm, por është i dobishëm nëse duam t'i shikojmë rezultatet e deritanishme.

Vija 11: Urdhri për kthimin e vlerës

Nëse vlera që e kthen është 0 (sit e shembulli yn), domethënë se program në mënyrë korrekte realizohet. Nëse kthehet çfarëdo tjetër vlerë (1, 2...), domethënë se diçka ka qenë e gabueshme gjatë realizimit të programit. Ne do ta shfrytëzojmë urdhrin **return 0**.

Vija 12: Pjesa dalëse prej kllapave të mëdha për fund të funksionit main().

Vijat 1 dhe 2 patjetër të kyçen në çdo program C++.

Funksioni main() ka frmë standarde:

```
int main() {
        Urdhri;
        ...
        Urdhri;
        return 0;
}
```

[14] Më vonë d të sqarojmë çka janë stringe dhe si shfrytëzohen.

Programet në C++ mund të shkruhen me çfarëdo redaktues të tekstit. Pastaj, përkthehen dhe realizohen, varësisht prej rrethinë zhvillimore të integruar.

Urdhri për shtypje

Theksuam se urdhri për shtypje të stringeve ka formë:

```
cout << "Përshëndetje, si jeni?" << endl;
```

Domethënë, nëse duam të shkruajmë diçka në ekran, thjeshtë prej *Vijës 8* te program prej ***figura 1.6.1*** do të shtojmë edhe urdhëra, sikurse që është bërë te ***figura 1.6.2***, njëjtë me ***figura 1.5.15***.

```
1   #include <iostream>
2   using namespace std;
3
4   int main() {
5
6       //  Programi im i parë Përshëndetje.cpp
7
8       cout <<"Përshëndetje, si jeni"_<< endl;
9       cout <<"Ky është shembull për program"  << endl;
10      cout << "që është shkruar në C++"     << endl;
11      cout <<"Me këtë kontrollojmë se MVS 2019 a punon mirë"          << endl;
12
13      system( "pause" );
14      return 0;
15  }
```

Figura 1.6.2

Pas realizimit të programit, do ta fitojmë këtë dalje:

```
Përshëndetje, si jeni?
Ky është shembull për program
që është shkruar në C++
Me këtë kontrollojmë se MVS 2019 a punon mirë
Press any key to continue..
```

Vërejmë se çdo string te urdhërat shtypet në rresht të ri. Kjo arrihet në atë mënyrë që në fund urdhri cout vendohet në të ashtuquajturën manipulator endl[15].

Kjo do të thotë se urdhri vijues për shtypje e cila në fund e ka manipulatorin endl, do të shtype në vijën e re (rreshti i ri).

Për shtypjen në vazhdim në vijën e njëjtë, urdhri paraprak nuk duhet të ketë në fund endl.

Për shembull, nëse urdhri te Vija 9 prej ***figura 1.6.2*** në fund nuk ka endl, atëherë do të shtypet:

[15] Në C++ ekzistojnë më shumë manipulator (funksione ndihmëse) për kontroll të futjes dhe të shtypjes të të dhënave.

```
Përshëndetje, si jeni?
Ky është shembull për program që është shkruar në C++
Me këtë kontrollojmë se MVS 2019 a punon mirë
Press any key to continue . . .
```

Sikurse vërejmë, fjala e fundit prej urdhrit të dytë dhe fjala e parë prej urdhrit të tretë janë bashkuar. Për t'u ndarë duhet të lihet vend i zbrazët në fund të stringut prej urdhrit të dytë ose fillimit të stringut prej urdhrit të trtë.

Urdhërat te Vijat 8, 9, 10 dhe 11 ndonjëherë quhen edhe **gjykime**. Mund të vëreni se çdo gjykim mbaron me pikëpresje (;).

Vërejmë se urdhri për shtypje fillon me fjalën cout (lexohet „si aut"), pas të cilit vijjnë operatori për shtypje <<, të quajtur **operator për futje** (angl. insertion operator) dhe shprehja që shtyp. Në rastin tone, shprehja paraqet varg prej shenjave (string), që shtypet në pajisjen dalëse standard te kompjuteri, zakonisht në ekran.

Forma e përgjithshme për shtypje është:

```
cout << shprehje ;
```

Operatori << është operator binary operandi i majtë i të cilit është fjala cout, por operandi i djathtë është shprehja që duhet të shtypet.

Operatori << mund të shfrytëzon shumë herë në urdhrin e njëjtë. Për shembull:

```
cout << "Përshëndetje, si jeni? " << "Ky është shembull për program. " << endl;
```

Poashtu, të dy stringet do të shtypen në vijën e njëjtë:

```
Përshëndetje, si jeni? Ky është shembull për program
```

Në një vijë mund të shkruhen shumë urdhëra për shtypje, ku do të jenë ndarë me shenjën pikëpresje. Për shembull, nëse urdhërat te Vijat 9 dhe 10 prej programit te ***figura 1.6.2*** i shkruajmë në një vijë:

```
cout << "Ky është shembull për program. "; cout << "që është shkruar në  C++."
<< endl;
```

dalja do të jetë krejtësisht i njëjtë.

Me një urdhër për shtypje, mundemi të shtypim më shumë stringe, sikurse është treguar te ***figura 1.6.3***. Poashtu, nëse urdhri është i gjatë, mundemi ta hedhim te rreshti vijues me shtypjen e butonit Enter para ose pas operatorit <<.

Rezultati i realizimit të programit do të jetë:

```
Autor i librit Kalesh Angja është Stale Popov
Ose, me 2 urdhëra
Autor i librit Kalesh Angja është Stale Popov
ose, me më shumë urdhëra
Autor i librit Kalesh Angja është Stale Popov
Press any key to continue . . .
```

```
1   #include <iostream>
2   using namespace std;
3
4   int main() {    // Shtypja e stringeve
5
6       cout << "Autor i librit"   << " " <<  "Kalesh Angja"
7           << "është" <<"Stale Popov" << endl;
8       cout <<"ose, me 2 urdhëra" << endl;
9       cout <<"Autor i librit"   << " " <<  "Kalesh Angja"
10      cout <<"është"<< "Stale Popov" << endl;
11      cout <<"ose, me më shumë urdhëra"<< endl;
12      cout <<"Autor i librit";
13      cout << "   ";
14      cout <<"Kalesh Angja";
15      cout << "është";
16      cout <<"Stale Popov" << endl;
17
18      system( "pause" );
19      return 0;
20  }
```

Figura 1.6.3

Pasi titujt e librave shkruhen në thonjëza, për t'u shtypur thonjëzat „...“, para tyre vendohet vija e pjerrët e kundërt, \ d.m.th., \"...". Stringu "Kalesh Angja" duhet të shkruhet "\"Kalesh Angja\"".

Gjithashtu, për shtypjen te vija e zbrazët jepet komanda: :

```
cout << endl;
```

Me kto ndryshime te program, dalja do të jetë:

```
Autor i librit    Kalesh Angja   është  Stale Popov
ose, me 2 urdhëra
Autor i librit    Kalesh Angja   është  Stale Popov
ose, me më shumë urdhëra
Autor i librit  Kalesh Angja   është  Stale Popov
Press any key to continue..
```

Shpesh, ndonjë string më i gjatë ta shtypim në më shumë vija. Për këtë qëllim, shfrytëzohet sekuenca speciale \n, e cila mundëson pas asaj të shtypet në vijën vijuese. Për shembull, nëse duam shtpim:

```
Autor i librit
"Kalesh Angja"
është
Stale Popov
```

kjo mund të bëhet me një urdhër:

```
cout << "Autor i librit \n\"Kalesh Angja\" \jo\nStale Popov" << endl;
```

Te urdhri vijues shfrytëzohen sekuencat \" për shtypje në thonjëza dhe \n për kalimin dhe shtypjen në vijë të re.

Në C++ ekzistojnë më shumë të ashtuquajtura **eskejp sekuenca** (angl. escape sequences).

Do të përmendim disa:

\n Kalimi në vijë të re.
\" Shtypja në thonjëza "...".
\' Shtypja në gjysmëthonjëza '...'
\t Kalimi në pozitën vijuese të tabulatorit.
\\ Shtypja në vijën e pjerrtë të kundërt \.

Urdhërat për shtypje në programin prej ***figura 1.6.3*** janë renditur njëra pas tjetrës. Ato saktë ashtu edhe do të jenë realizuar prej kompjuterit, së pari e para, pastaj e dyta, pastaj e treta etj., d.m.th., urdhërat do të jenë të realizuara sipas renditjes sikurse janë renditur. Struktura e këtillë prej urdhërave të njëpasnjëshme quhet **strukturë e renditur** ose **sekuenca** (angl. sequence).

Për shembull, me këtë program

```
1   #include <iostream>
2   using namespace std;
3
4   int main() {
5       //  Shembulli strukturë rendor-sekuenca
6
7       cout << "    *" << endl;
8       cout << "   * *" << endl;
9       cout << "  * * *" << endl;
10      cout << " * * * *" << endl;
11      cout << "* * * * *" << endl;
12      cout << " * * * *" << endl;
13      cout << "  * * *" << endl;
14      cout << "   * *" << endl;
15      cout << "    *" << endl;
16
17      cout << endl;
18      system("Color 17");
19      system("pause");
20      return 0;
21  }
```

Figura 1.6.4

me strukturën rendore të urdhërave, do të shtyp figurën:

```
    *
   * *
  * * *
 * * * *
* * * * *
 * * * *
  * * *
   * *
    *
Press any key to continue . . .
```

Te program e shtojmë urdhrin sistem („Color 17“); me të cilin vendoset ngjyra e kaltër prapa (numër 1) dhe ngjyra e bardhë te teksti (numri 7) për pamje më të këndshme të paraqitjes së rezultateve. (Lexuesi mund të eksperimenton me këtë urdhër

ku numri i parë është ngjyra e pjesës së prapme, por numri i dytë është ngjyra e tekstit. Numrat mund të jenë cilido kombinim i 16 numrave heksadhjetore të para: 0, 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, A, B, C, D, E, F).

Te shembujt tonë do t'i shfrytëzojmë 4 urdhërat e fundit.

Detyra për ushtrime

1. Te program i ***figura 1.6.4***, te urdhri:
```
system("Color 17");
```
ndryshoni numrat e ngjyrës të pjesës së prapme (tani është 1) dhe numrat e ngjyrës së tekstit (tani është 7), të clët mund të jenë 0, 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, A, B, C, D, E, F. Zgjedhni kombinim që më së shumti Ju pëlqen.
2. Shkruani program që në ekran do ta japë këtë dalje:
```
     *
    * *
   *   *
  *     *
 *       *
* * * * *
```
3. Shkruani program që në ekran do ta shkruan emrin Tuaj me shenjën * se me tjetër shenjë.
4. Të shkruhet program që do t'i shtypë emrin Tuaj, por te rreshti i dytë do t'i shtyp emrin dhe mbiemrin Tuaj, por te rreshti i dytë do t'i shtyp numrin e viteve Tuaja.
5. Përmirësoni programin paraprak të shtyp sa muaj jeni rritur në vend sa vjet jeni rritur. Për shembull, nëse keni lindur në maj të vitit 2003, por tani jemi tror i vitit 2020, atëherë jen rritur (17 vjet) x (12 muaj) + (10 (tetor) – 5 (maj)) muaj.
6. Të shkruhet programi që do ta shtyp rezultatin prej shumëzimit të 1 234 me 5 678. Kontrolloni a keni fituar rezultat të saktë me ndihmën e kalkulatorit.
7. Të shkruhet programi që do ta shtyp rezultatin prej shumëzimit të 123 456 me 7 891 011. Çka keni fituar si rezultat? Ky rezultati a është i saktë?

Madhësitë dhe të dhënat

Theksuam se algoritmet janë mënyra për përpunimin e të dhënave, përkatësisht me ato përpunohen të dhënat hyrëse sipas renditjes rigoroze të shkruar dhe fitohen rezultatet dalëse. Me imponimin e pyetjes çfarë rezultate mund të përpunohen me algoritmet. Prandaj, të vërejmë çka janë të dhëna.

Madhësia është masa për ndonjë karakteristikë të lëndës ose dukurisë së dhënë. Për shembull, këto karakteristika kanë madhësi të vet: gjatësia, vëllimi, masa, ngjyra, mosha, shpejtësia etj. Madhësitë kanë vlera të cilat shprehen në masa ose vlera prej ndonjë bashkësie. Për shembull: cm është masa për gjatësi, m^3 është masa për

vëllim, kg është masa për masën, viti është masa për moshën, m/sek është masa për shpejtësinë etj.

Vlerat me të cilat shprehen madhësitë quhen **të dhëna**. Domethënë, të dhënat kanë vlerë. Për shembull, gjatësia e hapit të njeriut është 70 cm, vëllimi i kubit me brinjë 2 cm është 8 cm^3, mosha e profesorit të informatikës është 47 vjet etj. Të dhënat përpunohen me algoritme, d.m.th., programe.

Konstanta dhe ndryshoret

Në shumicën e rasteve e dhëna, d.m.th., vlera e ndonjë madhësie, nuk ndryshon. Për shembull, vlera e numrit $\pi = 3.14$ është fiks dhe prandaj themi se ai është **konstanta** (angl. konstant).Vlerat fikse quhen **literale** (angl. literals)[16]. Në çdo gjuhë programore ka literale të ndërtuara të cilat mund të shfrytëzohen si konstante te programet.

Për shembull, konstanta π në gjuhën programore C++ mund të shkruhet me PI dhe mund të shfrytëzohet te frmula[17], si:

```
perimetri  = 2 * r * PI;     syprina  = r * r * PI;    // * është shenjë për shumëzim
```

Por programuesit te programet mund të japin (emërtojnë) konstantet e veta. Për shembull, nëse te program shfrytëzohet emri i shtetit tonë, atëherë ajo do të jepet si konstante me emrin shteti dhe vlera `"Maqedonia"`[18]. Ose, mund të shfrytëzohet konstanta muaj, të cilat mund të pranon vlerë 12 ose ndonjë vlerë tjetër. Konstantat e këtilla, të cilat i përkufizojnë dhe emërtojnë programuesit dhe te të cilat mund t'u shoqërohet vlerë, quhen **konstante të emërtuara** (angl. named konstants).

Për dallim prej konstantëve, vlera e të dhënave për disa madhësi ndryshon. Për shembull, mosha e ndonjë njeriu, koha gjatë ditës, shpejtësia e ndonjë automobili etj., mund të fitojnë vlera të ndryshme dhe prandaj, themi se të dhënat e atyre madhësive janë ndryshore. Themi se vitet e vëllait tim janë 10, vitet e mija 17, vitet e qenit janë 5 etj. Domethënë, 10, 17 dhe 5 janë vlerat e të dhënës së moshës. Domethënë, mosha është e dhënë që mund të ketë vlera të ndryshueshme. Të dhënat e këtilla, të cilat mund të kenë vlera të ndryshme, quhen **ndryshore** (angl. variables).

Gjatë përpunimit të të dhënave me ndihmën e kompjuterit, konstantat dhe ndryshoret kanë emrat e tyre, Vlerat e tyre duhet të futen dhe të mahen mend

[16] Te programet mund të shfrytëzojmë literale të ndryshme, d.m.th., vlera fikse të të dhënave. Për shembull: Nxitimi i tokës, numri amë i qytetarit, emri i ndonjë qyteti etj.

[17] Konstantat në C++ shkruhen me shkronja të mëdha (të gjitha shkronjat janë të mëdha).

[18] Nëse literali është tekst, atëherë vendohet vetëm në thonjëza.

ndërsa përpunohen. Për shembull: numriPi, numriE, mosha, shpejtësi, ngjyra etj.

Nëse e dhëna është konstante, atëherë te lokacioni i memories nën emrin e dhënë (për shembull, numriPi) vlera nuk ndryshon për kohën e realizimit të programit.

Nëse, tani, e dhëna është ndryshore, atëherë vlera e lokacionit të memories te e cila është shkruar ndryshorja nën ndonjë emër (për shembull, mosha) ndryshon. Për shembull, mosha = 17, mosha = 20 etj. Themi se vlera e të dhënës është ndrshore dhe prandaj, e dhëna mosha quhet ndryshore.

Formulat matematikore shpesh kyçin në vete ndryshore. Themi se te funksioni y = f(x), x dhe y janë ndryshore pasi për dallim vlera e x fitohet vlerë e ndryshme e y. Ose, te formula për njehsimin e syprinës së drejtkëndëshit me brinjë a dhe b (S = a * b), brinjët a dhe b janë ndryshore. Ndonjëherë, te formulat janë kyçur edhe konstante. Për shembull, te formula për syprinën e rrethit është S = r * r * PI. Te formula mund të paraqitet edhe numër si konstante. Për shembull, V = 4 * r * r * r * PI / 3.

Me gjuhët programore mund të përpunohen të dhëna të ndryshme, vlerat e të cilave janë shprehur me:

- numra të plotë (… –2, –1, 0, 1, 2, 3…),
- numra real (… –2.34… –1.89… 0… 0.573… 123.45…),
- shenja[19] ('?', '*', '@', '7', '+'…),
- tekste[20] (`"Macedonia"`, `"Sot është shekulli 21"`, `"Informatika"`…),
- igura, zëri etj.

Themi se ato janë të dhëna prej **llojit** të ndryshëm (angl. type). Përveç llojit të dhënat kanë **emër** dhe **vlerë**. Prandaj, themi se të dhënat i kanë këto karakteristika:

- Emër.
- Lloj.
- Vlerë.

Sipas vlerës që u shoqërohet ndryshoreve, themi se ato janë të llojit. Për shembull, ndryshorja mosha (nëse shprehet në vite) është prej **lloj numër i plotë** pasi mund të marrë vlera vetëm numra të plotë: mosha = 18, mosha = 10, mosha = 123 etj. Ngjashëm, ndryshorja syprina (syprina e rrethit) është prej llojit real pasi merr vlera të numrave dhjetorë, syprina = = ($3^2 \cdot PI = 9 \cdot 3.14 = 28.2735$). Ndryshorja prej **llojit të shenjave** (mund të fitojë vlerë çfarëdo shenje e venduar në gjysmë thonjëza) është `shenjë = '+'`, ndryshore prej **llojit tekstual** (mund të marrë vlerë çfarëdo tekst në thonjëza) është `shtet = "Maqedonia është e përjetshme"` etj.

[19] Shenjat te gjuhët programore shënohen me gjysmëthonjëza.
[20] Tekstet te gjuhët programore shënohen e thonjëza.

Emrat e të dhënave

Emrat (identifikatorët[21]) e të dhënave në C++ mund të jenë:

- Fjalë kyçe ose të rezervuara[22].
- Emra e dobishëm të përkufizuar.

Fjalët e rezervuara kanë domethënie specifike dhe zbatim. Të atillë janë: const, double, float, int, strukt, unsigned, break, continue, else, for dhe të tjerë.

Emrat e dobishëm të përkufizuar janë formuar prej shfrytëzuesve (programuesve) me respektimin e këtyre rregullave:

- Emri fillon me shkronjën (A – ZH, a – zh) ose me vizë të tërhequr (_).
- Gjatësia e emrit është i pakufizuar.
- Shkronjat e vogla dhe të mëdha dallohen. Për shembull, unë dhe Unë janë emra të ndryshëm.
- Emri mund të përmbajë edhe shkronja të vogla dhe të mëdha prej alfabetit, shifra 0 – 9 dhe vizë e tërhequr.
- Emri nuk guxon të përmbajë vend të zbrazët.
- Emri nuk guxon të përmbajë shenjë special, sikurse: !, @, #, $, ^ etj.
- Emri nuk guxon të jetë fjalë kyçe ose e rezervuar.

Për shembull, emrat e drejtë të të dhënave janë:

```
a, A1, iTi, i2j3,, _emri, rrezja, R, numër_120, _char, TiMëso.
```

Emra jo të drejtë të të dhënave janë:

```
5_shi       - Emri nuk mund të fillon me shifër.
do$lar      - Emri nuk guxon të përmbajë shenjë speciale.
i 2         - Nuk është lejuar vend i zbrazët te emri.
char        - Nuk mund fjalë e rezervuar të jetë identifikator.
```

Për emrat e të dhënave nuk preferohen fjalë të rezervuara ose fjalë të ngjashme të rezervuara se fjalë të cilat përmbajnë fjalë të rezervuara.

Për shembull:

```
CHAR        – E ngjashme me fjalën e rezervuar char.
_float      – Përmban fjalë të rezervuar float.
__          – Dy viza të tërhequra
```

[21] Identifikatori (angl. identifier) ven prej fjalës identifikim, që d të thotë konstatimi i identitetit. Emrat e të dhënave shërbejnë për konstatim që është e dhënë dhe prandaj, quhen identifikator.

[22] Fjalët kyçe kanë domethënie special te gjuha. Fjalët e rezervuara për gjuhën dhe nuk mund të shfrytëzohen sikurse identfikator.

Llojet e të dhënave

Lloj i të dhënës paraqet bashkësi të fundshme mbi ndonjë bashkësi të përkufizuar të fundshme të operacioneve[23]. Vlerat e çdo lloj të të dhënave shkruhen në lokacione aq të memories sa është e caktuar me gjuhën për atë lloj. Prej këtu, shpesh thuhet se lloj i të dhënës tregon se si të interpretohet përmbajta e një ose më shumë lokacione të memories së njëpasnjëshme te e cila janë vendosur vlera e ndonjë të dhëne.

Në C++ ekzistojnë tre lloje të të dhënave:

- Të thjeshta (të pa strukturuara).
- Tëpërbëra (të strukturuara).
- Të adresave.

Llojet e të dhënave		
Të dhënat e thjeshta (të pa strukturuara)		
	Integrale[24]	
	numra të plotë	short, int, long, long long
	me shenjë	char
	logjike	bool
	real	float, double, long double
	i numërueshëm	enum
Lloje të përbëra (të strukturuara)		
	vargu	array
	struktura	struct
	unioni	union
	klas	class
Të adresave		
	tregues	pointer
	referencë	reference

Llojet e thjeshta ose **të pastrukturuara të të dhënave** janë ato të cilat nuk mund të ndahen në pjesë. Për shembull, 123, –456, 1234567890, 'W', 123.45 etj. janë të thjeshtë (të pastrukturuara, të pandara) të të dhënave, Ndërsa, "Ti"është e dhënë e strukturuar të llojit vargu tekstual[25], i cili përbëhet prej dy shenjave (të thjeshtë, të pastrukturuar) të të dhënave 'T' dhe 'i'. Prandaj, themi se **llojet e përëbërë (të strukturuarat) të të dhënave** përbëhen prej më shumë llojeve të thjeshta.

[23] Do të sqarojmë në vazhdim.
[24] Lloje integrale janë ato të cilat paraqesin një tërësi, d.m.th., nuk ndahen.
[25] Do të sqarojmë më vonë.

Të dhënat e llojit të adresave janë ato vlera e të cilëve është adresa e ndonjë lkacioni të memories[26].

Lloj i numrit të plotë të të dhënave dhe lloj i shenjës mund të jenë edhe të pashënuar (angl. unsigned):

```
unsigned[27] short
unsigned int
unsigned long
unsigned long long
unsigned char
```

Fjalët short, int, long, char, bool, float, double, enum, signed dhe unsigned janë të ashtuquajtura **lloje të specifikatorëve** (angl. type specifiers).

Lloj me numër të plotë, real, me shenja dhe logjike quhen edhe **lloje primitive të të dhënave** (angl. primitive data types) ose lloje themelore të të dhënave (angl. fundamental data types). Ato janë **ndërtuar në lloje të të dhënave** (angl. built-in data types).

Në vazhdim, shkurt do t'i sqarojmë llojet numra të plotë, real, me shenja dhe tekstuale të të dhënave.

Lloj numër të plotë të të dhënave janë vlera të numrave të plotë pozitiv dhe negativ {... –2, –1, 0, 1, 2... } prej saktë nënbashkësisë së caktuar për çdo nënlloj (short, int, long, long long). (Shiko ***tabelën 1.7.1, 1.7.2, 1.7.3***).

Lloj real i të dhënave janë vlerat e numrave real pozitiv dhe negative, d.m.th., numrat dhjetor {... –2.0..., –2.001..., –1.0..., 0.0..., 1.0..., 2.0... } prej saktë nënbashkësi të caktuar për çdo nënlloj (float, double, long double).

Lloj e shenjë të të dhënave janë vlera prej bashkësisë së shenjave, edhe atë: shkronja, shifra dhe shenja speciale. Gjatë shfrytëzimit të tyre si vlerë, vendohen te gjysmëthonjëzat për t'u dalluar prej shenjave të tjera të njëjta. Për shembull, numri i plotë 5 dallohet prej shenjës '5'. Të dhënat karakteristike të shenjës është një vend i zbrazët ' '.

Bashkësia e të dhënave të shenjave është saktë e renditur në të ashtuquajturën tabela ASCII (American Standard Code for Information Interchange), te e cila çdo shenjë ka paraardhësin e vet (përveç të parit) dhe pasardhësin e tij (përveç të fundit), (Shiko **Shtesa B: Shenja ASCII**).

Me lidhjen e të dhënave me shenjë, formohen varg (sekuenca) prej shenjave, të cilat trajtohen si lloj i veçantë i të dhënave të quajtura stringe.

Për t'u dalluar prej konstantave dhe prej ndryshoreve te program, stringet shkruhen në thonjëza.

[26] Do të sqarojmë më vonë.

[27] Unsigned do të thotë se të dhënat janë vetëm numra pozitiv dhe numri 0, d.m.th., nuk mund të kenë vlera negative.

Për shembull:

```
"C++ Bazat e programimit "
"Maqedonia"
"2020"
"E hënë, viti 21.06.2045 "
" "       // Ky është string me një vend të zbrazët – string blank (angl. blank).
""        // Ky është string i zbrazët (angl. null string) dhe dallohet
          // prej stringut blank.
"Stringu patjetër të shkruhet në një vijë dhe të mbarojë me thonjëza, nuk guxon
të kalon në rresht të rë, pasi ky është string"
```

Vëreni se i fundit prej shembujve nuk është string. Nëse stringu patjetër të jetë më i gjatë prej një vije, ai ndahet në më shumë stringje, të cilët lehtë bashkohen me shenjën +.

Për shembull, me shprehjen:

```
"Maqedonia" + " " + "2020"
```

do të fitohet stringu "Maqedonia 2021".

Ky operacion me stringje quhet **bashkim** (angl. concatenation).

Stringjet paraqein lloje të përbëra (të strukturuara) të të dhënave. Lloj tyre në C++ shënohet me **string**.

Stringjet nuk janë lloj i përkufizuar i të dhënave te gjuha C++, por janë të kyçur te **biblioteka standard e C**++ (angl. C++ Standard library).

Deklarimi i konstantave dhe ndryshoreve të të dhënave

Për t'u përpunuar të dhënat me ndonjë program, ato duhet të gjenden në memorien punuese të kompjuterit. Programi patjetër të dijë në cilën adresë te memoria gjendet çdo e dhënë dhe sa lokacione të memories zen. Thamë se numri i lokacioneve të memorisë që zënë ndonjë të dhënë varet prej llojit të tij, (shiko t***abela 1.7.1, 1.7.2, 1.7.3***). Prandaj, për të ditur përkthyesin cila e dhënë prej cilit lloj është, përveç të dhënës, patjetër të shkruhet edhe lloj i tij. Kjo mënyrë quhet **deklrimi i të dhënave** (angl. data dec-laration). Gjatë deklarimit, për çdo të dhënë jepet emri dhe lloj i tij. Nëse gjatë deklariit jepet edhe vlera fillestare e të dhënës, ajo quhet deklarimi dhe **inicializimi** (angl. deklaration and initialization).

Para se të shfrytëzohet ndonjë konstante ose ndryshore te programi (në operacione të ndryshme, sikurse: njehsim, kopjim, shtypje etj.), ai patjetër të jetë deklaruar. Gjatë përkthimit, përkthyesi rezervon memorie përkatëse për çdo konstante dhe ndryshore të deklaruar (sipas llojit) ose rezervon dhe vendos vlerë te lokacioni nëse kryhet deklarimi dhe inicializimi. Poashtu, programuesit dinë te cili lokacion i memories gjenden të dhënat, por përkthyesi e lidh lokacionin me emrin e konstantes ose ndryshorja (identifikatori) i të dhënës.

Thamë se të dhënat mund të jenë konstanta dhe ndryshore.

Konstante janë ato identifikator vlera e të cilit (përmbajtja e lokacionit te memoria) nuk ndryshon për kohën e realizimit të programit. (Nëse përpiqemi ta ndryshojmë vlerën e ndonjë konstante, do të paraqitet gabimi).

Konstantat deklarohen me fjalën const sipas të cilit përmendet lloj i emrit, por pastaj patjetër të shoqërohet vlera me operatorin për shoqërim =:

const *lloj emri* = *vlera*; [28]

Për t'u dalluar konstantat prej ndryshoreve, shfrytëzohet praktika ato të shkruhen me shkronja të mëdha, por fjalët të ndahen me vizë poshtë.

Shembuj :

```
const int M = 12;                          // Muaj në vit
const float NXITIMI_TOKËS  = 9.81;
const double NUMRI_PI = 3.1415;
const char DA = 'D';
const string DATA  = "E hënë, 21.06.2036";
```

Konstanta M është i llojit int dhe te lkacioni i tij mund të vendohet vetëm vlera numër i plotë. Konstanta DA është i llojit char, që do të thotë se vlera që mund t'i shoqërohet patjetër të jetë shenjë. Me të tjera fjalë, lloj konstanta cakton çfarë vlere mund të marrë konstanta.

Gjithashtu, është shumë e dobishme pas konstantes të shkruhet koment, nëse ajo është e nevojshme pas konstntes të shkruhet koment, nëse ai është i nevojshëm, që të dihet çka është ajo konstante.

Ë vërejmë edhe se gjatë deklarimit të konstantes, ajo patjetër të inicializohet. Nëse inicializohet pas deklarimit, do të paraditet gabimi.



Ndryshoret janë ato identifikator vlera e të cilit (përmbajtja e lokacionit te memoria me të cilën është lidhur emri i tyre), mund të ndryshojë.

Ndryshoret deklarohen me:

lloj emri;

ose:

lloj emri = *vlera*;

ose:

lloj emri = *shprehje*;

[28] Te përkufizimet e përgjithshme do të shfrytëzojmë shkronja të pjerrëta. Shprehjet prej një fjale do tÇi shkruajmë me fjalë të bashkuara, por shprehjet prej më shumë fjalëve (si lista) do t'i shkruajmë me fjalë të bashkuar me vijë të poshtme.

Mënyra e fundit paraqet njëkohësisht deklarim de inicializim (shoqërim të vlerës fillestare) të ndryshore. Vlera e ndryshores së inicializuar mund të (më vonë) të ndryshojë kudo në program, me urdhrin për shoqërim të vlerës së ndryshores.

Që të mund të shfrytëzojmë te program, ndryshorja patjetër të jetë **përkufizuar**. Ajo përkufizohet me shoqërim të vlerës gjatë deklarimit (me inicializim) ose me urdhër për shoqërim.

Peratori standard për shoqërim të vlerës së ndryshores është e =. Ana e djathtë gjatë shoqërimit mund të jetë vlerë ose shprehje.

Urdhri për shoqërim vlere të ndryshores është:

emri = *vlerë*;

ose:

emri = *vlerë*;

Deklarimi, deklarimi, dhe inicializimi dhe përkufizimi i ndryshoreve mund të bëhet kudo te programi.

Shembuj:

```
short i;                    // Deklarimi i ndryshores numër të plotë i.
int m = 10, n = 17;         // Deklarimi dhe inicializimi i
                            // ndryshoreve numra të plotë m dhe n.
float pesha  = 56.75f;      // Deklarimi dhe inicializimi i ndryshores
                            // reale të peshës.
double shuma;               // Deklarimi i ndryshores reale shuma.
char shenja  = '+';         // Deklarimi dhe inicializimi i
                            // ndryshores së shenjës.
string shteti;              // Deklarimi i stringut të shtetit.
i = 5;                      // Shoqërimi i vlerës së ndryshores i.
shuma  = 123.45;            // Shoqërimimi vlerës së ndryshores shumë.
shteti  = "MAQEDONIA";      // Shoqërimi i vlerës së ndryshores
                            // shteti.
double numriParë = (1 + 2 * 7) / (7 - 5);   // Deklarimi dhe inicializimi
```

Me urdhrin e parë, përkthyesi rezervon memorie prej 2 bajt për ndryshoren i (pasi është i llojit short), d.m.th., ai lokacion e lidh me emrin i. Nëse përpiqemi ta shfrytëzojmë ndryshoren i që është vetëm deklarim, por nuk është dhe të inicializuar, do të paraqitet ky gabim.

```
C4700    uninitialized local variable 'i' used
```

Me urdhrin:

```
i = 5;
```

të ndryshores i i shoqërohet vlerë 5, d.m.th., kjo vlerë vendohet në shoqërim të lokacionit për i në memorie. Pas këtij urdhri, ndryshorja i mund të shfrytëzohet kudo qoftë te programi.

Te vija e dytë prej **Shembujve** janë deklaruar dy ndryshore. Kjo është e mundur vetëm nëse ndryshoret janë të llojit të njëjtë.

Te shembulli i fundit, te ana e djathtë prej urdhrit gjendet shprehja aritmetike, që e para njehsohet dhe pastaj vlera e saj shoqërohet ndryshores numriDytë.

C++ e lejon edhe këtë mënyrë të shoqërimit të vlerave:

```
x = (y = 10) * (z = 5);     // Të x i shoqëron vlerë 50.
x = y = z = 20;             // të x, y dhe z u shoqëron vlerë 20.
```

Nuk ka rregull për të shkruar emra të ndryshoreve te C++, përveç kufizimeve të përmendura te titulli **Emrat e të dhënave** prej nënpikës **1.6 Hyrje në C++**. Çdo programues formon stilin e vet, por shpesh shfrytëzohet stili i shkronjës së parë të jetë e vogël, por çdo tjetër fjalë te emri të fillon me shkronjë të madhe. Për shembull: numriPI, çmimiNjësi, emriDheMbiemri, syprinaEKatrorit etj. Ky stil shfrytëzohet edhe te gjuha programore C++, por do ta shfrytëzojmë edhe ne.

Shembulli 1.6.1

Te shembulli (***figura 1.6.5***) është konstanta e deklaruar NUMRI_PI dhe i është shoqëruar vlera 3.1415. Pastaj, është deklaruar ndryshorja short ÇmimiNjësi, të cilës i shqërohet vlerë me urdhrin për shoqërim, por jo gjatë deklarimit.

```
1   #include <iostream>
2   using namespace std;
3
4   int main() {
5       // Deklarimi, inicializimi dhe shtypja e konstantave dhe ndryshoreve
6
7       const double NUMRI_PI   = 3.1415;  //Deklarimi dhe inicializimi i
8                                          //konstantes
9       short çmimiNjësi;                  // Deklarimi i ndryshores numër i plotë
10      int copaAkullore      = 100;       //Deklarimi dhe inicializimi
11      çmimiNjësi    = 50;                //Shoqërimi i vlerës ndryshores
12      cout << Konstanta PI     =" << NUMRI_PI  << endl;
13      cout << Vlera e        " <<  copaAkullore     << "akullore nga   "
14          << çmimiNjësi
15      cout << " denar dhe është  " << copaAkullore       * çmimiIVetëm
16          << " denar   " << endl;
17
18      cout << endl;
19      system( "Color 17" );
20      system( "pause" );
21      return 0;
22  }
```

Figura 1.6.5

Rezultati rej realizimit të programit është:

```
Konstanta PI=3.1425
Vlera e 100 akulloreve nga 50 denar është 5000 denarë
Press any key to continue...
```

Detyra për ushtrime

1. Shkruani 3 programe te të cilat do tÇi kyçim urdhërat për deklarim dhe inicializim. Pastaj, programet plotësoni me urdhëra për shtypje në ekran me të cilat do tÇi shtypni vlerat e të gjitha deklaratave të ndryshoreve. Çka ndodh kur shtypni vlerë të ndryshores të painicializuar ose të papërkufizuar ndryshorja?
2. Të shkruhet program te e cila do të deklaroni dhe inicializoni dy ndryshore me urdhrin int a = 12, b = 7;. Pastaj, shtypni shumën, ndryshimi dhe prodhimin e tyre në tre vija të njëpasnjëshme në ekran.
3. Le të jetë deklaruar/përkufizuar:
```
int x;
float y;
char z;
x = 2; y = 5.8; z = 'P';
```
Të shkruhet program me të cilin d të shtypen vlerat e ndryshoreve x, y dhe z në një vijë, ashtu që të jenë të ndara me nga një vend të zbrazët, por pastaj të kalohet te vija e re.
4. Le të jetë deklaruar/përkufizuar:
```
int dita  = 21;
string muaj  = "Qershor";
int viti  = 2020;
string sot  = "E hënë";
```
Të shkruhet program te i cili do t'i shfrytëzojmë ndryshoret e deklaruara dhe

inicializuara dhe do të shtypen:

Sot është e Hënë, 21 Qershor viti 2021.

Pyetje për kontroll të njohurive

1. Kush e ka dizajnuar gjuhën C++?
2. Prej çka përbëhet bashkësia e shenjave në C++?
3. Numëroni disa prej shenjave speciale që shfrytëzohen në C++.
4. Çka janë identifikatorët?
5. Çka është sintaksa, kurse çka është semantika e gjuhës?
6. Si ndahen identifikatorët?
7. Shkruani formën e funksionit main().
8. Me cilën shenjë ndahen urdhërat në C++?
9. Pse kryhet dhëmbëzimi i programit?
10. Si shënohen komentimet te programi?
11. Cili është urdhri për shtypje në C++?
12. Cili është operatori për shtypje?
13. Me cilin eskejp sekuencë kalohet për shtypje në rreshtin e ri?
14. Çka është struktura rendore prej urdhërave?
15. Çka është madhësia, kurse çka është e dhëna?

16. Çka është konstanta, kurse çka është ndryshorja?
17. Cilat vlera i quajmë literale?
18. Sa mund të jetë i gjatë emri i ndryshores në C++?
19. Cilat janë karakteristikat e të dhënës?
20. Si mund të jenë emrat e të dhënave në C++?
21. Përmend rregullat për përkufizim të emrave të përkufizuar të emrave të dobishëm (identifikatorëve).
22. Cilët prej këtyre emrave të të dhënave janë shkruar drejtë, kurse cilat nuk janë dhe pse?

a) _54abv	b)unë_5T	c) prinf	ç) aj De
d) emriIm	dh) for	e) a.7_b9	f) b9_c10

23. Sqaro çka është lloji i të dhënës?
24. Cilat lloje të të dhënave i dini në C++?
25. Sqaroni çka janë lloje të thjeshta, kurse çka janë lloje të përbëra të të dhënave.
26. Si mund të jetë përmbajtja e llojeve të adresave të të dhënave?
27. Cilat specifikator të llojeve i dini?
28. Çka paraqet fjala unsigned nëse përmendet para llojit të të dhënës?
29. Cilat vlera mund t'i kenë të dhënat prej llojit numër të plotë, të llojit real, prej llojit të shenjës dhe prej llojit tekstual. Me cilët specifikator shënohen këto lloje?
30. Për cilët identifikator themi se është konstant, por për cilin se është ndryshore?
31. Sa here dhe në cilat vende të programit mund të shfrytëzohet ndryshorja e njëjtë?
32. Çka do të ndodh nëse programin e njëjtë shfrytëzoni edhe konstante edhe ndryshore me emrin e njëjtë?
33. Emrin e programit a mund ta shfrytëzoni si ndryshore?
34. Çka është deklaratë, kurse çka është përkufizimi i ndryshores?
35. Çka do të thotë inicializimi i ndryshores?
36. Shkruani formën e përgjithshme të urdhrit për deklarim dhe inicializim.
37. Përmend disa shembuj për deklarim dhe disa për deklarim dhe inicializim të ndryshorve.
38. Me cilin operator shoqërohet vlera e ndryshores ose të konstantes?
39. Kur mund të shfrytëzohet ndonjë ndryshore që është vetëm e deklaruar?
40. Kjo deklaratë a është e drejtë: int m = 10, n = m;.

1.7 Llojet e të dhënave

Lloj numër i plotë i të dhënave int

Lloj numër i plotë i të dhënave mund të ketë vlerë të çfarëdo numri të plotë prej bashkësisë së numrave të plozë $Z = \{... -2, -1, 0, 1, 2...\}$.

Përmendëm se ka katër lloje të të dhënave numër të plotë: short, int, long dhe long long. Të varur prej llojit, madhësia e bashkësisë së vlerave të ndryshme.

Te ***tabela 1.7.1*** 1 janë dhënë lloje numra të plotë të të dhënave, vargjet e vlerave të tyre (angl. data range) dhe sasitë të memoria[29] që e zënë.

Lloj	Vlera	Memoria
short	–32768... 32767	16 bit
int	–2147483648... 2147483647	32 bit
long	–2147483648... 2147483647	32 bit
long long	–9223372036854775808... 9223372036854775807	64 bit
unsigned short	0... 65535	16 bit
unsigned int	0... 4294967295	32 bit
unsigned long	0... 4294967295	32 bit
unsigned long long	0... 18446744073709551615	64 bit

Tabela 1.7.1

Vargu i vlerave të çdo lloj varet prej kompjuterit te i cili kryhet programi. Vlerat minimale dhe maksimale përkufizohen si konstante:

```
short               SHRT_MIN = -32768
                    SHRT_MAX = 32767
unsigned short      USHRT_MAX = 65535
int                 INT_MIN = -2147483648
                    INT_MAX = 2147483647
unsigned int        UINT_MAX = 4294967295
long                LONG_MIN = -2147483648
                    LONG_MAX = 2147483647
unsigned long       ULONG_MAX = 4294967295
long long           _I64_MIN = -9223372036854775808
                    _I64_MAX = 9223372036854775807
unsigned long long  _UI64_MAX = 18446744073709551615
```

Për operacionet me lloje numër të plotë të të dhënave, shfrytëzohen këta operatorë aritmetikor:

+	Mbledhja
–	Zbritja dhe negacioni[30]

[29] Sasia e memories që zënë lloje të të dhënave mund të ndryshojë prej një platform të kompjuterit në tjetrin.

[30] Shenja minus (–) para një operandi quhet operator unar, d.m.th., minus unar.

*	Shumëzimi
/	Pjesëtimi numra të plotë – pjesa e plotë prej herësit të y numrave të plotë
%	Pjesëtim me modul-mbetje prej pjesëtimit të dy numrave të plotë

Rezultati prej pjesëtimit të dy numrave të plotë me operatorin / është pjesa e prej pjesëtimit. Për shembull:

```
10 / 4 = 2,  -15 / 6 = -2,    20 / (-6) = -3,    (-14) / (-3) = 4
5 / 0  do të paraqesë gabim gjatë përkthimit.
```

Rezultati prej zbatimit të operatorit % mbi dy numra t plotë është mbetja prej pjesëtimit. Për shembull[31]:

```
10 % 4 = 2,  -15 % 6 = -3,   20 % (-6) = 2,    (-14) % (-3) = -2
5 % 0  do të paraqesë gabim gjatë përkthimit.
```

Prioritet të operatorit për numra të plotë është:

1	*	/	%	prioritet i njëjtë
2	+	–		prioritet i njëjtë

Gjatë njehsimit të shprehjeve aritmetike, operacionet realizohen prej të majtës nga e djathta. Së pari realizohen operacionet me prioritet 1 (cili do prej tre operacioneve), por pastaj operacionet me prioritet 2 (të çfarëdo qoftë prej dy operacioneve).

Për shembull:

```
1 + 2 * 3 – 4 % 5 * 6 / 7 = 1 + 6 – 3 = 4
```

Me përdorimin e kllapave, ndryshon renditja e realizimit të operacioneve të caktuara me prioritetet e operatorëve.

Për shembull:

```
(1 + 2 * (3 – 4)) % (5 * 6 / 7) = (1 + 2 * (-1)) % 4 = (1 – 2) % 4 =
-1
```

Shembulli:

```
7 / 3 = 2
205 / 20 = 10
205 % 20 = 5
-25 % 3 = -1
7.0 / 4 = 1.7500
(1 + 2 * (3 + 4)) % 5 = 0
(1 + 2 * 3 + 4) % 5 = 1
1 + 2 * 3 + 4 % 5 = 7
-15 % (-4) = -3
15 % (-4) = 3
2147483647 + 1 = -2147483648      // mbushja [32]
```

[31] Nëse një operator është negative, shenja për mbetje varet prej përkthyesit.
[32] Për përgjysmimin do të sqarojmë më vonë.

Operator standard për shoqërim të vlerës së ndryshoreve te urdhërat për shoqërim është = . Gjatë shoqërimit të konstantes të pashënuar, duhet të vendohet prapashtesa (sufiksin) u ose U. Në të kundërtën, do trajtohet sikurse int.

Edhe për këto lloje të konstantave vendohet prapashtesa:

lloj	i prapashtesës
long	l ose L
long long	ll ose LL
unsigned long	ul ose UL
unsigned long long	ull ose ULL.

Shembuj:

```
int numriIParë, numriIDytë;
short shifra  = 8;
long shifraArabe = 1234567890;
numriIParë = 1 + 2 * 3 + 45 % 6;          (= 10)
numriIParë = numriIParë + shifra;         (= 18)
numriIDytë  = numriIParë / shifra;        (= 2)
numriIDytë  = numriIDytë  % shifra;       (= 0)
const long PREJ_DIELLI_DERI_SATURN  = 1424600000L;
long long njësiaAstronomike = 149597870700LL;
unsigned int tëgjithaShifrat = 1234567890u;
unsigned long maxLong = 4294967295ul;
unsigned long long maxLL = 18446744073709551615ull;
x = (y = 10) * (z = 5);
x = y = z = 20;
```

Te shembulli vijues do të paraqesim pjesëtim numër të plotë, pjesëtim sipas modulit, d.m.th., mbetja prej pjesëtimit numër të plotë dhe prioritet të operacioneve për numrat e plotë.

Shembulli 1.7.1

```
1   #include <iostream>
2   using namespace std;
3
4   int main() {    // Operacione me numra të plotë
5
6       // Pjesëtimi me numra të plotë-pjesa e plotë prej herësit të dy numrave të plotë
7       cout << "10 / 4 = " << 10 / 4 << endl;
8       cout << "-15 / 6 = " << -15 / 6 << endl;
9       cout << "20 / (-6) = " << 20 / ( -6 ) << endl;
10      cout << "-14 / (-3) = " << ( -14 ) / ( -3 ) << endl;
11      // Pjesëtimi sipas modulit-mbetja prej pjesëtimit të dy numrave të plotë
12      cout << "10 % 4 = " << 10 % 4 << endl;
13      cout << "-15 % 6 = " << -15 % 6 << endl;
14      cout << "20 % (-6) = " << 20 % ( -6 ) << endl;
```

Figura 1.7.1

```
15      cout << "-14 % (-3) = " << ( -14 ) % ( -3 ) << endl;
16      //   Prioritet i operatorëve për numrat e plotë
17      cout << "1 + 2 * 3 - 4 * 5 % 6 / 7 = "
18          << 1 + 2 * 3 - 4 % 5 * 6 / 7 << endl;
19      cout << "(1 + 2 * (3 - 4)) * (5 % 6 / 7) = "
20          << ( 1 + 2 * ( 3 - 4 ) ) % ( 5 * 6 / 7 ) << endl;
21
22      cout << endl;
23      system( "Color 17" );
24      system( "pause" );
25      return 0;
26  }
```

Figura 1.7.1 (vazhdim)

Një dalje prej realizimit të programit prej ***figura 1.7.1*** është:

```
10 / 4 = 2
-15 / 6 = -2
20 / (-6) = -3
-14 / (-3) = 4
10 % 4 = 2
-15 % 6 = -3
20 % (-6) = 2
-14 % (-3) = -2
1 + 2 * 3 - 4 * 5 % 6 / 7 = 4
(1 + 2 * (3 - 4)) * (5 % 6 / 7) = -1

Press any key to continue . . .
```

Forma e shkurtuar e operatorëve

Operatorët në C++ mund të shfrytëzohen në të ashtuquajturën **forma e shkurtuar** e cila shprehet me operatorin aritmetik dhe operatorin për shoqërim =. Ato quhen **operator të përbërë për shoqërim** (angl. compound assignment operators).

Forma e përgjithshme e operatorëve për shoqërim është:

operatoriaritmetik =

Format e shkurtuara të operatorëve për shoqërim për të dhënat e numrave të plotë janë:

+= **-=** ***=** **/=** **%=**

Shembuj:

`numriIParë += shifra;` është njëjtë me `numriIParë = numriIParë + shifra;`
`numriIDytë %= shifra;` është njëjtë me `numriIDytë = numriIDytë % shifra;`

Te shembulli vijues është ilustruar shfrytëzimi i forms së shkurtuar të operatorëve.

Shembulli 1.7.2

Te ***figura 1.7.2*** është ilustruar shfrytëzimi i formës së shkurtur të operatorëve.

```
1   #include <iostream>
2   using namespace std;
3
4   int main() {    // Forma e shkurtur e operatorëve
5
6       int cifra = 8;
7       cout << "shifra   " << shifra << endl;
8
9       int numriIParë,numriIDytë,numriITretë;
10       numriIParë = numriIDytë = 100    // Ova e dozvoleno vo C++
11      cout <<"Numri i parë " <<numriIParë<< endl;
12      cout << "Numri i dytë " <<numriIDytë << endl;
13
14     numriIParë +=shifra                // forma e shkurtuar e operatorit +
15     numriIDytë *= shifra               // forma e shkurtuar e operatorit *
16      cout << "numriIParë= cc      <<numriIParë<< endl;
17      cout << "numriIDytë*= cifra =  " <<numriIDytë<< endl;
18
19      //  Shoqërimi i vlerave ndryshoreve te shprehja
20      //  edhe kjo është lejuar në C++
21    numriITretë = (numriIParë= 123 ) + ( numriIDytë= 321 );
22      cout << "numriITretë= " <<numriIParë<< " + " <<numriIDytë<< " = "
23          <<numriITretë<< endl;
24
25      cout << endl;
26      system( "Color 17" );
27      system( "pause" );
28      return 0;
29  }
```

Figura 1.7.2

Një dalje prej realizimit të programit është:

```
Shifra = 8
Numri i parë = 100
Numri i dytë = 100
numriIParë += shifra = 108
numriIDytë  *= shifra = 800
Numri i tretë = 123 + 321 = 444
Press any key to continue . .
```

Detyra për ushtrime

1. Shkruani program te i cili për numrat x = 123 dhe y = 52 do t'i njehsoni dhe shtypni: shumën, ndryshimin, prodhimin, pjesën e plotë prej herësit të tyre. Poashtu, të shfrytëzohet vetëm një ndryshore z.
2. Të shkruhet program me të cilin do t'i njehsoni dhe shtypni katrorin dhe kubin e numrit të plotë numriIPlotëX = 123, pa i shfrytëzuar ndryshoret e të tjera.

3. Të shkruhet program me të cilin do t'i shtypni shifrën e mesme të numrit treshifror numriX = 274.
4. Treni prej Manastiri për në Shkup niset në ora 5 dhe 20 minuta. Në Shkup arrin në ora 8 dhe 12 minuta. Të shkruhet program me të cilin do të njehsoni sa kohë treni ka udhëtuar prej Manastiri deri në Shkup.
5. Të shkruhet program me të cilin do të njehsoni shuma dhe ndryshimi i këndeve

   $\alpha = 100° 47 ′38″$ dhe $= \beta 35 °53 ′49″$.

Lloj real i të dhënave **float, double, long double**

Lloj real i të dhënave janë ato të cilat fitojnë vlera prej bashkësisë së numrave real. Me llojreal shpesh mendohet në numrat dhjetor.

Në C++ janë ndërtuar te lloje të të dhënave reale, edhe atë: **float, double** dhe **long double**.

Të dhënat prej llojit real mund të jenë konstanta dhe ndryshore.

Inicializimi kryhet sikurse edhe te llojet e numrave të plotë të të dhënave.

Gjatë deklarimit të ndryshoreve prej llojit float, duhet të vendohet prapasjtesa (sufiksi) f ose F. Në të kundërtën, do të trajtohet si lloj double.

Gjithashtu, llojit long double vendohet prapashtesa l ose L.

Shembuj:

```
float x;
float peshEPërgjithshme;
double shumaEPërgjithshme  = 12345.67;
long double PI = 3.14159265358979323846;
const float NXITIMI_TOKËS  = 9.81f;
float numri_është  = 2.7182818284590452354F;
long double rrezjaEElektronit = 0.00000000000000282L;  //2.82x10-15
```

Preciziteti i të dhënave prej llojit **float, double** dhe **long double** është i ndryshëm, edhe atë:

- Të dhënat **float** zënë 32 bit dhe kanë 7 shifra të rëndësishme.
- Të dhënat **double** zënë 64 bit dhe kanë 15 shifra të rëndësishme.
- Të dhënat **long double** zënë 80 bit dhe kanë 18 shifra të rëndësishme.

Vargu i vlerave të llojit real të të dhënave është dhënë te ***tabela 1.7.2.*** Vargu është njehsuar sipas precizitetit të paraqitjes së numrave me 32, 64 dhe 80 bit. Ekzistojnë formate për paraqijen e të plotave dhe të numrave dhjetorë[33].

[33] Ekziston IEEE standard (Institute of Electrical and Electronics Engineers) me të cilin janë përshkruar formatet për paraqitjen e të plotave dhe numrave dhjetorë në kompjuter, sipas precizitetit, d.m.th., sipas numrit të bitëve.

Lloj	Vlera	Memoria
float	$\pm 3.4028234 \bullet 10^{-38} ... \pm 3.4028234 \bullet 10^{38}$	32 bit
double	$\pm 1.7976931348623157 \bullet 10^{-308} ...$ $\pm 1.7976931348623157 \bullet 10^{308}$	64 bit
long double[34]	$\pm 3.4 \bullet 10^{-4932} ... \pm 1.1 \bullet 10^{4932}$	80 bit

Tabela 1.7.2

Vlerat minimale dhe maksimale të numrave dhjetorë në C++ varen prej përkthyesit dhe janë dhënë si konstante[35]. Për shembull, te kompjuteri im ato janë:

```
float                FLT_MIN  = 1.17549e-38
                     FLT_MAX  = 3.40282e+38
double               DBL_MIN  = 2.22507e-308
                     DBL_MAX  = 1.79769e+308
long double          LDBL_MIN = 2.22507e-308
                     LDBL_MAX = 1.79769e+308
```

Operatorët aritmetik për të dhënat prej llojit real janë:

+	mbledhja
–	zbritja ose negacioni
*	shumëzimi
/	pjesëtimi real (nëse të paktën njëri prej të dhënave është real)

Nëse gjatë pjesëtimit me 0.0 del jashtë prej vargut të numrave, nuk paraqitet gabim, por për rezultat fitohet inf ose –inf, (e pafundshme, angl. infinity).

Prioriteti i operatorëve për numrat real në shprehjet aritmetike shqyrtohet prej të majtës në të djathtë, edhe atë:

1	*	/	prioritet i njëjtë (operatorët multiplikativ)
2	+	–	prioritet i njëjtë (operatorët aditiv)

Edhe këta operatorë mund të shfrytëzohen në formën standard dhe të shkurtuar:

+=	–=	*=	/=

[34] Ky lloj është shfrytëzuar në versionet e mëhershme në C++. Në standardet e sotshme për C++, ky lloj është ekuivalent me double.

[35] Vlerat më të vogla pozitive për llojet reale të të dhënave janë përkufizuar si konstante. Te kompjuteri im ato janë:

```
float                FLT_EPSILON  = 1.19209e-07
double               DBL_EPSILON  = 2.22045e-16
long double          LDBL_EPSILON = 2.22045e-16
```

Shembulli 1.7.3

Me këtë shembull (***figura 1.7.3***) ovet ndryshimi në precizitetin prej llojit float (të paraqitur me 32 bit) dhe prej llojit double (të paritur me 64 bit).

```
1   #include <iostream>
2   using namespace std;
3
4   int main() {    // Operacione me numra real
5
6       //Për tip float
7       float
8      numriIParë= 1.000000000f;
9      numriIDytë = 0.999898989f;
10
11      cout <<                                          << endl;
12      cout <<numriIParë<< " - " <<numriIDytë << " = " << rezultati << endl;
13
14      //Për tip double
15      double numriIParë, numriIDytë, rezultati
16      numriIParë  = 1.000000000;
17      numriIDytë   = 0.999898989;
18
19      cout << "Ndryshimi i numrave dhjetorë të llojit        " << endl;
20      cout << numriIParë << " - " << numriIDytë  << " = "
21          << rezultati << endl;
22
23      cout << endl;
24      system( "Color 17" );
25      system( "pause" );
26      return 0;
27  }
```

Figura 1.7.3

Shembull prej realizimit të programit është:

```
Ndryshimi i numrave dhjetorë të llojit float:
1 - 0.999899 = 0.00010103
Ndryshimi i numrave dhjetorë të llojit float:
1 - 0.999899 = 0.000101011
Press any key to continue . . .
```

Prej daljes vërehet se edhe pse vlera e të dhënave është e njëjtë, rezultati është i ndryshëm.

Formati për paraqitjen e të dhënave dhjetore

Të dhënat dhjetore te gjuhët programore paraqiten në dy mënyra:

- Te formati dhjetor (**f**- formati, **F**- formati), mënyra e njohur si **pika e palëvizshme** (angl. fixed point).
- Te formati eksponencial (**e**- formati, **E**- formati), mënyra e njohur si **pika e lëvizshme** (angl. floating point).
- Shkronja **f** vjen prej fjalës „float“, por shkronja e vjen prej fjalës „exponent“. Numrat dhjetor te f- formati (ose F- formati) shkruhen me pika dhjetore në

vendin fiks, e cila i ndan pjesën e plotë dhe dhjetore të numrit. Prandaj, ajo mënyrë e paraqitjes së numrave dhjetorë quhet paraqitja me pikë të palëvizshme. Për shembull: 1234.56, –0.25, 0.5432, –123.45 etj.

Te e- formati (ose E- formati) pika e lëvizshme, ku shfrytëzohet eksponent. Për shembull, numri 123456789.12 mund të shkruhet me zhvendosjen e pikës dhjetore kudo qoftë majtas ose djathtas:

$1234567891.2x10^{-1}$, $12345.678912x10^{4}$, $0.0012345678912x10^{11}$

Numrat e njëjtë në e- ose E-format shkruhen në këtë mënyrë:

1.234568e+08, 1.234568E+08.

Kur numrat dhjetor shtypen në e-format (ose E-format), shkruhen *vetëm një shifër* majtas prej pikës dhjetore, ndërsa shkronja e ose E shkruhet para eksponentit. Eksponenti shkruhet me shenjë – ose +.

Numrat dhjetor të shtypur në format f, F, e ose E kanë precizitet prej 6 shifrave të sakta, por e shtata rrumbullakohet.

Për shembull, nëse janë përkufizuar (të deklaruara dhe të inicializuara) ndryshoret vijuese në f-format dhe te e-format:

```
float a = 1234.56f, a1 = -25000.f, a2 = 0.5432f;
double c = 76.543e3, c1 = -25.e-1, c2 = 2e3;
```

gjatë shtypjes së tyre në f-format, fitohet:

```
1234.560059     -25000.000000   0.543200
76543.000000    -2.500000       2000.000000
```

por gjatë shtypjes në e-format, fitohet:

```
1.234560e+03    -2.500000e+04   5.432000e-01
7.654300e+04    -2.500000e+00   2.000000e+03
```

Ngjashëm, nëse te program prej ***figura 1.7.3*** pak ndryshon vlera e ndryshores numriIDytë (vendi 0.999898989, jepet 0.999998989), vlera e ndryshores rezultati do të shtypet në **e**-format:

```
Ndryshimi i numrave dhjetorë të llojit float:
1 - 0.999999 = 1.01328e - 06
Ndryshimi i numrave dhjetorë të llojit float:
1 - 0.999999 = 1.011e-06
Press any key to continue . . .
```

Shprehjet aritmetike dhe konversioni i llojit të të dhënave

Gjatë njehsimeve, te programet paraqiten shprehje të thjeshta dhe të përbëra aritmetike. Ato shprehen me konstanta, ndryshore dhe operator.

Operatorët mund të jenë:

Unare: + dhe –
Binare: + – * / dhe %

Për shembull:

–5 + 3, –y, a + b / c % d, 1.2 * x * x – 3.4 * x + 5.67

Nëse te shprehja ka më shumë operatoro, ata realizohen sipas prioritetit:

më i lartë: unar + unar –
mesatar: * / %
më i ulët: + –

Për shembull, për a = 5, b = 4, c = 3, d = 2, shprehja a + b / c % d do të njehsohet:

```
a + b / c % d = 5 + 4 / 3 % 2 = 5 + 1 % 2 = 5 + 1 = 6
```

Prioriteti i operatorëve mund të ndryshojë me kllapa. Për shembull, nëse shprehjen paraprake e shkruajmë (a + b) / (c % d), do të njehsohet:

```
(a + b) / (c % d) = (5 + 4) / (3 % 2) = 9 / 1 = 9
```

Operatorët unar te shprehjet realizohen prej të djathtës në të majtë. Për shembull, për a = 5 dhe b = –3:

```
a + ( –b ) = 5 + (– (–3 ) ) = 5 + ( +3 ) = 8
```

Nuk mundet `5 (+ -) (-3) )`

Thamë se lloj i ndryshores cakton se lokacioni i memories përkatëse mund të përmbajë vetëm lloj të atillë të të dhënave.

Për shembull, nëse është deklaruar:

```
int numërIPlotë;
float numërReal ;
```

këto urdhëra për shoqërim janë në rregull:

```
numërIPlotë  = 5;
numërReal  = 6.7;
```

Por çka ndodh nëse i ndryshojnë vlerat, d.m.th.,.:

```
numërIPlotë  = 6.7;
numërReal  = 5;
```

Me urdhrin e parë, pasi ndryshorja numërIPlotë mund të fitojë vlerë vetëm nujmra të plotë, pritet pjesa dhjetore prej 6.7 dhe të ndryshores numërIPlotë dhe i shoqërohet vlera 6.

Me urdhrin e dytë, pasi ndryshorja numërReal mund të fitojë vlerë vetëm numra real, konvertohet numri i plotë 5 në real 5.0 dhe të ndryshores numriReal i shoqërohet vlera 5.0.

Mënyra e këtillë e shoqërimit të vlerës së ndryshores prej lloj jo përkatës quhet **konversion implicit** (automatik) ose **detyrimi i llojit** (angl. type coercion).

Vërejmë se gjatë shoqërimit të vlerës reale të ndryshores numër i plotë humbin informatat për të dhënën pasi pritet pjesa dhjetore. Për t'iu larguar humbjes së informatës, shfrytëzohet **lloj eksplicit i konversionit** (angl. type conversion), të njohur sikurse **hedhja e llojit** (angl. type casting).

Hedhja kryhet me përmendjen e llojit para ndryshores ose shprehjes që duhet të knverton. Kështu dy urdhërat paraprake me hedhje do të jenë:

```
numërIPlotë  = int(6.7);
numërReal  = float(5);
```

Pasi ndryshorja numërIPlotë d të jetë vlerë 6 edhe në rastin vlera të jetë 6.99 (që është më afër deri te 7), për t'u humbur më pak informata për të dhënën, praktika e mire programore është ai të rrumbullakon me shtuarje vlere 0.5.

Urdhri do të jetë:

```
numërIPlotë  = int(6.7 + 0.5);
```

Shpesh, shprehjet aritmetike përmbajnë edhe ndryshore numra të plotë dhe nunra real, d.m.th., përmbajnë lloje të përziera të të dhënave.

Te shprehjet me lloje të përziera të të dhënave, sikurse:

```
numërReal1  = 5 + 7.34;
numërReal2  = 129.56 - 1.3e+2;
```

kryhet konversioni implicit i llojeve me precizitet më të vogël në llojet me recizitet më të madh.

Me këtë grup vijues të urdhërave:

```
int k = 5;
double p;
p = k + 7.34                (= 5.0 + 7.34 = 12.34)
```

së pari kryhet konversioni implicit (automatik) i ndryshores numër i plotë k (= 5) te ndryshorja prej llojit double (= 5.0), mblidhet me 7.34 dhe pastaj shuma i shoqërohet ndryshores p (= 12.34).

Te shprehja për njehsim të p, mund të shfrytëzohet edhe knversioni eksplicit:

```
p = float(k) + 7.34;
```

Me këtë urdhër:

```
int m = p;                          (12 ← 12.34)
```

kryhet konversioni implicit i 12.34 në 12, vlera që i shoqërohet ndryshores numër i plotë m.

E njëjta mund të bëhet edhe me klnversioni eksplicit:

```
m = int(p);                         (= 12)
```

ku vlera e ndryshores p në mënyrë eksplicite shndërrohet në lloj int.

Këto shembuj gjithashtu ilustrojnë knversin:

```
r = double(3 * 5);          (= 15.0)
cout << int('a') << endl;   (Do të shtypet 97)
```

Për konversionin e llojit, mund të shfrytëzohet edhe frma që është tipikë për gjuhën C (angl. C-like), d.m.th., e trashëguar prej atij. Poashtu, shfrytzohet operatori ( )

i cili quhet operator cast, të quajtur edhe operator për hedhje. Ai përdoret ashtu që së pari jepet lloj te i cili shndërrohet vlera e shprehjes, por pas tij te kllapat vijn shprehja lloj i të cilës ndryshon.

Për shembull:

```
m = (int)(5 + 7.34)          (= 12)
```

Shembujt paraprak mund të shkruhen edhe në këtë mënyrë

```
k = (int)(5 + 7.34);         (= 12)
r = (double)(3 * 5);         (= 15.0)
cout << (int) 'a' << endl;   (do të shtypet )[36]
```

Gabi mi shpeshtë bëhet gjatë pjesëtimit të dy ndryshoreve numra të plotë. PËr shembull, nëse shuma e 8 numrave natyrorë është 100, vlera mesatare është 100 / 8 = 12.5:

```
        int shuma = 100;
        int numra = 8;
        float vleraMesatare = shuma / numra;//E pasaktë, pjesëtimi numra të plotë)
duhet   float vleraMesatare  = float(shuma ) / numra;
ose     float vleraMesatare  = shuma  / float(numra);
ose     float vleraMesatare  = 1.0 * shuma  / numra;     (Pa hedhje)
```

Te shembujt paraprak shfrytëzuam edhe urdhër të këtillë:

```
numriIParë  = numriIParë  + shifra;
```

Nëse e shkruajmë këtë urdhër në formën matematikore, do të fitojmë barazim të pamundshëm:

```
x = x + y
```

e cila është e saktë nëse y = 0.

Por kjo shprehje në programim realizohet në mënyrë korrekte. Procesori së pari e jehson anën e djathtë, ashtu që e mbledh vlerën momentale të ndryshores x me vlerën e ndryshores y dhe shuma e fituar i shoqërohet si vlerë e re e ndryshores x.

Për shembull, nëse ndryshoret kanë vlera x = 5 dhe y = 3, urdhri do të realizohet sipas kësaj skeme.



a) Vlerat e x (= 5) barten te procesori.
b) Te ai shtohet vlera e y (= 3).
c) Shma e fituar vendohet si vlerë e re e x (= 8).

[36] Vlera e ASCII në shenjën 'a' është 97.

Nëse vlera e ndryshores x zmadhohet për 1 (themi, janë të inkriminuara), urdhri do të jetë:

```
x = x + 1;
```

Për realizimi e këtij urdhri, është future operator i veçantë, të quajtur o**perator për inkriminim**[37] (nagl. increment operator) ++. Urdhri paraprak i shkruar me këtë operator do të jetë:

```
++x;    ose     x++;
```

Përkatësisht me operatorin për inkriminim, është future edhe **operatori për dekrementim** (angl. decrement operator) – –, me të cilin zvogëlhet vlera e ndryshores për 1. Për shembull, urdhërat:

```
– –x;    ose     x– –;
```

kanë efekt të njëjtë sikurse edhe urdhri:

```
x = x - 1;
```

Shembulli 1.7.4

Me programin prej ***figura 1.7.4*** është ilustruar konversioni implicit dhe eksplicit.

```
1   #include <iostream>
2   using namespace std;
3
4   int main() {    // Konversioni i llojit të të dhënave
5
6       cout << "Konversioni implicit (vetëm në llojin e lartë)" << endl;
7       int k = 5;
8       double p;
9       p = k + 7.34;
10      cout << "5 + 7.34 = " << p << endl;
11      int m = p;
12      cout << "int m; \nm = 5 + 7.34 = " << m << endl;
13
14      cout << "\nKonversioni eksplicit (i detyruar) " << endl;
15      cout << "m = int(5 + 7.34) = " << int( p ) << endl;
16      cout << "m = (int)(5 + 7.34) = " << ( int ) p << endl;
17      cout << "int('a') = " << int( 'a' ) << endl;
18      cout << "(int)'a' = " << ( int ) 'a' << endl;
19      int zbir = 100;
20      int broevi = 8;
21      cout << "100 / 8 = " << shumë / numra   << endl;
22      cout << "float(100) / 8 = " << float( shumë   / numra   << endl;
23      cout << "100 / float(8) = " << shumë / float( numra   ) << endl;
24      cout << "1.0*100 / 8 = " << 1.0 * shumë / numra   << endl;
```

Figura 1.7.4

[37] Këto operacione më detalisht do t'i shqyrtojmë më vonë.

```
25
26      cout << endl;
27      system( "Color 17" );
28      system( "pause" );
29      return 0;
30  }
```

Figura 1.7.4 (vazhdim)

Dalja prej realizimit zë aplikacionit është:

```
Konversioni implicit (vetëm në llojin më të lartë)
5 + 7.34 = 12.34
int m;
m = 5 + 7.34 = 12

Konversionin eksplicit (të detyruar)
m = int(5 + 7.34) = 12
m = (int)(5 + 7.34) = 12
int('a') = 97
(int)'a' = 97
100 / 8 = 12
float(100) / 8 = 12.5
100 / float(8) = 12.5
1.0*100 / 8 = 12.5
```

Detyra për ushtrime

1. Të shkruhet program për njehsimin e perimetrit të ($P = 2r\pi$) dhe syprina ($S = r^2\pi$) të rrethit me rreze r = 18.3 cm.
2. Të shkruhet program për njehsimin e syprinës dhe vëllimit të paralelpipedit me brinjë a = 12.5 cm, b = 7.2 cm dhe c = 15.8 cm.
3. Të shkruhet program për zgjidhjen e barazimit: $5.27x - 23.15 = 0$.
4. Të shkruhet program për shndërrimin e këndit $\alpha = 36.27°$ në radian sipas formulës $\alpha^{rad} = \alpha\pi^{o} / 360$.
5. Të shkruhet program për njehsimin ei shpejtësisë së autombilit që për 5 rë kalon largësinë prej 465 kilometra.
6. Të shkruhet program për shtypjen e dhjetorit të tretë prej herësit të numrave real a dhe b, për a = 3 dhe b = 16.
7. Të shkruhet program për njehsimin e ndryshimit ndërmjet vlerave të numrit $\pi = 3.1415$ dhe shumës. $4\left(1-\frac{1}{3}+\frac{1}{5}-\frac{1}{7}+\frac{1}{9}-\frac{1}{11}+\frac{1}{13}-\frac{1}{15}\right)$.

Lloji i shenjës të të dhënave **char**

Të dhënat prej **llojit të shenjës** mund të kenë vlerë që çfarëdo qftë shenje numër i plotë. Atom mund të jenë ndryshore ose konstante të të dhënave. Deklarohen me fjalën **char**. Poashtu, shenja vendohet te gjysmëthnjzat, që të dallohen prej shenjës së njëjtë në tekst.

Shembuj:

```
const char taraba = '#';
char a;
char shenjë  = '+';
char denar = 'd';
char ascii = 120;
```

Të gjitha shenjat të cilat shfrytëzohen në gjuhën programore C++, në kompjuter reperzentohen (shkruajnë në memorie) me numra të plotë – kode, sipas tabelës ASCII (American Standard Code for Information Interchange). (Shiko **Datotekën B: Shenja ASCII**). Për shembull, shenja Q ka vlerë binare (kod) $01010001_2 = 81_{10}$, ndërsa shenja '=' ka kod $0011111_2 = 99_{10}$. Gjatë shtypjes së këtyre kodeve, shtypen shenjat përkatëse.

Të dhënat prej llojit të shenjës mund të trajtohen sikurse çfarëdo lloj numër të plotë, duke pasur llogari për vargun e vlerave. Me atom und të realizohen operacione aritmetike, ato mund të lexohen, të shtypen dhe të krahasohen.

Për shembull, nëse deklarohen ndryshorja procent me:

```
char përqindja;
```

shenja % mund të shoqëroj me çfarëdo qoftë prej këtyre dy urdhërave:

```
char përqindje  = '%';
përqindje  = 37;
```

Me këtë urdhër:

```
përqindja++;
```

inkrementohet vlerë numër i plotë të shenjës % prej 37 në 38, por me urdhrin:

```
cout << përqindje  << endl;
```

do të shtypet shenja &. Me të tjera fjalë, shenjar standarde ASCII janë renditur dhe vlera e tyre dekade është prej 0 (000000) deri 127 (1111111). 111).

Tabela e zgjeruar ASCII përmban 256 shenja me kode prej 0 në 255. Zgjerimi është me shenjat me kode prej 128 deri 255.

Pasi shenjat te C++ kanë vlera numra të plotë sipas tabelës ASCII[38], atom und të krahasohen. Për shembull, sheja '+' ka ASCII-vlerë 43_{16} ose 67_{10}, por ASCII-vlera e shenjës ':' është 58_{16} ose 88_{10}. Prandaj, mund të shkruhet '+' < ':'.

Vlerat dhe vargu i të dhënave prej llojit të shenjës janë dhënë te ***tabela 1.7.3.*** Kdet prej–128 deri –1 dhe prej 128 deri 255 janë kode të shenjave të njëjta.

Lloj	Vlera	Memoria
char	–128... 127	8 bit
unsigned char	0... 255	8 bit

Tabela 1.7.3

[38] Tabela standarde ASCII përmban 128 shenja, ndërsa tabela e zgjeruar ASCII përmban 256 shenja. Por për të përfshirë shenjat prej më shumë gjuhëve botërore, sot shfrytëzohen të ashtuquajtura unikod (angl. Unicode), i cili paraqet standard internacioal për kodim.

Vlera minimale dhe maksimale e të dhënave prej tipto char janë konstante:

```
char                    CHAR_MIN  = -128
                        CHAR_MAX  = 127
unsigned char           UCHAR_MAX = 255
```

Shembulli 1.7.5

Të njehsohet kamata për kapital të depnuar prej 100 000 denar nëse norma e kamatës është 7.5 %, sipas formulës kamatë $= \frac{\text{kapita} \cdot \text{norma e interest}}{100}$.

```
1   #include <iostream>
2   using namespace std;
3
4   int main() {    // Lloj i shenjës të të dhënave
5
6       char shenjaEPërqindjes '%';
7       double kapitali   = 100000.0;
8       float normaEKamatës  = 7.5f;
9       double sasiaEKamatës;
10      sasiaEKamatës = capital*normaEKamatës/100
11      cout << "Për kapitalin e deponuar prej" << capital    << "  denar i" << endl;
12      cout << "me nrmë të kamatës vjetore prej " << normaEKamatës
13          << "                << endl;
14      cout << "shenjaEPërqindjes    " <<fitohet kamata prej "  denar ." << endl;
15
16      system( "Color 17" );
17      system( "pause" );
18      return 0;
19  }
```

Figura 1.7.5

Një dalje sipas realizimit të tij është:

```
Për kapitalin e deponuar prej 100000 denar  me  .
nrmë të kamatës vjetore prej 7.5% fitohet
kamata prej 7500 denarë
Press any key to continue . . .
```

Detyra për ushtrime

1. Të shkruhet program me të cilin do të deklaroni aq shenja të ndryshoreve aq sa ka shkronja emri Juaj dhe çdonjërës do t'i shoqëroj nga një shkronjë. Pastaj, shtypni ashtu që në dalje do ta fitoni gjithë emrin.
2. Të shkruhet program për gjetjen e ndryshimit të numrave rendor të shkronjave 'S' dhe 'D' te tabela ASCII.
3. Çmimi i ndonjë prodhimi është 123.45 denarë, por gjatë një jave është shtrenjtuar për 15 % dhe pastaj është liruar për 8 %. Sa ka qenë çmimi në fund të javës? (Për shenjën % të shfrytëzohet ndryshorja e shenjës).

4. Të gjendet edhe shtypet shenja që i paraprin edhe shenja që e përcjell pas shenjës @ te tabela ASCII.
5. Të caktohet sa shkronja ka ndërmjet dy shkronjave prej alfabetit.
6. Të deklarohen dhe inicializohen dy ndryshore numra të plotë a dhe b të vlerave 12 345 dhe 678. Të deklarohet edhe në shenjë e ndryshores operator dhe t'i shoqërohet nga një prej shenjave: +, –, *, / dhe %. Pas çdo shoqërimi të shenjës, të shtypen a dhe b me shenjën e operatorit ndërmjet tyre, si edhe rezultati prej operacionit. Për rezultatin prej operacionit, të deklarohet ndryshorja përkatëse. Për shembull, për operator = '%' të shtypen 12 345 % 678 = 141.

Lloj logjik i të dhënave **bool**

Të dhënat vlera e të cilëve mund të jetë ose true ose false janë të **llojit logjik** (angl. logical type). Fjalët e rezervuara true dhe false janë konstante special në C++. Gjatë njehsimit të shprehjeve, konstantat logjike true dhe false kanë vlerë 1 ose 0 dhe lexohen sikur 1 dhe 0.

Të dhënat e llojeve logjike deklarohen me fjalën **bool**.

Shembuj:

```
bool Po Jo;
bool semafor = true;
```

Me të dhënat prej llojeve logjike mund të shfrytëzohen edhe **operatorët logjik** (angl. logical operators)[39]:

&& logjike ***DHE*** (AND)
|| logjike ***OSE*** (OR)
! logjike ***JO*** (NOT)

Këta operatorë quhen edhe **operator të kushtëzuar** (angl. conditional operators) pasi shpesh shfrytëzohen gjatë vlerave (true ose false) të ndonjë shprehje logjike të përbërë.

Operatorët logjik janë, në realitet, funksione, të quajtura **funksione të Bulit** (angl. boolean functions)[40], sipas matematikanit Xhorxh Bul (George Boole) i cili i ka përkufizuar.

Operatorët logjik janë përkufizuar me këtë tabelë.

JO/*NOT*/*!*	***DHE***/*AND*/*&&*	***OSE***/*OR*/*||*
!false = true	false && false = false	false || false = false
!true = false	false && true = false	false || true = true
	true && false = false	true || false = true
	true && true = true	true || true = true

Tabela 1.7.4

[39] Ekzistojnë edhe operator tjerë logjik.
[40] Ekzistojnë edhe të tjera funksione të Bulit.

Shembuj:

Vlera e këtyre shprehjeve për a = true dhe b = false do të jetë:

```
a)
(a || b) && (!a || b) = (true || false) && (false || false) = true && false = false

b)
(a && !b) && (!a || b) || (a || b) = (true && !false) && (!true || false) || (true || false) = (true && true) && (false || false) || (true || false) = true && false || true = false || true = true
```

Me të gjitha llojet paraprake të përmendura të të dhënave mund të shfrytëzohen **operatorët e relacionit** (angl. relational operators):

<	më i vogël
<=	më i vogël ose i barabartë
>	më e madhe
>=	më e madhe ose e barabartë
==	e barabartë
!=	e ndryshme

Të përmendim se operatori == nuk është „dy e barabartë", por operator binary për krahasim të dy operandëve. Për shembull, nëse z është ndryshore logjike, me urdhrin:

```
z = x == y;
```

së pari krahasohen vlerat e x dhe y dhe nëse janë të njëjta, z i shoqërohet vlerë true, por nëse nuk janë të njëjtë, z i shoqërohet vlera false.

Gjatë shfrytëzimit të operatorëve të relacioneve, duhet të kemi kujdes operndët të jenë të llojit të njëjtë. Në të kundërtën, mund të ndodh konversioni i detyruar i një lloj në tjetrin, i cili mund të sillet deri te rezultati i gabuar ose deri te dukuria e porosisë për gabim.

Për shembull, te urdhri:

```
bool Po Jo  = 1 == '1';
```

kryhet konversioni implicit i shenjës '1' në numër të plotë dhe pastaj krahasohet me konstante 1. Rezultati është false. Pse?

Operandët e relacioneve mund të jenë edhe prej llojit tjetër të thjeshtë. Gjatë shfrytëzimit të shprehjeve, ato në mënyrë të detyrueshme konvertojnë në lloj logjik, edhe atë: vlera 0 në false, por të gjitha vlerat jozero në true.

Për shembull, këto urdhëra:

```
double rreze  = 1.23;
bool Po Jo  = rreze  > 0;
```

realizohet ndryshorja korrekte dhe logjike Po Jo fiton vlerë true.

Gjatë krahasimit të numrave real, duhet të kemi kujdes se ato njehsohen përafërsisht, por jo saktë.

Për shembull, me këto urdhëra:

```
float a = 1.0f / 5;
Po Jo  = a == 0.2;
```

```
cout << "a = 1.0/5 = " << a << " a është e barabartë 0.2? " << Po Jo<< endl;
```

rezultati do të jetë false, d.m.th., 0 për ndryshoren Po Jo:

```
a = 1.0/5 = 0.2 a është e barabartë 0.2? 0
```

Por mund të ndodh operndët dhe gjithë shprehja të jenë shkruar në mënrë korrekte (përkthyesi të mos paraqet), por rezultati të jetë i gabuar. Për shembull, vlera e shprehjes:

```
bool suksesIShkëlqyeshëm = nota  == 4 || 5
```

është true, pavarësisht si është vlera e ndryshores nta pasi operandi i djathtë i operatorit || gjithmonë ka vlerë true.

Në realitet, gjykimi i drejtë duhet të jetë:

```
bool sukse  = nota  == 4 || nota  == 5;
```

që fiton vlerë false nëse nota është më e vogël se 4.

Ngjashëm, urdhri:

```
bool të renditur  = a < b < c;
```

është e saktë sintksisht por semantike nuk është. Kështu, për vlerën a = 3 dhe c = 5, do të japë rezultat të gabuar pasi së pari krahasohet 3 < b që jep rezultat true ose false, d.m.th., vlera 1 ose 0. Pastaj, krahasohet 1 < 5 ose 0 < 5 që gjithmonë jep rezultat true. Por për b = 6 duhet të fitohet rezultati false.

Urdhri i drejtë është:

```
bool të renditur  = a < b && b < c;
```

operatorët logjik dhe të relacionit shfrytëzohen në **shprehjet logjike** (angl. logical expressions), vlera e të cilit mund të jetë true ose false.

Shembuj:

```
int alfa = 60, x = 7, a = 3, b = 8, c = 2;
bool p = (alfa > 0) && (alfa < 90);
bool q = (x < -1) || (x > 1);
bool r = !(a < b + 5 * c) && (2 * c + 1 == 3 * b) || (c >= b);
cout << "p = " << p << "\nq = " << q << "\nr = " << r << endl;
```

Me këtë tabelë janë paraqotur shprehjet logjike ekuivalente të quajtura **rregullat e De Morganit** (angl. De Morgan's Laws).

Shprehje	Shprehje ekuivalente
!(a && b)	!a || !b
!(a || b)	!a && !b

Shprehjet te programet mund të jenë edhe maft të përbërë edhe tea to të shfrytëzohen operatorët aritmetik, logji dhe të relacionit. Gjatë njehsimit të tyre, respektohet prioriteti i operatrëve, edhe atë:

Me i lartë	Negacioni (NOT) !	unar +			unar –
	aritmetike	*	/	%	
		+	–		
	Të relacionit	<	<=	>	>=
		==	!=		

	logjike	(AND) &&						
		(OR) ||						
të ulët	Shqërim më	=	+=	–=	*=	/=	%=	

Njehsimi i shprehjeve logjike kryhet prej të majtës në të djathtë, me respektimin e prioritetit të operatorëve dhe kllapave

Në rastet e caktuara, C++ kryen vlerësim të kushtëzuar (angl. conditional evalua-tion, ose short-circuit) shprehjes.

Për shembull, gjatë njehsimit të shprehjes:

```
(alfa > 0) && (alfa < 90)
```

për alfa = -30^0, nënshprehja e majtë (alfa > 0) fiton vlerë false dhe pavarësisht prej vlers së nënshprehjes së djathtë (`alfa < 90`), vlera e gjithë shprehjes është `false`. Prandaj, në rastin e shprehjes me operatorin &&, nënshprehja e djathtë nuk njehsohet.

Ngjashëm, gjatë njehsimit të shprehjes:

```
(x < -1) || (x > 1)
```

për x = –2, vlera e nënshprehjes është true dhe pavarësisht prej vlerës së nënshprehjes së djathtë, gjithë shprehja fiton vlerë true. Prandaj, nënshprehja e djathtë nuk njehsohet.

Shembulli 1.7.6

Me këtë shembull shtypet tabela e funksioneve logjike AND, OR dhe NOT, të njehsuara varësisht prej vlerave të dy ndryshoreve logjike a dhe b.

```
1   #include <iostream>
2   using namespace std;
3
4   int main() {    // Lloj logjik i të dhënave
5
6       bool a, b;
7       cout << "----------------------------------------" << endl;
- **Struktura kontrolluese algoritmike** janë struktura speciale me të cilat kontrollohet realizimi i algoritmeve.
- **Programimi i strukturuar** është programim te i cili shfrytëzohen teknikat: programimi prej lart pshtë dhe programimi modular.
- Me teknikën **programimi prej lart poshtë** ndahet (zbërthehet) detyra në detyra më të vogla dhe më të thjeshta të ashtuquajtura **nëndetyra**.
- Teknika **programimi modular** përbëhet në programimin e tërësive të pavarua pre algoritmit si module të veçanta, të cilët pastaj bashkohen sekuencijalisht në një tërësi.

- **Gjuha makinerike** është gjuhë te e cila imstuksionet makinerike dhe të dhënat shprehen me zero dhe njëshe.
- **Gjuhë simbolike** janë gjuhë te të cilat instruksionet makinerike dhe të dhënat shprehen me simbole (mnemonic).
- **Asemblere** janë përkthyes të cilët programin prej gjuhës simbolike e përkthejnë në program të gjuhës makinerike.
- **Gjuha programore e lartë** janë gjuh të gjuhëve natyrore, te t clat sot (më së shpeshti) programohet.
- Gjuhët programore të larta janë **gjuhë makinerike të pavarura** pasi nuk vren prej makinës te e cila realizohen programet (me përkthim të mëparshëm).
- Gjuhët programore të larta janë **gjuhë problemore të orientuara** pasi impnohen për problem prej fushave të veçanta (ekonomi, teknikë, inteligjenca artificijale etj.).
- **Gramatika** e gjuhës programore është bashkësi e rregullave për ndërtimin e fjalëve dhe urdhërave.
- **Sintaksa** është bashkësi e rregullave për ndërtimin e urdhërave te gjuhët programore.
- **Semantika** është domethënia e ndonjë udhëri, d.m.th., veprime që ajo i shkakton gjatë realizimit.
- **Fjalët e rezervuara** janë fjalë të veçanta të rezervuara për gjuhën programore.
- Disa prej fjalëve të rezervuara janë **fjalët kyçe** pasi kanë domethënie të veçantë për gjuhën programore.
- **Identifikator** janë fjalë të cilët i formojnë programuesit sipas rregullave të caktuara dhe patjetër të jenë të ndryshme prej fjalëve t rezervuara te gjuha programore.
- **Përkthyes (kompajler)** është program special për përkthim të programit burimit në programin makinerik.
- **Interpretator** janë programe speciale të cilët direkt e realizojnë (interpretojnë) programin burimor.
- **Gjuhë skripte** janë gjuhë programore për integracion dhe komunikim me gjuhë tjera programore.
- **Gjuhë programore imperative** janë ato te të cilat për përpunimin e të dhënave shfrytëzohen urdhëra.
- **Gjuhë programore deklarative** janë ato te të clat përshkruhet se si të vjen deri te rezultati.
- **Gjuhë programore procedurale** janë gjuhë imperative te të cilat shfrytëzohen **procedura** (funksione) (grup prej urdhërave të shprehura si një tërësi).
- **Gjuhë objekte të orientuar** janë gjuhë imperative te të cilat të dhënat janë shprehr si atribut të objekteve, por sjelloja e objekteve shprehet me funksione.

- **Gjuhë funksionale** janë gjuhë deklarative te t cilt shfrytëzohen shprehje dhe funksione.
- **Gjuhë logjike** janë gjuhë deklarative te të cilat gjatë njehsimeve, shfrytëzohen relacione, fakte, përfundime dhe metoda për përfundim.
- **Unified Modeling Languge – UML** është gjuhë e veçanr grafike për të shprehur procese të ndryshme (vijimi i algoritmit, kalimi prej njërës gjendje në tjetrën dhe të ngjasme).
- **Rrethina e integruar zhvillimore** është rrethina me aplikime të cilat shfrytëzohen gjatë programimit.
- **Microsoft Visual Studio** është rrethinë e integruar zhvillimore për të shkruar, redaktur dhe realizimi (testimi) i programeve.
- **Code::Blocks** është rrethinë e integruar zhvillimore për të shkruar, redaktur dhe realizimi (testimi) i programeve.
- **Redaktor tekstual – editor** është aplikacioni për të shkruar dhe redaktuar programe.
- **Dibager** është aplikacion për kërkesë të gabimeve logjike te programi.
- **Lidhës** është aplikim për lidhje të shumë datotekave (programeve) në datotekë të vetme.
- **Apikacioni** në C++ është program që e përmban funksionin kryesor main().
- **<iostream>** është bibliotekë që përmban funksione për operacione hyrëse dhe dalëse te programet.
- **namespace** është direktiva për formimin e hapësirës së emrit (varg) te memoria për emra të ndryshoreve, funksioneve dhe identifikatorëve të tjerë.
- **Funksioni** është program që pas realizimit jep rezultate.
- **Dhëmbëzimi** paraqet dhëmbëzim të urdhërave (më së shpeshti për një pozitë tabultorësh) për shkak të pamjes më të madhe rë programeve.
- **Funksioni kryesor** është ai me të cilin fillon realizimi i çdo aplikacioni.
- **Komentim** është çfarëdo qoftë tekst i venduar me dy viza të pjerrëta ose ndërmjet shenjave /* në fillim dhe */ në fund.
- **cout** është urdhër për shtypje.
- **cin** është urdhër për lexim.
- **<<** është operator për shtypje.
- **>>** është operator për lexim.
- **endl** është urdhër për kalimin në ndonjë vijë të re.
- **;** është shenjë për në fund të urdhrit, d.m.th., ndarës i urdhërave.
- **return 0;** është urdhër për mbarimin korrekt të aplikimit.
- **Struktura rendore** ose **sekuenca** është struktura te e cila urdhërat realizohen nërenditje sikurse që janë renditur.

- **Sekuenca (eskejp) dalëse** janë sekuenca speciale të shprehura me kombinim të vizës së pjerrtë të kundërt dhe ndonjë shkronje ose shenje. Për shembull, \n është eskejp sekuencë për kalimin në rresht të ri.
- **String** është varg prej shenjave të vendosura në thonjëza, të cilat trajtojnë sikurse lloj i veçantë i të dhënës.
- **Gjykim** (më së shpeshti) paraqet shprehje matematikore që ka vlerë. Shpesh, urdhërat te gjuhët programore quhen gjykime.
- **Madhësia** është masa për ndonjë karakteristikë të objektit ose dukurisë së dhënë.
- **Të dhëna** janë vlera me të cilat shprehen madhësitë.
- **Literale** janë vlera fikse të cilat nuk ndryshojnë.
- **Konstantat e emërtuara** ose vetëm **konstante** janë identifikator (emra të madhësive) te të cilat mund vetëm njëherë t'u jepet vlerë dhe ajo nuk guxon të ndryshojë gjatë realizimit të programit.
- **Ndryshore** janë identifikator (emra të madhësive) te të cilat mund t'u jepen vlera të ndryshme të programit.
- **Lloj** e dhënë paraqet bashkësi të fundshme të të dhënave mbi të cilën është përkufizuar bashkësi e fundshme e operacioneve.
- **Llojet e thjeshta** ose **të pastrukturuara të të dhënave** janë ato të cilat nuk mund të ndahen në pjesë.
- **Llojet e përbëra** ose **të strukturuara të të dhënave** përbëhen prej më shumë llojeve të thjeshta.
- **Llojet e adresave tëtë dhënave** janë ato vlera e të cilave është adresa e ndonjë lokacioni të memories.
- **Llojet e thjeshta të të dhënave** ose **lloje të ndërtuara të të dhënave** të quajtura dhe **llojet themelore t të dhënave** janë lloje numra të plotë, real, me shenja dhe logjike.
- **Specifikatorët e llojit** janë emra të llojeve.
- Të dhëna **unsigned** janë ato të cilat mund të kenë vetëm vlera jonegative.
- **String** është varg prej shenjave të vendosura në thonjëza.
- **Lidhja** është operacion për lidhje të dy stringeve njëri me tjetrin.
- **Deklarimi i ndryshores** është dhënia e llojit dhe të emrit të ndryshores.
- **Deklarimi dhe inicializimi i ndryshores** është dhënia e llojit dhe të emrit dhe shoqërimi i vlerës fillestare të ndryshores.
- **Përkufizimi i ndryshores** është shoqërimi i vlerës gjatë deklarimit dhe inicializimit se shoqërimi i vlerës me urdhër për shoqërim të tani më ndryshores së deklaruar.
- **Lloj numër i plotë i të dhënave** është e dhënë me vlerë prej bashkësisë së numrave të plotë Z = {... –2, –1, 0, 1, 2... }, por varësisht prej bashkësisë, llojeve të të dhënave numra të plotë deklarohen e fjalët: **short**, **int**, **long, longlong, unsigned short, unsigned int, unsigned long dhe unsigned long long**.

- **Forma e shkurtuar e operatorëve** (ose **operatorët** e **përbërë**) shprehet me operator aritmetik dhe operatori për shoqërim =. Për shembull, +=, –=, *= etj.
- **Lloj real i të dhënës** është ajo e dhënë që fitn vlera prej bashkësisë së numrave real (mendohet në numra dhjetor), por deklarohet me fjalët: **float, double** dhe **long double**.
- Paraqitja e numrit dhjetor me **pikë të palëvizshme** është kur numri dhjetor shkruhet me pikë dhjetore në vendin e fiksuar, që saktë i ndan pjesën e plotë dhe dhjetore të numrit.
- Paraqitja e numrit dhjetor me **pikë lëvizëse** është kur numri dhjetor shkruhet me pikë dhjetore në çfarëdo vendi, që shfrytëzohet eksponent për vendet e zhvendosura.
- **Konversioni implicit** (automatik) ose **lloj i detyruar** është shoqërimi i vlerës së ndryshores prej llojit jo përkatës.
- **Konversioni i llojit eksplicit** ose **hidhja e llojit** është listimi i llojit te i cili duam të kovertojmë ndryshoren ose shprehjen.
- **Operatori për inkrementim** është ++.
- **Operatori për dekrementim** është – –.
- **Lloj me shenja të të dhënës** mund të ketë vlerë çfarëdo qoftë shenjë ose çfarëdo qoftë vlerë numër i plotë dhe deklarohet me fjalën **char**.
- **lloj logjik** i të **dhënës** mund të ketë vlerë ose true ose false, por deklarohet me fjalën **bool**.
- **Operator logjik** ose **operator i kushtëzuar** janë: &&, || dhe !.
- **Funksionet e Bulit** janë: NOT, AND dhe OR.
- **Shprehje logjike** është shprehje vlera e të cilës mund të jetë true ose false.
- **Operator të relacionit** janë: <, <=, >, >=, ==, !=.
- **Operator me bite** janë: &, |, ^, ~, << dhe >>.
- **Lloj i numërueshëm** i të **dhënës** mund të ketë vlerë prej përpara të bashkësisë së përkufizuar të konstantave (vlerat literale), të cilat patjetër të jenë identifikator, por jo numra. Deklarohet me fjalën **enum**.
- **E dhëna tekstuale** është varg prej shenjave të vendosura në thonjëza.
- **Riemërtimi** i llojit të të dhënës paraqet dhënie në tjetër emër (sinonim) për llojin.
- **Caktimi automatik i llojit** kryhet me fjalën auto, ku lloj i ndryshores e cakton përkthyesin, sipas llojit të shprehjes i cili i shoqërohet ndryshores.
- **Heder-datoteka** janë datoteka prej ***bibliotekës standard të C++*** të cilët janë të kyçur me direktivën #include dhe vendohen në thonjëza këndore <>.
- **Mbushja** ndod kur vlera e ndryshores është jashtë prej vargut të llojit prej të cilit është deklaruar.

- **Operatori për futje** (insertim) << është lidhur me pajisjen dalëse standarde të kompjuterit, më së shpeshti monitorin.
- **Operatori për ndarje** (ekstrakcion) >> është lidhur me pajisje hyrëse standarde të kompjuterit, më së shpeshti monitorin.
- **Shenja për vijën e re** është shenja që gjeneron me shtypjen e butonit Enter.
- **Përrua dalëse** e të dhënave paraqet varg prej shenjave të të dhënave që shtypen.
- **Përrua hyrës** i të dhënave paraqet varg prej shenjave të të dhënave që lexohen.
- **<string>** është biblioteka e cila përmban funksione për punë me stringe.
- **<iomanip>** është biblioteka e cila përmban manipulator për shtypjen e formatimit.
- **<ostream>** është biblioteka e cila përmban urdhëra për përrua dalëse.
- **<istream>** është biblioteka e cila përmban urdhëra për përrua hyrëse

Përmbledhje

- Të gjitha programet të cilat munet të Realizon kompjuteri, me një emër quhet softuer.
- Puna e kompjuterit është e kontrolluar me të ashtuquajturën sistem programor.
- Për t'u realizuar çfarëdo qoftë program me ndihmën e kompjuterit, patjetër të ekziston program aplikativ që kompjuteri mund ta realizojë.
- Që të mund të realizohen çfarëdo aktivitete, duhet të njihet numri i saktë i aktiviteteve (elementare) që duhet të realizohen dhe renditja e tyre e realizimit. Lista e aktiviteteve elementare (hapave) të shkruara sipas renditjes së realizimit paraqet algoritëm.
- Gjatë realizimit të algoritmit, futen të dhëna hyrëse, por fitohen rezultate dalëse. Ndonjëherë, rezultatet dalëse nuk fitohen direkt, por nëpërmjet ndërmjet rezultateve.
- Varësisht prej hapave algoritmike, algoritmi mund të jetë i përgjithshëm ose detal.
- Algoritmet mund të shkruhen tekstualisht me pseudo gjuhë, grafikisht me bllok-diagram ose me urdhërat e ndonjë gjuhe programore. Paraqitja grafike mund të jetë me bllok-diagrame standarde ose me të strukturuara.
- Procesi i të shkruarit të algoritmit me urdhër prej ndonjë gjuhe programore quhet kodim, por teksti i fituar quhet program burimor.
- Programi burimor e shkruar te ndonjë gjuhë programore mund të përkthehet me përkthyes në program realizues, që procesori mund ta realizojë ose njëkohësisht ta përkthen (interpreton) dhe realizon me interpretator.
- Për kontroll më të lehtë gjatë realizimit të algoritmeve, ato shkruhen me struktura kontrolluese algoritmike. Sipas tyre, programimi i atillë e ka fituar emrin programimi i strukturuar.
- Programimi i strukturuar është mënyrë e programimit te i cili shfrytëzohen metodat: programimi prej lart poshtë (zbërthimi i detyrës në detyra më të thjeshta) dhe programimi modular (përpunimi i programeve të veçanta për tërësi të pavarura).
- Të zgjidhurit e detyrës me ndihmën e kompjuterit përbëhet prej disa fazave: vendosja e detyrës, përkufizimi i algoritmit, të shkruarit e programit (programimi) dhe testimi i programit.
- Gjatë vendosjes së detyrës, saktë duhet të përkufizohen dhe të precizohen kushtet nën të cilat ajo zgjidhet.
- Gjatë përkufizimit të algoritmit, paraprakisht duhet të kuptohet detyra, të realizohet analiza e të dhënave hyrëse që duhet të përpunohen, a janë të nevojshme formula dhe/ose metoda dhe çfarë rezultate duhet të fitohen.

Pastaj, shkruhet algoritmi i cili mund të programohet dhe program të realizohet në kompjuter.

- Pas përgatitjes së programit, ai duhet të testohet a punon drejtë (a fitohen rezultate të sakta) për të dhëna të ndryshme hyrëse, për të cilët njihen rezultatet.
- Gjuhët programore janë gjuhë artificial të cilat ndahen në: gjuhë programore të larta (te të cilat shkruhen programet), gjuhë simbolike (te të cilat mund, por jo patjetër të përkthehet programi) dhe gjuha makinerike (te e cila përkthehet program që të mund kompjuteri ta realizojë).
- Në gjuhën makinerike, dhe instruksionet dhe të dhënat shkruhen me bite, d.m.th., me shifra 0 dhe 1.
- Te gjuhët simbolike, dhe për instruksionet dhe për të dhënat shfrytëzohen simbole. Gjuhët simbolike janë të orientuara në mënyrë makinerike pasi çdo familje e procesorëve kanë gjuhë simbolike personale.
- Çdo gjuhë programore e lartë ka: gramatikë, fjalor prej fjalëve të rezervuara (dhe kyçe), rregulla për formimin e identifikatorëve (konstante dhe të ndryshueshme), rregulla sintaksore (sintaksa) për konstruksionin e urdhërave dhe rregulla semantike për kontroll të domethënies së urdhërave.
- Gjatë të shkruarit e programit (programimi), programuesit mund të formojnë fjalë (identifikator) me rregulla të veçanta, me të cilat do t'i emërtojë të dhënat që përpunohen. Identifikatorët nuk guxojë të jenë fjalë të rezervuara.
- Nëse program burimor përkthehet me përkthyes (kompajler), atëherë bëhet datoteka realizuese e programit në formën makinerike. Nëse program burimor interpretohet me interpretator, atëherë nuk bëhet datoteka e realizueshme, por interpretatori i interpreton dhe realizon urdhërat.
- Gjuhët e skripteve shërbejnë për komunikim me gjuhë të tjera programore. Për ato nuk është e nevojshme përkthyes, por interpretator.
- Proraet burimore ka prapashtesë sipas emrit që është shkurtesë prej gjuhës në të cilën janë shkruar. Për shembull:.cpp,.java,.pas,.for etj. Programet e realizuara kanë prapashtesë.exe,.com,.bat,.bin,.dll etj.
- Ka shumë gjenerata të gjuhëve programore.
- Sipas mënyrës së përpunimit të të dhënave, gjuhët programore ndahen në: imperative (procedural dhe objekte të orientuara) dhe deklarative (funksionale dhe logjike).
- Në programimin objekt të orientuar shfrytëzohen objekte të cilat kanë atribute të veta (të dhëna) dhe sjelloja ose gjendja (e shprehur me funksione).
- Për paraqitje grafike të algoritmeve dhe proceset te ndonjë algoritëm, shfrytëzohet gjuha Unified Modeling Languge – UML.
- Sot ekzistojnë rrethina të ndryshme të integruara zhvillimore për programim në C++, por më të njohura janë: Microsoft Visual Studio, Code::Blocks, NetBeans dhe të tjera.

- Çdo rrethinë integruese zhvillimore ka: redactor të tekstit, përkthyes, lidhës dhe dibager.
- Gjuha C++ është gjuha për programim objekt të orientuar, të dizajnuar prej Bjarne Stroustrup (Bjarne Stroustrup) në vitin 1983, si përmirësim të gjuhës „C me klasa“ prej vitit 1980, që, pra, është përmirësim të gjuhës C prej vitit 1972 të dizajnuar prej Dennis Ritchie (Denis Riçi)).
- Programi (aplikimi) i shkruar në C++ patjetër të ketë një funksion kryesor (main()) prej të cilit fillon realizimi edhe të funksioneve të tjera të cilat thirren prej funksionit kryesor.
- C++ është ndërmjet gjuhëve të para programore objekte të orientuara.
- Për realizimin e operacioneve hyrëse-dalëse, në fillim prej programit patjetër të kyçet biblioteka <iostream>.
- Për pamje më të madhe të programit, vendohen vija të zbrazëta dhe komentime, të cilat nuk përkthehen, por kryhet dhe dhëmbëzimi i programit.
- Çdo urdhër në C++ mbaron me pikëpresje (;).
- Programet në C++ mund të shkruhen me çfarëdo redaktues të tekstit.
- Programet në C++ përbëhen prej funkioneve. Funksioni kryesor quhet main().
- Trupi i çdo funksioni vendohet në kllapa të mëdha.
- Çdo aplikim patjetër të ketë vetëm një funksion kryesor, me të cilën fillon realizimi i plikimit.
- Urdhri për shtypjes në C++ është cout, që shfrytëzohet me operatorin për shtypje <<.
- Urdhri për shtypjes në C++ është cin, që shfrytëzohet me operatorin për lexim>>.
- Funksioni kryesor në C++ kthen rezultat 0 nëse është realizuar në mënyrë korrekte.
- Urdhri vijues pas urdhrit për shtypje që në fund e ka manipulatorin end shtyp në vijën e re (rresht i ri).
- Për shtypjen e shenjave special, sikurse”...“, ’... ’, \ etj., shfrytëzohet sekuenca dalëse (eskejp).
- Gjuha C++ ka gramatikë, sintaksë, semantik, fjalë të rezervuara, identifikator (fjalë të formuara prej programuesve) dhe elemente të tjera të një gjuhe programore.
- Gjatë përkthimit të programit, me rregulla sintaksore kontrollohet të shkruarit e drejtë të çdo urdhri.
- Çdo urdhër te program patjetër të ketë saktë domethënie të përkufizimit dhe të shkakton saktë veprime përkufizuese. Kjo kontrollohet me rregulla semantike të gjuhës.
- Me të dhënat shprehet vlerat e madhësive, por madhësitë janë masa për karakteristikat e objektee ose të dukurive. Të dhënat mund të jenë konstante (kanë një vlerë të pandrysheueshme) ose ndryshore (vlera mund të ndryshojë).

- Gjatë deklarimit të konstantave në C++, para llojit të tyre vendohet fjala const.
- Çdo e dhënë ka: emër, lloj dhe vlerë.
- Emrat (identifikatorët) e të dhënave në C++ mund të jenë: fjalë të rezervuara (te të cilat bëjn pjesë edhe fjalët kyçe) ose emra të përkufizuara shfrytëzuese (identifikator), të cilët formojnë sipas rregullave të caktuara. Fjalët e rezervuara nuk mund të shfrytëzohen si identifikator.
- Llojet e të dhënave në C++ mund të jenë të thjeshta (të pastrukturuara), të përbëra (të strukturuara – të cilat përbëhen prej llojeve të thjeshta) dhe me adresë (vlera e të cilës është adresa e lokacionit të memories).
- Llojet e thjeshta janë: integral (numra të plotë, me shenja dhe logjike), reale dhe të numërueshme.
- Lloj të përbërë janë: varg, struktura, unioni dhe klasa.
- Konstantat dhe ndryshoret deklarohen duke përmendur llojin dhe emrin. Nëse te deklarimi jepet vlera e konstantes ose ndryshorja, atëherë kryhet deklarimi dhe inicializimi.
- Për t'u dalluar konstantat prej ndryshoreve, praktikohet ato të shkruhen me të gjitha shkronjat e mëdha, por fjalët te emri i konstantave të ndahen me vizë të gjatë.
- Konstantat deklarohen me fjalën const sipas të cilës përmendet lloj dhe emri, por pastaj, patjetër të shtohet vlera e konstantes me operatorin për shoqërim =.
- Para se të shfrytëzohet te program, ndryshorja patjetër të jetë e përkufizuar me dhënien e vlerës, qoftë me inicializim, qoftë me urdhër për shoqërim.
- Kur ndonjë ndryshoreje i shoqërohet vlerë më e madhe ose më e vogël prej vargut të llojit të tij, vjen deri te mbimbushje ose nënmbushje dhe paraqitet gabimi.
- Lloj numër i plotë dhe lloj me shenja mund të jenë edhe të pa shënuara.
- Specifikuesit e llojeve të taksave:
  - për lloj numër të plotë: short, int, long dhe long long.
  - për lloj me shenja: char.
  - për lloj të numërueshëm: enum.
  - për strukturë: strukt.
  - për klasë: class.
  - për referencë: reference.
  - për lloj real: float, double dhe long double.
  - për llojlogjik: bool.
  - për varg: array.
  - për union: union.
  - për tregues: pointer.
- Lloji i të dhënave integer janë vlera nga grupi i numrave të plotë {... –2, –1, 0, 1, 2...}.
- Format e shkurtuara të operatorëve aritmetikë: +, –, * dhe / për të dhëna të plota dhe reale janë: +=, –=, *=, /=. Operatori %= është një formë e shkurtër e

operatori % për lloj numër të plotë të të dhënave. Këta operatorë quhen operator të përbërë.

- Lloj real i të dhënave janë vlera prej bashkësisë së numrave realë (dhjetor) {... –2.0..., –2.001..., –1.0..., 0.0..., 1.0..., 2.0...}.
- Gjatë deklarimit të ndryshoreve të llojit float, duhet të vendohet prapashtesa (sufiksi) f ose F. Në të kundërtën, ato do të trajtohen si ndryshore të llojit double.
- Të dhënat dhjetore në gjuhët programore paraqiten në format dhjetor (f-format, F-format) (mënyra e njohur si pikë e palëvizshme) edhe në formatin eksponencial (e-format, E- format) (mënyra e njohur si pikë lëvizëse).
- Shkronja f vjen prej fjalës „float“, por shkronja e vjen prej fjalës „exponent“.
- Numrat dhjetor te f- format ose F- format) shkruhen me pikë dhjetore në vendin fiks.
- Kur numrat dhjetor shtypen në e- format (ose E- format), shkruhen v*etëm një shifër* majtas prej pikës dhjetore, por shkronja e ose E shkruhen para eksponentit.
- Shoqërimi i vlerës së ndryshores prej llojit jopërkatës kryhet me konversionin, por mund të jetë implicit (automatik) ose eksplicit (me hedhje). Në rastin e dytë, përmendet lloj te i cili duhet të konvertohet vlera prej llojit jopërkatës, por në rastin e parë, nuk përmendet.
- Për zmadhim/zvogëlim vlera e ndryshores numër i plotë ose me shenja për 1, shfrytëzohet operatori për inkrementim (++) ose operatori për dekerementim (– –).
- Të dhënat prej llojit me shenja mund të ketë vlerë çfarëdo shenje ose çfarëdo vlerë numër i plotë. Ato vendohen në gjysmëthonjëza.
- Lloj logjik i të dhënave mund të ketë vetëm vlerë të konstantave speciale true ose false.
- Gjatë njehsimit të shprehjeve logjike, konstantat logjike true dhe false kanë vlerë 1 dhe 0.
- Për operacionet me lloj logjik të të dhënave, shfrytëzohen operatorët logjikë (të kushtëzuar): &&, || dhe !. Ato janë operator për funksionet e Bulit AND (**DHE**), OR (**OSE**) dhe NOT (**JO**).
- Operatorët e relacionit janë: <, <=, >, >=, == (e barabartë) dhe != (e ndryshme).
- Operatorët me bite janë: & (logjike DHE), | (logjike OSE), ^ (jashtëzakonshme OSE), ~ (komplement), << (zhvendosje majtas për 1 vend) dhe >> (zhvendosje djathtas për 1 vend.
- Lloj i numërueshëm deklarohet me fjalën enum, por konstanta vendohet në listë me kllapa të mëdha dhe shkruhet me shkronja të mëdha. Pas pjesës dalëse prej kllapave të mëdha, nuk vendohet pikëpresje (;).
- Lloj i numërueshëm përkufizohet para funksionit main();

- Stringet ose të dhënat tekstuale janë të dhëna të përbëra prej vargut të shenjave të vendosura në thonjëza.
- Për punën me stringe, shfrytëzohen funksione prej bibliotekës <string>, e cila patjetër të kyçet në programin me direktivë #include.
- Shpesh, për shkak të lexueshmërisë së programit dhe gjendshmëria më e lehtë në atë, për emrat e llojeve të ndërtuara të të dhënave është e dëshirueshme të shfrytëzohen sinonime (tjera emra) të cilat do të na përkujtojnë në diçka, me fjalën kyçe typedef.
- Kur duam llojin e ndryshores të caktohet sipas llojit të shprehjes që i shoqërohet, ai deklarohet me fjalën auto.
- Leximi i të dhënave në C++ është organizuar si përrua hyrëse prej shenjave, ndërsa shtypja është organizuar si përrua dalës prej shenjave.
- Urdhri për lexim prej hyrjes standard është cin, por urdhri për shtypje të daljes standard është cout. cin dhe cout janë ndryshore prej bibliotekës <iostre-am>. cin është prej llojit istream që është lidhur me përruan hyrëse të të dhënave, por cout është prej llojit ostream që është lidhur me përruan dalëse të të dhënave.
- Vijat programore të cilat fillojnë me direktivën `#include` përkthyesi nuk i përkthen, por ato përpunohen me program të veçantë të quajtur paraprocesor.
- Datotekat të cilat janë kyçur te program me direktivën #include vendohen te kllapat këndore, me të cilat informohen paraprocesorët ato t'i kërkon në të ashtuquajturën direktorium include prej *bibliotekës standard të C++*.
- Për formatimin e të dhënave, gjatë shtypjes shfrytëzohen manipulator. Disa prej tyre përkufizohen në bibliotekë <iostream>, por disa përkufizohen në bibliotekë <iomanip>, e cila (sikurse edhe <iostream>) duhet të kyçet në fillim prej programit.
- Me shtypjen e butonit Enter, gjenerohet shenja për vijë të re dhe kalon në vijë të re. Gjatë leximit të të dhënave hyrëse, lexohet deri sa nuk gjendet shenja për vijë të re.
- *Biblioteka standard e C++* përmban më shumë datoteka, të quajtura heder-datoteka të cilat përmbajnë grupe prej funksioneve të ngjashme. Më së shpeshti të shfrytëzuara heder-datoteka janë: <iostream>, <iomanip>, <cmath>, <string>, <cctype> dhe të tjera.

MODULI

KONTROLLI I RRJEDHJES DHE FUNKSIONET NË C++

2

Në këtë kapitull do të njiheni me këtë:

- Strukturat kontrolluese algoritmike.
- Shfrytëzimi i renditjes së strukturës kontrolluese algoritmike.
- Struktura kontrolluese algoritmike për zgjedhje prej dy mundësive **nëse–atëherë–ndryshe** dhe urdhri kontrollues për zgjedhje prej dy mundësive if-else.
- Folezimi i urdhrit kontrollues për tgjedhje prej dy mundësive if-else.
- Struktura kontrolluese algoritmike për zgjedhje prej më shumë mundësive **rast** dhe urdhri kontrollues për zgjedhje prej më shumë mundësive switch.
- Shfrytëzimi i operatorit të kushtëzuar?:.
- Struktura kontrolluese algoritmike për përsëritje **derisa–realizo, realizo–derisa dhe për–deri–hapi** dhe urdhri kontrollues për përsëritje while, do-while dhe for.
- Shfrytëzimi i operatorëve për inkrementim (++) dhe për dekrementim (—)
- Struktura kontrolluese algoritmike për kërcim (**vazhdo, ndërpre, dalje, kërcim**) dhe urdhëra kontrolluese për kërcim (continue, break, exit(), goto).
- Funksione biblioteke në gjuhën programore C++.
- Funksione shfrytëzuese: përkufizimi, deklarimi dhe thirrja.
- Deklarimi dhe shfrytëzimi i ndryshoreve globale dhe lokale.
- Funksione të përmirësuara.

Fjalë kyçe

:: operator për zgjidhjen e fushës së pamjes.	Funksion shfrytëzues
?: operator i kushtëzuar	Funksion shfrytëzues i përkufizuar
break	Lista e argumenteve
continue	Lista e parametrave
do-while	Ndryshorja lokale
exit()	Funksioni shfrytëzues
for	Programimi modular
goto	Parametra
if	Nnalgoritme
if-else	Nëndetyra
inline	Fusha e pamjes
switch	Fusha e qasjes
void	**fillimi–fund**
while	**ndërprerje**
nëse-atëherë	Bartja e argumentit sipas vlerës
nëse-atëherë-ndryshe	Bartja e argumentit sipas referencës
Struktrura kontrolluese algoritmike	**Programimi prej lart poshtë**
Struktrura kontrolluese algoritmike për zgjedhje prej dy mundësive	**vazhdo**
Bllok algoritmik	Procedura
Argument	Nënalgoritmi procedural
Argumenti i bartur sipas vlerës	Struktrura kontrolluese algoritmike rendore (sekuenca)
Argumenti i bartur sipas referencës	**Ndryshorja referente**
Funksione të përmirësuara	Referenca
Argument i vërtetë	Referencimi
Parametri hyrës	Biblioteka standarde
Argument hyrës formal	**kërcim**
Parametri hyrës-dalës	Ndryshorja e fshehur
Argumenti formal hyrës-dalës	**rast**
dyer	Ndryshorja statike

Ndryshoret globale	Argumenti formal
derisa–realizo	Parametri formal i llojit
Jeta e ndryshores	Funksioni
për–deri–hapi	Funksioni pa vlerë kthyese
për–zmadho–deri	Funksioni me vlerë kthyese
për–zvogëlo–deri	Nënprogrami funksional
realizo–deri	Nënalgoritmi funksional
dalje	Nënshkrimi funksional
Parametri dalës	Prototip funksional
Argumenti formal dalës	Përsëritja ciklike
Parametri konstant	Cikli

Te nënpikat **1.1, 1.2** dhe **1.3** prej **MODULIT 1: Hyrje në gjuhën programore C++**, u njohtëm me konceptet algoritëm, hapat algoritmike, mënyra e paraqitjes së algoritmeve dhe programimin e strukturuar. Për përshkrim të rrjedhës së algoritmeve gjatë programimit të strukturuar, shfrytëzohen të ashtuquajtura **struktura kontrolluese algoritmike** të veçanta. Me ato nuk realizohet kurfar njehsime, por caktohet renditja e realizimit të hapave algoritmike d.m.th., drejton me renditjen e hapave të realizuara.

Në teorinë e programimit është e njohur se rrjedha e çdo algoritmi mund të kontrollohet me shfrytëzimin e këtyre strukturave kontrolluese algoritmike:

- **Struktura kontrolluese rendore** ose **sekuenca** (angl. sequence).
- **Struktura kontrolluese për zgjedhje** ose **selektim** (angl. selection).
- **Struktura kontrolluese për përsëritje** ose **iteracion** (angl. iteration).

Struktrura kontrolluese algoritmike e parë është e njohur edhe nën emrin **struktura kontrolluese vijore**, e dyta është e njohur edhe nën emrin **struktura kontrolluese e degëzuar**, por e treta është e njohur edhe nën emrin **struktura kontrolluese ciklike**.



figura 2.1

Çdo strukturë kontrolluese algoritmike ka vetëm një pikë hyrëse (●) dhe vetëm një pikë dalëse (⊙), ***figura 2.1***.

2.1 Struktura kontrolluese rendore

Kjo strukture kontrolluese përbëhet prej hapave algoritmik të cilët realizojnë sipas asaj renditje me të cilën janë përmendur. Atë e shfrytëzojmë te të gjithë shembujt e deritanishëm.

Grafikisht, struktura është paraqitur te ***figura 2.1.1***.

Çdo strukture kontrolluese rendore paraqet tërësi të veçantë dhe mund të paraqitet kudo te algoritmi. Prandaj, është e nevojshme të shënohet fillimi dhe fundi i strukturës. Ajo bëhet e fjalët **fillim** (angl. begin) dhe **fund** (angl. end), ***figura 2.1.2.*** Struktura kontrolluese algoritmike rendore quhet **fillim–fund**.



Figura 2.1.1

```
fillim
        hapi A;
        hapi B;
        ...
fund
```

***Figura* 2.1.2**

Shenja ; (pikëpresje) shfrytëzohet për ndarje të hapave te strukturë kontrolluese rendore **fillim–fund.** Përmbajtja e strukturës kontrolluese rendore është një **bllok** prej hapave, por për pamje më të madhe hapat shkruhen pak ë tërhequr djathtas prej fjalëve **fillim** dhe **fund**. Fjalët fillim dhe fund shkruhen në vertikalen e njëjtë. Kjo vlen për të gjitha strukturat kontrolluese algoritmike.

Kjo mënyrë e të shkruarit të algoritmeve dhe programeve me tërheqje (më së shpeshti për një pozitë tabulatore), quhet **dhëmbëzi** (angl. indentation). Dhëmbëzimi shfrytëzohet për pamje më të madhe dhe për njohje më të lehtë të strukturës kontrolluese algoritmike dhe të programeve.

Struktura kontrolluese algoritmike **fillim–fund** më së shpeshti shfrytëzohet në hapat për dhënien e vlerave fillestare dhe të të dhënave edhe gjatë njehsimeve.

Për shembull:

```
fillim  {Vlerat fillestare}
    a ← 3;
    b ← –5.74;
    c ← '@';
fund
```

Poashtu shigjeta majtas ← cshfrytëzohet se symbol për shoqërim të vlerave të ndryshoreve.

Te të gjitha programet që i shkruajtëm te **Moduli 1: Hyrje në gjuhën programore C++**, shfrytëzuam strukturë kontrolluese algoritmike **fillim–fund** pasi urdhërat i shkruajtëm njëra ps tjetrës.

Në disa raste, nëse duhet të shënohet grupi i urdhërave me të cilët realizohej një hap algoritmik (për shembull, hapi: leximi i të dhënave), grupi vendohet në kllapa të mëdha {}. Kllapat {} e shënojnë bllokun e urdhërave të cilat duhet të realizohen.

Kështu,, struktura kontrolluese algoritmike **fillim–fund** prej ***figura 2.1.2***, do të shkruhet si te ***figura 2.1.3***.

```
{
        urdhri A;
        urdhri B;
        ...
        urdhri P;
}
```

Figura 2.1.3

Për shembull, segmenti algoritmik për dhënie vlera fillestare të të dhënave, do të shkruhet me këtë segment programor:

```
{       // Vlera fillestare
        a = 3;
        b = -5.74;
        c = '@';
}
```

Vërejtje: Pas kllapave {}, nuk vendohet shenja pikë

Pas ekzekutimit të segmentit të programit të mëposhtëm

```
{
        a = 2;
        b = 3;
        p = a;
        a = b;
        b = p;
}
```

vlerat e ndryshoreve a dhe b do të jenë 3 dhe 2.

2.2 Strukturat kontrolluese algoritmike për zgjedhje dhe urdhëra kontrolluese për zgjedhje

Struktura kontrolluese algoritmike për zgjedhje prej dy mundësive **nëse–atëherë–ndryshe**

Struktura kontrolluese algoritmike për zgjedhje prej dy mundësive shfrytëzohet për zgjedhje të njërës prej dy kaheve të mundshme të vazhdimit të veprimit te algoritmi, varësisht prej ndonjë kushti. Kushti i ndonjë shprehje logjike. Shprehja logjike mund të ketë vetëm dy vlera: *saktë* dhe *pasaktë*. Ato quhen *vlera logjike* dhe prandaj, shprehja quhet *shprhje logjike*.



figura 2.2.1

Struktura kontrolluese për zgjedhje prej dy mundësive grafikisht është paraqitur te ***figura 2.2.1.***

Nëse vlera e s*hprehjes logjike është e saktë*, **atëherë** realizohet hapi A, **ndryshe** (nëse vlera është *e saktë*) realizohet haçi B. Prandaj, kjo strukture kontrolluese quhet **nëse–atëherë–ndryshe** (angl. if-then-else).

Shënimi tekstual strukturës të pseudo gjuhë është dhënë te ***figura 2.2.2***.

```
nëse  shprehje logjike
        atëherë
                hapi  A;
        ndryshe
                hapi  B;
fund_nëse  {shprehje logjike}
```

figura 2.2.2

Struktura fillon me **nëse**, por mbaron me **fund_nëse** {*shprehe logjike*}. Për shembull, te ***figura 2.2.3*** është shfrytëzuar kjo strukturë për gjetjen e nmrit më të madh prej numrave a dhe b.

```
nëse  a > b
        atëherë
            më i madh ← a;
        ndryshe
            më i madh ← b;
fund_nëse {a > b}
```

Figura 2.2.3

Treguam se hapat te një algoritëm mund të jenë më të përgjithshme dhe të përbëhen prej më shumë hapave tjerë ose madje edhe prej strukturave kontrolluese të plota. Nëse hapi A dhe hapi B prej ***figura 2.2.2*** përbëhen prej hapave tjerë, atëherë ato paraqesin një bllok **algoritmik** dhe më së shpeshti shënohet me fjalët **fillim** dhe **fund**, si te ***figura 2.2.4***. Domethënë, hapat A1, A2... An dhe B1, B2... Bm janë blloqe algoritmike në mundësi **atëherë**, përkatësisht në mundësinë **ndryshe**.

```
nëse  shprehje logjike
        atëherë
                fillimi
                        hapi  A1;
                        hapi  A2;
                        ...
                        hapi  An;
                fund
        ndryshe
                fillimi
                        hapi  B1;
                        hapi  B2;
                        ...
                        hapi  Bm;
fund
fund_nëse  {shprehje logjike}
```

Figura 2.2.4

Për shembull, për gjetjen e numrit më të madhprej dy numrave të dhënë a dhe b, me shfrytëzimin e kësaj strukture kontrolluese, do të shkruajmë:

```
më i madh ← b;
nëse  a > b
        atëherë
                më i madh ← a;
fund_nëse  {a > b}
```

Struktura kontrolluese për zgjedhje prejdy mundësive mund të shfrytëzohet edhe kur njëra prej mundësive të shprehjes logjike nuk përmban hapa realizues. Në këtë rast, vazhdohet te hapi vijues pas strukturës kontrolluese. Shënimi tekstual është dhënë te ***figura 2.2.5.***

```
nëse  shprehje logjike
        atëherë
                hapi  A;
fund_nëse {shprehje logjike}
```

Figura 2.2.5

Struktura kontrolluese e këtillë quhet nëse-atëherë (angl. if-then). then).

Paraqitja grafike e strukturës kontrolluese **nëse-atëherë** është dhënë te ***figura 2.2.6.***



Figura 2.2.6

Urdhri kontrollues për zgjedhje prej dy mundësive if

Me urdhrin kontrollues për zgjedhje if, realizohet struktura kontrolluese algoritmike për zgjidhje prej dy mundësive **nëse–atëherë**, ku njëra mundësi nuk a urdhër, ***figura 2.2.5*** dhe ***figura 2.2.6***. Shprehja logjike është ndonjë kusht për realizmin e udhëtarit A ose për mos realizimin, ***figura 2.2.7***.

```
if(kusht)
        urdhër A;
```

Figura 2.2.7

Gjatë realizimit të urdhrit kontrollues për zgjedhje if, së pari shqyrtohet kushti dhe nëse është plotësuar (ka vlerë true), realizohet urdhri A, por nëse nuk është plotësuar (ka vlerë false), nuk realizohet urdhri A, por realizimi i programit vazhdon me këtë urdhër.

Nëse duhet të realizohen më shumë urdhëra,ato veëndohen në bllok me kllapa të mëdha, ***figura 2.2.8.***

```
if(kusht) {
        urdhër 1;
        ...
        urdhër m;
}
```

Figura 2.2.8

Nëse *kushti* ka vlerë true, atëherë realizohen urdhërat prej bllokut {urdhri 1... urdhri m}, ndryshe urdhërat prej bllokut nk realizohen.
kusht mund të jetë vetëm shprehje logjike, i cili mundet të ketë vlerë true ose false.

Shprehjet logjike në C++ ndërtohen me operatorët e relacionit dhe logjike[1].
Shembuj përshprehje logjike janë:

```
(a > b) && (a >= c)
((alfa < 90) && (beta > 0)) || (alfa – beta > 0)
!(x <= y)                    njëjtë me    x > y
!((a > b) && (a >= c))       njëjtë me    (a <= b) || (a < c)
!((x != y) || (x > y))       njëjtë me    (x == y) && (x <= y)
```

Këta tre shembuj e ilustrojnë urdhrin kontrollues për zgjedhje **if**:

a)

```
int x;
if(x < 0)
        xaps = –x;
```

b)

```
int x;
if (x != 0)
     x = 0;
```

c)

```
int x, y, pom;
if (true) {
     pom = x;
     x = y;
     y = pom;
}
```

[1] Për ato folëm te **Llojet logjike të të dhënave** te nënpika **1.7. Llojet etë dhënave.**

Shembuj

Shembulli 2.2.1

Të shkruhet segment programor për konstatimin numri i future a është pozitiv.

```
int numri;
cout << "Futni nmër: ";
cin >> numër ;
if(numër  > 0) {
	cout << "Numri i future është pozitiv." << endl;
}
```

Shembulli 2.2.2

Të shkruhet segment programor për njehsimin e vlerës absolute.

```
int numri;
cout << "Futni numër të plotë: ";
cin >> numri;
cout << "Vlera absolte e numrit  " << numri;
if (numri < 0) {
	numri = -numri;
}
cout << " e " numri << endl;
```

Urdhri kontrollues përzgjedhje prej dy mundësive if-else

Me urdhrin kontrollues për zgjedhje if-else, realizohetstruktura kontrolluese algoritmike për zgjedhje prej dy mundësive **nëse-atëherë-ndryshe**, ***figura 2.2.1*** dhe ***figura 2.2.2.***

Gjatë realizimit të urdhrit kontrollues për zgjedhje if-else (***figura 2.2.9***), së pari shqyrtohet kushti dhe nëse është plotësuar (ka vlerë true), realizhet urdhri A, por nëse nuk është plotësuar (ka vlerë false), realizohet urdhri B.

Nëse duhet tërealizohen më sumë urdhëra kur është plotësuar kushti ose kur ai nuk është plotësur, ato urdhëra vendohen në bllok me kllapa të mëdha, f***igura 2.2.10***.

Nës *kushti* ka vlerë true, atëherë realizohen urdhërat prej bllokut { urdhër A1... urdhër Ap}, por nëse *kushti* ka vlerë false, realizohen urdhërat prej bllokut {urdhër B1... urdhër Bq}.

```
if(kusht)
	urdhër A;
else
	urdhër B;
```

Figura 2.2.9

```
if(kusht) {
	urdhër A1;
	...
	urdhër Ap;
}
else {
	urdhër B1;
	...
	urdhër Bq;
}
```

Figura 2.2.10

Shembuj

Shembulli 2.2.3

Nëse gjatë përgjigjes së saktë të ndonjë prerje duhet të përgjiget me një porosi, por gjatë përgjigjes të pasaktë me tjetrën, atëherë atë mundemi ta shkruajmë me këtë segment programor:

```
char përgjigje;
cout << "Futni përgjigjen P për të saktë: ";
cin >> përgjigje;
if (përgjigje == 'D')
	cout << "Përgjigja është e sakë." << endl;
else
	cout << "Përgjigja është e sakë." << endl;
```

Shembulli 2.2.4

Këndi alfa është këndi ngushtë nëse është më i madh prej 0^0 he më i vogël se 90^0. Kjo mund të shkruhet me këtë segment programor:

```
int alfa;
cout << "Futni kënd në shkallë: ";
cin >> alfa;
if ((alfa > 0) && (alfa < 90))
	cout << "Këndi është i ngushtë." << endl;
else
	cout << "Këndi është i ngushtë." << endl;
```

Shembulli 2.2.5

Segmenti programor vijues është i rregullt (përkthyesi nuk paraqet gabim), por punon gabimisht:

```
bool Po Jo;
cin >> Po Jo;
if (Po Jo = true) {
	cout << "Përgjigja është e saktë." << endl;
	cout << "Por segmenti është gabimisht." << endl;
}
else
	cout << "Përgjigja nuk është e saktë." << endl;
```

Çfarëdo vlere ta fsim për ndryshore Po Jo, segmenti gjithmonë shtyp `Përgjigja është e saktë.`

Gabimi është te kushti `Po Jo = true` pasi ai është urdhër për shoqërim (me operatorin =), por jo kusht për bari (me operator ==). Rezultati prej realizimit të tij gjithmonë është true dhe prandaj, gjithmnë shtypet `Përgjigja është e saktë.`

Shembulli 2.2.6

Shpeshherë është e nevojshme kontrolli i vlerës të emëruesit gjatë pjesëtimit të dy numrave pasi nukështë e lejuar pjesëtimi me 0. Segmenti programor vijues ilustron se si dhet të shmanget pjesëtimi me 0:

```
int n;
cout << "Futni numër të plotë: ";
cin >> n;
if (n != 0)
    cout << "Vler reciproke e  " << n << "është: " << 1./ n << endl;
else
       cout << "Nuk është e lejuar pjesëtimi me 0." << endl;
```

Ushtrime

Ushtrimi 2.2.1

Cilat prej këtyre segmenteve programore japin rezultat të njëjtë?

a)

```
if(a > b)
      cout << a;
Else
      cout << b;
```

b)

```
if(a > b)
      cout << a;
```

c)

```
if(a <= b)
      cout << b;
Else
      cout << a;
```

Ushtrimi 2.2.2

Cili është dryshimi ndërmjet këtyre segmenteve programore?

a)

```
if((a == b) || (a == c))
       cout << a << endl;
else
       cout << b << ' ' << c << endl;
```

b)

```
if((a != b) && (a != c))
       cout << b << ' ' << c << endl;
else
       cout << a << endl;
```

Ushtrimi 2.2.3

Çka punon ky segment programor?

```
if(a < b)
      min = a;
else
      min = b;
 cout << min << endl;
```

Detyra të zgjidhura

Detyra 2.2.1

Të kontrollohet se numri natyror i futur a është numër çift se tek.

```
1   // Të kontrollohet numri i futur a është
2   // çift ose tek.
3    #include <iostream>
4    using namespace std;
5
6   int main() {
7        int numër;
8        cout << "Futni numër natyror:"      ;
9        cin >>numër;
10       if(numër % 2 == 0 )
11           cout << "Numri i futur"      << numër<< "është çift ." << endl;
12       else
13           cout << "Numri i futur"      << numër<< "është tek."     << endl;
14
15       cout << endl;
16       system( "Color 17" );
17       system( "pause" );
18       return 0;
19   }
```

Figura 2.2.11

```
Futni numër natyror: 123
Numri i futu 123 është tek.
Press any key to continue . . .
```

Detyra 2.2.2

Të kontrollohet numri i futur a është pozitiv, negative ose zero.

```
1   // Të provhet vall numri i future është
2   //  pozitiv, negative ose zero
3    #include <iostream>
4    using namespace std;
5
6   int main() {
7       float numri;
8       cout << " Futni numër  ";
9       cin >> numri;
10      cout << "  Numri i futu  " << numri << "është;";
11      if (numri< 0) {
12          cout << " negative ." << endl;
13      }
14      if (numri> 0) {
15          cout << "pozitiv ."   << endl;
16      }
```

Figura 2.2.12

```
17      if(numri == 0) {
18          cout << "zero ." << endl;
19      }
20
21      cout << endl;
22      system("Color 17");
23      system("pause");
24      return 0;
25  }
```

Figura 2.2.12 (vazhdim)

Një dalje prej realizimit të programit është:

```
Numri i futur      -12.345
Numri i future      -12.345 është: negativ
Press any key to continue . . .
```

Detyra 2.2.3

Të kontrollohet vall numri i future është në vargun e llojit përkatës të numrave.

Vërejtje: Te nëntitulli **Leximi dhe shtypja e të dhënave numerike** prej nënpikës **1.8 Leximi dhe shtypja e të dhënave**, sqaruam sesi ndodh mbushja (ang. overflow). Për të mos ardhur deri tejmbushja, pasi mund të fitohen rezultate të gabuara, shpesh është e nevojshme kontrolli i ndonjë të dhënë a është ai në vargune vlerave të llojit prej të cilit është ndryshorja e deklaruar.

Te shembulli vijues është ilustruar mbushja e numrave të plotë.

```
1   //Mbushja e numrave të plotë
2   #include <iostream>
3
4   using namespace std;
5
6   int main() {
7
8       int numërIPlotë;
9       double të3;
10      cout << "Vargu i llojit është       [" << INT_MIN
11          << ", " << INT_MAX << "]" << endl;
12      cout << "Futni numër të plotëmë të madh se 1290: ";
13      cin >> numërIPlotë;
14      na3 = 1.0 *numërIPlotë*numërIPlotë * numërIPlotë;
15      cout << "Numri i plotë " << numërIPlotë << "në kub është";
16      if( ( INT_MIN <= të3 ) && ( të3 <= INT_MAX ) )
17          cout << int( të3 ) << endl;
18      else {
```

Figura 2.2.13

```
19          cout << " Erdh deri në mbushje     ." << endl;
20          cout << "   Pasi     " << numërIPlotë << "në kub nuk është "
21              << numërIPlotë*numërIPlotë* numërIPlotë   << endl;
22      }
23
24      cout << endl;
25      system( "Color 17" );
26      system( "pause" );
27      return 0;
28  }
```

Figura 2.2.13 (vazhdim)

Një dalje prej realizimit të programit është:

```
Vargu i llojit int është:       [-2147483648, 21474836471
Futni numer te plote me të madh prej 1290:  1291
Numri i plotë    1291 në kub është:Erdh deri në mbushje .
Pasi 1291 në kub nuk është-2143282125

Press any key to continue . . .
```

Detyra për ushtrime

Të shkruhen programe për këto detyra:

1. Të njehsohet katrori dhe kubi i numrit natyror n.
2. Të njehsohet perimetri i vijës rrethore dhe syprina e rrethit me rreze r.
3. Të lexohet numri natyror teshifror dhe të shtypet shifra e mesme.
4. Të lexohen tre numra dhe të konstatohet a mund të jenë brinjë të trekëndëshit.
5. Të renditen tre numra sipas madhësisë.
6. Të zgjidhet barazimi linear: $ax + b = 0$, për $a \neq 0$.
7. Të zgjidhet pabarazimi linear: $ax + b > 0$, për $a \neq 0$.
8. Të lexohet këndi më i vogël se 180^0 dhe të shtypet a është i ngushtë ose gjerë.
9. Të kontrollohet data e futur a është e drejtë. (Data të futet sit re numra të plotë për ditën, muajin dhe vitin).
10. Të njehsohet mosha e njeriut si ndryshim të datës sotshme të lindjes. Datat të futen i numra të plotë për ditën, muaji dhe vitin.

Folezimi i urdhërave kontrolluese if dhe if-else

Urdhërat kontrolluese if dhe if-else mund të folezohen (angl. nested) qoftë në zgjedhjen if qoftë në zgjedhjen else.

Kur folezimi është në zgjedhjen else, urdhri i këtillë quhet if-else-if.

Ta shqyrtojmë këtë shembull.

Shembulli 2.2.7

Tre numra të plotë a, b dhe c a mund të jenë brinjët e trekëndëshit kënddrejtë?

Zgjidhje: Numrat a, b dhe c mund të jenë brinjët e trekëndëshit kënddrejtë nëse $a^2 + b^2 = c^2$ ose nëse $a^2 + c^2 = b^2$ ose nëse $b^2 + c^2 = a^2$.

Këtë fjali mundemi ta shprehim me këtë segment programor:

```
if(a * a + b * b == c * c)
       cout << "Po";
else   if(a * a + c * c == b * b)
       cout << "Po";
else   if (b * b + c * c == a * a)
       cout << "Po";
else
       cout << "Jo";
```

Folezimi mund të jetë edhe në zgjedhjen e if.

Ta shqyrtojmë këtë shembull.

Shembulli 2.2.8

Të gjendet nuri më i madh prej numrave të dhënë a, b dhe c.

Zgjidhje:

Nëse a > b dhe a > c, atëherë numri më i madh është numri a.

Nëse b > a dhe b > c, atëherë numri më i madh është numri b.

Nëse c > a dhe c > b, atëherë numri më i madh është numri c.

Sementi programor do të jetë:

```
if(a > b)
       if(a > c)
              cout << "Numri më i madh është  " << a;
if(b > a)
       if(b > c)
              cout << "Numri më i madh është  " << b;
if(c > a)
       if(c > b)
              cout << "Numri më i madh është  " << c;
```

Vërejtje: Nuk është e lejuar folezim i urdhrit programor për zgjidhje të jetë edhe te zgjedhja **if** edhe te zgjedhja **else**.

Gjatë folezmit të urdhërave kontrollues për zgjedhje if, if-else dhe if-else-if, duhet pasur kujdes se përkthyesi në C++ çdo else elidh me parprakun if. Për shembull, te segmenti programor vijues,për a < b, nuk ka asgjë të shtypet pasi else është lidhur me të dytën if, por jo me të parën.

```
if(a > b)
	if(a > c)
		cout << "Numri më i madh është  " << a;
	else
		cout << "Numri më i madh është  " << a;
```

Nëse dum për a < b të realizohet urdhri

```
cout << "Numri më i madh nuk është  " << a;
```

atëherë duhet else të lidhet të parën if me kllapa.

```
if(a > b) {
	if(a > c)
		cout << "Numri më i madh është  " << a;
}
else
	cout << "Numri më i madh nuk është  " << a;
```

Kjo quhet **problem i varur else** (angl. dangling-else problem).

Ushtrime

Për **Shembullin 2.2.7** dhe **Shembulli 2.2.8** të shkruhen programe të veçanta në C++.

Detyra të zgjidhura

Detyra 2.2.4

Të shtypet suksesi i përgjithshëm i nxënësit nëse është mesatarja e notave prej lëndëve, dh atë:

Mesatarja	Suksesi i përgjithshëm
1 deri 1.5	Pamjaftueshëm
1.6 deri 2.5	Mjaftueshëm
2.6 deri 3.5	Mirë
3.6 deri 4.5	Shumë mirë
4.6 deri 5.0	Shkëlqyeshëm

Prormi në C++ do te jetë sikurse te ***figura 2.2.14.***

```
1   //Të shtypet suksesi i përgjithshëm të nxënësit nëse dihe nota mesatare.
2   #include <iostream>
3   using namespace std;
4
5   int main() {
6       float mesatare;
7       cout << "Futni notën mesatare  : ";
8       cin >>  mesatare;
9       cout << "Suksesi i prgjithshëm për notën mesatare " << mesatare << " e ";
10      if ( mesatare  <= 1.5)
11          cout << "Pamjaftueshëm << endl;
12      else    if ( mesatare  <= 2.5)
13          cout << " Mjaftueshëm " << endl;
14      else    if ( mesatare <= 3.5)
15          cout << " Mirë " << endl;
16      else    if ( mesatare <= 4.5)
17          cout << "Shumë mire" << endl;
18      else
19          cout << " Shkëlqyeshëm " << endl;
20
21      cout << endl;
22      system("Color 17");
23      system("pause");
24      return 0;
25  }
```

Figura 2.2.14

```
Futni ntë mesatare 3.56
Suksesi i përgjithshëm për notën mesatare 3.56 është Shumë
Mirë
Press any key to continue . . .
```

Të kujtohemi se kur ka vetëm një urdhër në if ose në else, atëherë mudet, por jo patjetër, të vendohen në kllapa të mëdha.

Detyra 2.2.5
Të caktohet numri më i madh prej tre numrave të dhënë.

Proami në C++ është dhënë te ***figura 2.2.15.***

```
1   //Të caktohet numri më i madh prej tre numrave
2
3   #include <iostream>
4   using namespace std;
5
6   int main() {
7       double a, b, c;
8       cout << "  Futni tre numra:   \n";
9       cout << "a="; cin >> a;
```

Figura 2.2.15

```
10      cout << "b="; cin >> b;
11      cout << "c="; cin >> c;
12      cout << "Më i madh prej tre numrave është ";
13      if (a > b) {
14          if (a > c)
15              cout << a << endl;
16          else
17              cout << c << endl;
18      }
19      else {
20          if (b > c)
21              cout << b << endl;
22          else
23              cout << c << endl;
24      }
25
26      cout << endl;
27      system("Color 17");
28      system("pause");
29      return 0;
30  }
```

Figura 2.2.15 (vazhdim)



Operator i kushtëzuar?:

Operatori i kushtëzuar shfrytëzohet për paraqitjen e urdhërave të zakonshme if-else. Sintaksa e tij është:

kushti? shprehja S : shprehja J ;

Së pari njehsohet *kushti* vlera e të cilit mund të jetë true ose false. Nëse është true, atëherë njehson shprehje S, por nëse është false njehsohet shprehja J.

Për shembull, segmenti programor:

```
if(m > n)
        max = m;
else
        max = n;
```

mund të shkruhe shkurt

```
max = (m > n) ? m : n;
```

Me këtë urdhër do të shtypet „çift.“ nëse ndryshorja numër ka vlerë çift, në të kundërtën do të shtypet „tek“ nëse ndryshorja numër ka vlerë tek:

```
cout << "Numri  " << numri  << "është  "
              << ((numri  % 2 == 0) ? "çift" : "tek") << endl;
```

Për shembull, për numrin = 23 do të shtypet:

```
Numri 23 është numër tek
```

Detyra për ushtrime

Të shkruhen programe për folezim për zgjidhjen e këtyre detyrave me folezim te urdhërat kontrollues për zgjedhje:

1. Të futen dy numra dhe operatori për operacionin aritmetik (+, –, * ose /) dhe të kryhet operacioni.
2. Të cktohet ekuivalenti arab të shifrës romake. (Shifrat romak janë: I = 1, V = 5, X = 10, L = 50, C = 100, D = 500 dhe M = 1 000).
3. Të caktohet nota për nxënësin sipas pikëvetë fituara nëse vlerësi kryhet sipas kësaj shkalle të pikëve: më pak se 60 – pamjaftueshëm, prej 60 deri 69 – mjaftueshëm, prej 70 deri 79 – mirë, prej 80 deri 89 – shumë mire dhe më shumë prej 90 – shkëlqyeshëm.
4. Të caktohet nxënësi që ka marrë notë kaluese nëse kushti për të kaluar është të fitojë 60 pikë prej gjithsej 100, me shfrytëzimin e operatorit të kushtëzuar?:.
5. Të caktoet se vija rrethore $O(x_1, y_1, r_1)$ dhe $O(x_2, y_2, r_2)$ a priten, me shfrytëzimin e operatorit të kushtëzuar?:. (Largësia ndërmjet dy pikave njësohet sipas formulës $d = \sqrt{(x_2 - x_1)^2 + (y_2 - y_1)^2}$).

Struktura kontrolluese algoritmike për zgjedhje prej më shumë mundësive RAST dhe urdhri kontrollues për zgjedhje prej më shumë mundësive switch

Kur ka më shumë mundësi për vazhdimin e veprimit te algoritmi, shfrytëzohet **struktura kontrolluese algoritmike për zgjedhje prej më shumë mundësive**, ***figura 2.2.16***. Zgjedha e njërës prej mundësive kryhet, varësisht prej vlerës të ndonë të dhëne ose të ndonjë *shprehje* aritmetike.

Vlera e *shprehjes* mund të jetë a, b... k ose mund *shprehja* të os fiton asnjë prej atyre vlerave. Në rasti shprehja të fitojë vlerë a, veprimi vazhdon me hapin A, në rastin kur vlera e *shprehjes* të jetë b, veprimi vazhdon me hapin B etj. Në rastin *shprehja* të mos fiton asnjë

```
rast shprehja
    a: hapi A;
       ndërprerje;
    b: hapi B;
       ndërprerje;
    . . .
    k: hapi K;
       ndërprerje;
    ndryshe
       hapi X;
fund_rast {shprehje}
```

Figura 2.2.16

prej vlerave a, b... k, atëherë veprimi vazhdon me hapin X.

Prej asaj që u tha deri më tani, vërehet se kjo strukture kontrolluese algoritmike kryhet zgjedhje të një ose më shumë rasteve të mundshme të vazhdimit të veprimet. Prandaj, ai quhet **zgjedhje në rast** ose., më shkurt, vetëm **rast** (angl. case).

Pas hapave a, b... k, është përmendur struktura kontrolluese algoritmike **ndërprerje**, me tëcilën ndërpritet realizimi i hapave tjerë te struktura kontrolluese rast dhe veprimi vazhdon me hapin ose struktura kontrolluese sipas **rast**. (Për strukturën kontrolluese algoritmike ndërprerje do të flasim te nënpika **2.4 Struktura kontrolluese algoritmike për kërcim dhe urdhëra kontrolluese për kërkim**).

Kjo strukture kontrolluese grafikisht është paraqitur te ***figura 2.2.17***.

Kur është e nevojshme të kryhet hap i njëjtë për më shumë vlera të *shprehjes*, atëherë struktura **rasti** shkruhet si te ***figura 2.2.18***.

```
rast shprehje
    a, c, d:  hapi A;
              ndërprerje;
    b, g:     hapi B;
              ndërprerje;
    . . .
    k, i, f, j: hapi K;
              ndërprerje;
    ndryshe
              hapi X;
fund_rast {shprehje }
```

Figura 2.2.18



Figura 2.2.17

Me urdhrin kontrollues **switch** realizohet struktura kontrolluese algoritmike për zgjedhje prej më shumë mundësive **rast**, por sintaksa e saj është dhënë te f***igura 2.2.19.***

Shprehja në kllapa (shprehja) mund të jetë çfarëdo shprehje vlerat e të cilës janë lloj numra të plotë (short, int, long, long long), lloj me shenja (char), lloj logjik (bool) ose lloj të numërueshëm (enum). Shenjat a, b... k janë konstante prej numrave të plotë, me shenja, lloje logjike ose të numërueshme. Ato nuk mund të jenë ndryshore.

```
switch(shprehje) {
          case a: urdhri A;
                  break;
          case b: urdhri B;
                  break;
          ...
          case K: urdhri K;
                  break;
          default:

                  urdhri X;
 }
```

Figura 2.2.19

Për çdo rast (case), realizohen tëgjitha urdhërat deri te urdhri kontrollues i arë break, veprimi i të cilit është kërcim (dalje) në fund të urdhrit kontrollues switch. Prandaj, patjetër të shfrytëzohet urdhri kontrollues break pas çdo case. Nëse nuk përmendet urdhri kontrollues break, realizimi vazhdon me këtë case2. Pas urdhrit X, nuk vendohet break.

Nëse *shprehja* nuk fiton asnjë vlerë prej konstantave të përmendura pas fjalës case, atëherë realizohet urdhri X pas fjalës default. Departamenti default është opcopnal, jo patjetër të përmendet. Nëse nuk ekziston, pas realizimit të çfarëdo qoftë case, klrcen në urdhrin vijues sipas urdhrit kontrollues switch.

Shembuj

Shembulli 2.2.9

Segmenti programor për vërtetim a jeni të ri (e re) ose jeni i rritur (e rritur) është:

```
bool Po Jo;
char PJ;
cout << "A jeni të lindur në shekullin 21? (P, J: "; cin >> PJ;
Po Jo = true;
if(PJ == 'J')
       Po Jo = false;
switch(Po Jo) {
       case true:    cout << "Ju jeni i ri (e re)." << endl;
              break;
       case false:   cout << "Ju jeni i rritur (e rritur)." << endl;
}
```

Shembulli 2.2.10

Të futet shenja për operacionin aritmetik: +, –, * ose / dhe të shtypet rezultati.

```
switch(shenja) {
case '+': cout << shenja << "plus " << endl;
       break;
case '-': cout << shenja << "minus " << endl;
       break;
case '*': cout << shenja << "nga  " << endl;
```

[2] Ky është gabim i shpeshtë, prandaj duhet të keni kujdes të vendohet break në fund të çdo case.

```
        break;
case '/': cout << shenja  << " mbi  " << endl;
        break;
default:
       cout << shenja  << " nuk është shenjë për operacion aritmetik." << endl;
}
```

Grupi i njëjtë i urdhërave mund të realizohet për raste të ndryshme (cases) deri te urdhri i parë break.

Shembulli 2.2.11

Të futet shkronja dhe të shtypet a është zanore ose është bashkëtingëllore.

```
switch(shkronjë) {
case 'a':
case 'e':
case 'i':
case 'o':
case 'u':
        cout << "Shkronja  " << shkronja  << " është zanore." << endl;
        break;
default:
        cout << "Shkronja  " << shkronja  << " është bashkëtingëllore." << endl;
}
```

Shembulli 2.2.12

Nëse ndonjë muaj i vitit është dhënë me numrin e tij rendor, atëherë me urdhrin kontrollues switch, mund të caktohet sa ditë ka ai muaj.

Vërejtje: Në vitin e brishtë muaj shkurt ka 29 ditë. Viti i brishtë është ai vit i cili plotpjesëtohet me 4 dhe nuk plotpjesëtohet me 100 ose e cila plotpjesëtohet me 400.

```
switch(muaj){
        case 1: case 3: case 5: case 7: case 8: case 10: case 12:
                ditë  = 31;
                break;
        case 4: case 6: case 9: case 11:
                ditë  = 30;
                break;
        case 2:
                ditë  = (((viti  % 4 == 0) && (viti  % 100 != 0)) ||
                (viti  % 400 == 0)) ? 29 : 28;
}
        cout << muaj  << "-muaj në  " << viti  << " viti ka  "
        << ditë  << " ditë ." << endl;
```

Shembulli 2.2.13

Segmenti programor për detyrën paraprake kur muajt prej llojit të numërueshëm do të jetë:

```
enum muaj  {JANAR, SHKURT, MARS, PRILL, MAJ, QERSHOR,
              KORRIK, GUSHT, SHTATOR, TETOR, NËNTOR, DHJETOR
}
muaj  muajEnum = SHKURT;
switch(muajEnum) {
       case JANAR: case MARS: case MAJ: case QERSHOR: case GUSHT:
       case TETOR : case DHJETOR :
              ditë  = 31;
              break;
       case PRILL: case QERSHORI: case SHTATOR: case NËNTOR:
              ditë  = 30;
              break;
       case SHKURT:
              ditë = (((viti  % 4 == 0) && (viti  % 100 != 0)) ||
              (viti  % 400 == 0)) ? 29 : 28;
}
       cout << muajEnum  << "-muaj në " << viti  << "viti ka  "
       << ditë  << " ditë ." << endl;
```

Shkruani 5 shembujt paraprak në një program dhe realizoni.

Detyra të zgjidhura

Detyra 2.2.6

Të shkruhet program me të cilën do të shtypet suksesi i përgjithshëm i nxënësit kur është dhënë numri i suksesit 5, 4, 3, 2 ose 1.

Programi është dhënë te ***figura 2.2.20.***

```
1   // Suksesi i përgjithshëm i nxënësit
2   #include <iostream>
3   using namespace std;
4
5   int main() {
6       int nota;
7       cout << "Futni nota  (1,2,3,4,5): ";
8       cin >> nota;
9       cout << "Suksesi i përgjithshëm i nxënësit";
10      switch( nota; ) {
11          case 5:     cout <<"Shkëlqyeshëm" << endl;
12              break;
13          case 4:     cout << "Shumë mirë"  << endl;
14              break;
```

Figura 2.2.20

```
15          case 3:     cout << "Mire"  << endl;
16              break;
17          case 2:     cout <<"Mjaftueshëm" << endl;
18              break;
19          case 1:     cout << "Pamjaftueshëm" << endl;
20              break;
21          default:    cout << "Kjo nuk është notë"  << endl;
22      }
23
24      cout << endl;
25      system( "Color 17" );
26      system( "pause" );
27      return 0;
28  }
```

Figura 2.2.20 (vazhdim)

Një dalje gjatë realizimit të programit është:

```
Futni nota       (1,2,3,4,5): 5
Suksesi i përgjithshëm i nxënësit është:
Shkëlqyeshëm
Press any key to continue . . .
```

Detyra 2.2.7

Të shkruhet program me të cilin për shifrën e future ndërmjet 1 dhe 9 do të shtypen a është çift ose tek. Nëse shifra nuk është ndërmjet 1 dhe 9 të shkruhet komenti.

```
1   // Shifrat çift dhe tek
2   #include <iostream>
3   using namespace std;
4
5   int main() {
6       short shifra;
7       cout <<"Futni shifër prej 1 deri 9 " ;
8       cin >> shifra;
9       switch( shifra; ) {
10          case 1: case 3: case 5: case 7: case 9:
11              cout <<"Është future shifra tek" << cifra << endl;
12              break;
13          case 2: case 4: case 6: case 8:
14              cout << "Është future shifra çift "  << cifra << endl;
15              break;
16          default: cout <<"Shenja e future nuk është shifër:" << cifra << endl;
17      }
18
19      cout << endl;
20      system( "Color 17" );
21      system( "pause" );
22      return 0;
23  }
```

Figura 2.2.21

NJë dalje prej realizimit të programit është:

```
Futni shifër prej 1 do 9: 5
Është future shifra tek 5
Press any key to continue . . .
```

Detyra për ushtrime

Për këto detyra të shkruhen programe me shfrytëzimin e urdhrit kontrollues për zgjedhje prej më shumë mundësive switch:

1. Të futet numri natyror më i vogël se 10 dhe të shtypet a është i thjeshtë[3], i plotpjesëtueshëm me 2, i plotpjesëtueshëm me 3 ose i përsosur[4].
2. Të shtypet kjo meny:

```
a. Profesor nga gjuha maqedonishte
b. Profesor nga informatika
c. Profesor nga matematika
d. Profesor nga fizika

Zgjidhni:    a
```

Pastaj, varësisht prej shkronjave të futura (a, b, c, d), të shzypet emri i profesorit të lëndës.

1. Të futet shifra 1, 2, 3... 9, 0 dhe të shtypet shifra me fjalë. Për shembull: për 1 të shtypet fjala „një“, për të shtypet fjala „dy“ etj.
2. Të caktohet ekuivalenti arab me shifrën romake (Shifra romak janë: : I = 1, V = 5, X = 10, L = 50, C = 100, D = 500 dhe M = 1 000).
3. Të caktohet nota për nxënësin sipas pikëve të fituara nëse vlerësimi kryhet sipas kësaj shkalle të pikëve 60 – pamjaftueshëm, prej 60 deri 69 – mjaftueshëm, prej 70 deri 79 – mirë, prej 80 deri 89 – shumë mirë dhe prej 90 deri 99 – shkëlqyeshëm.

Pyetje për kontroll të njohurive

1. Kur (më së shpeshti) shfrytëzohet struktura kontrolluese algoritmike rendore?
2. Cilat struktura kontrolluese algoritmike për zgjedhje i dini? Shkruani formën tekstuale të tyre.
3. Me cilin urdhër kontrollues algoritmik në C++ realizohet struktura kontrolluese algoritmike për zgjedhje prej dy mundësive **nëse–atëherë–ndryshe**? Përmend disa shembuj.

[3] Numër i thjeshtë është ai numër që është i plotpjesëtueshëm vetëm me numrin 1 dhe me vetveten. Numra të thjeshtë janë: 2, 3, 5, 7, 11 etj.

[4] Numër i përsosur është a ii cili është i barabartë me shumën e pjesëtuesve të vet, pa vet numrin. Numrat e përsosur janë: 6 (= 1 + 2 + 3), 28 (= 1 + 2 + 4 + 7 + 14), 496 etj.

4. Paraqitni grafikisht strukturën kontrolluese algoritmike nëse–atëherë–ndryshe.
5. Si është lloj i shprehjes që shfrytëzohet si kusht te struktura kontrolluese algoritmike për zgjedhje dhe urdhërat kontrolluese për zgjedhje?
6. Si shkruhet urdhri kontrollues për zgjedhje prej dy mundësive, kur sipas if dhe/ose sipas else ka më shumë se një urdhër? Përmend shembuj.
7. Shkruani sintaksën e urdhrit kontrollues për zgjedhje prej dy mundësive nëse nga një mundësi nk ks urdhëra. Përmend shembuj.
8. Cilat mënyra të folezimit te urdhërat kontrolluese për zgjedhje i dini?
9. Si quhet urdhri kontrollues për zgjedhje te e cila ka folezim te zgjedhja else?
10. Sqaro çka është varëse else. Përmend shembuj.
11. Shkruaj sintaksën e operatorit të kushtëzuar. Përmend shembuj.
12. Paraqitni tekstualisht dhe grafikisht strukturën kontrolluese algoritmike për zgjedhje prej më shumë mundësive.
13. Si mund të jetë lloj i shprehjes te urdhri kontrollues për zgjedhje prej më shumë mundësive?
14. Cili urdhër kontrollues vendohet në fund të çdo case te urdhri kontrollues switch?
15. Çka do të ndodh nëse në fund të çdo case nuk ka urdhër break?

Detyra

1. Çka do të shtypet pas realizimit të këtij segmenti programor nëse vlera e ndryshores n është 78?

```
if((n % 2 == 0) && (n % 3 == 0))
   cout << n << " plotpjesëtohet me 6." << endl;
else
   cout << n << " nuk plotpjesëtohet me  6." << endl;
```

2. Cili është gabimi te ky sistem programor:

```
if(x = a)
   cout << "x ka vlerë të njëjtë me a.";
else
   cout << "x ka vlerë të ndryshme me a.";
```

3. Pse ky segment programor gjithmonë shtyp „false“, pavarësisht prej vlerës së n?

```
cin >> n;
if(n = 0)
          cout << "true" << endl;
   else
          cout << "false" << endl;
```

4. Çka do të shtypet me këtë segment programor?

```
int i = 0, n;
float a = 1;
char c = 'a';
a++;
if(c == a && i == 0)
   n = 1;
else
   n = 2;
cout << "n = " << n << endl;
```

5. Këto segmente programore a japin rezultat të njëjtë?

```
if(a > b)
   cout << a << " > " << b << endl;
else if(b < c)
   cout << a << " <= " << b << "<" << c << endl;
else
   cout << a << " <= " << b << ">=" << c << endl;
```

```
if(a > b)
   cout << a << " > " << b << endl;
if(b < c)
   cout << a << " <= " << b << " < " << c << endl;
else
   cout << a << " <= " << b << " >= " << c << endl;
```

6. Të shkruhet segmenti programor për shprehjen logjike prej dy ndryshoreve:
   - shprehja është e saktë nëse ose ndr1 ose ndr2 është e saktë.
   - shprehja është e pasaktë nëse ose ndr1 ose ndr2 është e saktë.
   - shprehja është e pasaktë nëse edhe ndr1 edhe ndr2 është e pasaktë.
7. Të futen tre numra të plotë dhe të shtypet numri më i madh: njëherë nëse është më i madh prej dy të tjerëve, dy herë nëse të dy më të mëdhenj prej të tretit kanë vlerë të njëjtë, treherë nëse të tre numrat janë të barabartë.
8. Të plotësohet **Detyra 2.2.4** me kontrollin se nota mesatare e futur a është në intervalin [0.0, 5.0].
9. Të plotësohet **Detyra 2.2.6** me kontrollin se nota mesatare e future a është në intervalin [1, 5].
10. Të shkruhet program për shtypje të kësaj dalje, varësisht prej ndryshoreve.
11. Të kontrollohet se tre numra të ndryshëm a mund të jenë brinjë të trekëndëshit?
12. Shkruani programin që do të simulon kalkulator të zakonshëm me kto operacione: +, –, *, %, /, x^2.

2.3 Struktura kontrolluese algoritmike për përsëritje dhe urdhëra kontrollues për përsëritje

Struktura kontrolluese algoritmike për përsëritje shfrytëzohet atëherë kur është e nevojshme një grup hapa algoritmike të kryejë shumë here. Një realizim i hapave quhet një cikël, ***figura 2.3.1***. Prandaj, përsëritja e këtillë e realizimit të grupit të hapave algoritmike quhet **përsëritje ciklike**.

Për më lehtë të kuptohen këto struktura kontrolluese, do ta shqyrtojmë këtë detyrë.

```
cikli
        hapi A;
        hapi B;
        ...
        hapi M;
fundi_cikli
```

Figura 2.3.1

Detyra: Të caktohet shuma e 10 numrave të parë natyror.

Të mendojmë se kemi ndonjë enë dhe në atë i vendojmë numrat. Në fillim ena është e zbrazët, d.m.th., shuma është 0. Numri i parë natyror të cilin e vendojmë te ena është 1, domethënë tani shuma është 0 + 1 = 1. Pastah, te ena e vendosim numrin natyror vijues 2, domethënë në enë do të kemi dy numra (1 dhe 2), por shumë do të jetë 0 + 1 + 2. Pastaj, i vendosim numrat 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9 dhe 10, por shuma do të zmadhohet me shtuarjen e çdo numri. Shuma e fundit do të jetë 0 + 1 + 2 + 3 + 4 + 5 + 6 + 7 + 8 + 9 + 10.

Mund të vërejmë se te mënyra për gjetjen e shumës realizohen vetëm dy veprime:

- Shtuarja e numri shumës.
- Zmadhimi i numrit për 1.

Pasi numri ndryshon prej 1 deri 10, por shuma është 0, 1, 3, 6, 10 etj., mundemi të futim dy numra të ndryshueshëm numri dhe shuma. Në fillim, përmbajtja e ndryshores shumë është 0, por vlera fillestare e numrit është 1. Prandaj, ndryshoret numri dhe shuma i inicializojmë vlert 1 dhe 0. Algoritmi mund të shkruhet tekstualisht si te ***figura 2.3.2.***

```
shuma ← 0;
numri ← 1;
cikli 10 herë
        – shtoje numrin shumës;
        – zmadhoje numrin për 1;
fund_cikli
```

Figura 2.3.2

Varësisht prej mënyrës së ndërprerjes së përsëritjes, dallojmë tri struktura kontrolluese për përsëritje, edhe atë:

- Struktura kontrolluese me numërim të cikleve.
- Struktura kontrolluese me dalje në fillim të ciklit.
- Struktura kontrolluese me dalje në fund prej ciklit

Strukturat kontrolluese algoritmike për përsëritje me numërim të cikleve dhe urdhërt kontrolluese for

Në këtë strukture kontrolluese, numri i përsëritjeve të ciklit është prej përpr i njohur. Përsëritjet, d.m.th., ciklet numërohen me numërues të veçantë, për të cilët janë dhënë vlera fillestare dhe e fundit, ***figura 2.3.3.***

Ciklet realizohen **për** çdo vlerë të ndryshores numërues prej fillestares, me **zmadhimin** nga 1, **deri** te fundi. Ndryshorja numërues zmadhohet për 1 para çdo cikli. Prandaj, struktura kontrolluese e këtillë quhet **për–zmadho–deri.**

```
për numërues ← fillestare zmadho deri   fundi
        hapi  A;
        hapi  B;
        ...
        hapi  K;
fund_për  {numërues}
```

Figura 2.3.3

Ndryshoret numërues, fillestare dhe e fundit patjetër të jenë ndryshore të llojit të njëjtë. Ndryshorja vlera fillestare ka vlerë më të vogël ose të barabartë prej ndryshores së fundit. Në të kundërtën, nuk realizohet asnjë cikël. Vlera e numëruesit nuk guxon të ndryshojë te hapat algoritmike prej të cilëve përbëhet cikli.

Nëse është e nevojshme përsëritja te e cila vlera fillestare (fillestare) duhet të jetë më e madhe prej të fundit (e fundit), atëherë shfrytëzohet strukture kontrolluese e ngjashme. Te ajo, cikli realikzohet **për** çdo vlerë të ndryshores numërues prej fillestares, e **zvogëlim** sipas 1, **deri** e fundit. Ndryshorja numërues zvogëlohet për 1 pra çdo cikli. Prandaj struktura kontrolluese e këtillë quhet **për–zvogëlo–deri,** ***figura 2.3.4*****.**

```
për numërues ← fillestare zvogëlo  deri fundit
        hapi  A;
        hapi  B;
        ...
        hapi  J;
fund_për  {numërues}
```

Figura 2.3.4

Te algoritmet (detyrat) ku numëruesi nuk zmadhohet ose zvogëlohet sipas 1, por sipas ndonjë sasie të hapave, struktura kontrolluese **quhet për–deri–hapi,** ***figura 2.3.5.***

Te kjo strukture kontrolluese, **për** ndonjë vlerë fillestare të numëruesit, **deri** ndonjë vlerë të fundit, ai zmadhohet në çdo cikël me **hapi** për sasi të caktuar. Prandaj, kjo strukture kontrolluese për përsëritje quhet **për–deri–hapi**.

```
për numërues ← fillestare deri fundit hapi sasia
        hapi  A;
        hapi  B;
        ...
        hapi  M;
fund_për  {numërues}
```

Figura 2.3.5

Nëse sasia (sasia) e hapit te struktura kontrolluese **për–deri–hapi** është +1, fitohet struktura kontrolluese **për–zmadho–deri**, por nëse sasia e hapit është –1, fitohet struktura kontrolluese **për–zvogëlo–deri**.

Paraqitja grafike e strukturës kontrolluese **për–deri–hapi** është dhënë te ***figura 2.3.6.***

Algoritmi për detyrën për gjetjen e shumës së 10 numrave të parë natyror, e shprehur me strukturën kontrolluese **për–zmadho–deri** është dhënë te ***figura 2.3.7.***

```
algoritëm ShumaDeri10
fillimi
        shuma ← 0;
        numri ← 1;
        për numërues ← 1 zmadho deri 10
                shuma ← shuma + numri;
                numri ← numri + 1;
       fund_për {numërues}
      shtyp shuma;
fund { ShumaDeri 10}
```

Figura 2.3.7

Figura 2.3.6



Për realizimin e tri strukturave kontrolluese: **për–zmadho–deri**, **për–zvogëlo–deri** dhe **për–deri–hap**, në C++ shfrytëzohet urdhri kontrollues for.

Forma e përgjithshme e urdhrit kontrollues for është dhënë te ***figura 2.3.8.***

Kushti është pjesë e shqyrtimit të kushtit para përsëri të realizojë ciklin. Ai është shprehje logjike.

Nëse *kushti* ka vlerë true, atëherë cikli përsëri do të realizojë, por nëse ka vlerë false, atëherë cikli nuk realizohet, por veprimi vazhdon me urdhrin vijues. Pasi kushti mund të mos plotësohet dhe para fillimit të ciklit të parë, mund të mos realizon asnjë cikël.

```
for (inicializimi; kusht; azhurimi){
        urdhër A;
        urdhër B;
          ...
        urdhër R;
}
```

Figura 2.3.8

Pjesa *azhurim* e urdhrit kontrollues for realizohet pas realizimit të çdo cikli, por më së shpeshti te ai azhurohet numëruesi.

Forma e urdhrit kontrollues for për strukturën kontrolluese **për–deri–hap** është dhënë te **figura 2.3.9:**

```
for (numërues = fillestar; numërues <= fundit; numërues = numërues + sasia) {
                    urdhër A;
                    urdhër B;
                    ...
                    urdhër L;
}
```

Figura 2.3.9

Te pjesa për inicializim, ndryshorja numërues inicializohet në vlerën fillestare. Ajo pjesë realizohet vetëm njëherë. Shqyrtimi i kushtit se vlera e numëruesit a është më e vogël prej ose e barabartë me vlerën e fundit (e fundit) (numërues <= fundit), është përmirësuar në vet urdhrin. Kushti (kusht) numërues <= fundit shqyrtohet para fillimit të çdo cikli edhe nëse vlera true, cikli realizohet, por nëse vlera false, cikli nuk realizohet.

Programi për detyrë për gjetjen e 10 numrave të parë natyror, sipas algoritmit prej **figura 2.3.7**, me shfrytëzimin e urdhrit for, është dhënë te **figura 2.3.10.**

```
1   #include <iostream>
2   using namespace std;
3
4   int main() {     // Shuma e 10 numrave të parë natyror me
5
6       int numërues, numër, shuma;
7     shuma = 0;
8     numër = 1;
9     for(numërues = 1;numërues<= 10;numërues =numërues+ 1 ) {
10        shuma = numër + numër;
11        numër =numër+ 1;
12      }
13      cout <<   "Shuma e 10 numrave të parë natyror është"    <<shumë<< endl;
14
15      cout << endl;
16      system( "Color 17" );
17      system( "pause" );
18      return 0;
19  }
```

Figura 2.3.1.0

```
Shuma e 10 numrave të parë natyror është 55
Press any key to continue . . .
```

Shembuj

Shembulli 2.3.1

Të gjendet shuma e 10 numrave të parë natyror, me mbledhje prej 10 deri 1, d.m.th., 10 + 9 + 8 + 7 + 6 + 5 + 4 + 3 + 2 + 1.

Programi është dhënë te **figura 2.3.11**. Vërejmë se program është i njëjtë me atë te **figura 2.3.10**, me atë dallim që ndryshorja numër inicializohet në 10, numërues numërues inicializohet në 10, kushti është ndryshuar në numërues >= 1 edhe në pjesën për azhurim të uerdhërit for, numëruesi zvogëlohet për 1.

```
1   #include <iostream>
2   using namespace std;
3
4   int main() {     // Shuma e 10 numrave të parë natyror me
5
6       int numërues, numër, shuma;
7      shuma = 0;
8      numër = 10;
9       for( numërues  = 10; numërues >= 1; numerues = numërues  - 1 ) {
10                 += numërues;
11     numërues += 1;
12      }
13      cout <<"Shuma e 10 numrave të parë natyror është"     << shuma << endl;
14
15      cout << endl;
16      system( "Color 17" );
17      system( "pause" );
18      return 0;
19  }
```

Figura 2.3.11

Shembulli 2.3.2

Të shtypet tabela për shumëzim deri në 10 me numër të futur.

Programi është dhënë te ***figura 2.3.12***. Te ai është kyçur biblioteka <iomanip> prej të cilës shfrytëzohet funksioni setw(), me të cilën jepet numri i vendeve te të cilat shtypet ndryshorja vijuese dhe funksioni right, me të cilën vlera që shtypet mbështetet në anën e djathtë.

Për shembull, nëse vlera e x është 1 234 me urdhrin:

```
cout << setw(10 << right << x << endl;
```

vlera e x do të shtypet djathtas të mbështetur në fushën prej 10 vendeve:

␣␣␣␣␣␣123.

```
1   #include <iostream>
2   #include <iomanip>
3   using namespace std;
4
5   int main() {     //Tabela e shumëzimit me
6
7       int numërues, numër;
8       cout <<"Tabela e shumëzimit me (1,2,...,9): ";
9       cin >>numër;
10      for(numërues = 1;numërues <= 10; numërues= numërues + 1 ) {
11          cout << "\n" << setw( 3 ) << right <<numërues<< " x " <<numër<< " = "
12              << setw( 3 ) <<numërues * numër;
13      }
14
15      cout << endl;
16      system( "Color 17" );
17      system( "pause" );
18      return 0;
19  }
```

Figura 2.3.12

```
Tabela e shumëzimit me (1,2,...,9): 7

  1 x 7 =   7
  2 x 7 =  14
  3 x 7 =  21
  4 x 7 =  28
  5 x 7 =  35
  6 x 7 =  42
  7 x 7 =  49
  8 x 7 =  56
  9 x 7 =  63
 10 x 7 =  70
Press any key to continue . . .
```

Shembulli 2.3.3

Të shtypen shkronjat prej G deri g pa shenjat ndërmjet shkronjave të mëdha dhe të vogla.

Deklarimi me inicializim të numëruesit shkronja, mund të bëhet edhe në pjesën për inicializim të urdhrit for, sikurse është në programin vijues.

```
1   #include <iostream>
2   using namespace std;
3
4   int main() {     // Shtypja e shkronjave prej G deri g
5
6       for( char shkronja = 'G';shkronja <= 'g';shkronja : shkronja + 1 ) {
7           cout <<shkronja << " ";
8       }
9
```

Figura 2.3.13.

```
10      cout << endl;
11      system( "Color 17" );
12      system( "pause" );
13      return 0;
14  }
```

Figura 2.3.13 (vazhdim)

```
g f e d c b a Z Y X W V U T S R Q P O N M L K J I H G
Press any key to continue . . .
```

Shembulli 2.3.4

Të tabelohet funksioni $f(x) = 3x^2 - 2x + 4$ për x [–30,30] me sasinë e hapit 4, sikurse është treguar te dalja e fituar. Programi është dhënë te figura 2.3.14.

```
1   #include <iostream>
2   #include <iomanip>
3   using namespace std;
4
5   int main() {    // Tabelimi i funksionit me
6
7       double x, y;
8       cout << setw( 7 ) << "x" << setw( 15 ) << "y=3x^2-2x+4" << endl << endl;
9       for( int numërues = -30; numërues <= 30; numërues  += 4 ) {
10          x = numërues;
11          y = 3 * x * x - 2 * x + 4;
12          cout << setw( 10 ) << x << setw( 10 ) << y << endl;
13      }
14
15      cout << endl;
16      system( "Color 17" );
17      system( "pause" );
18      return 0;
19  }
```

Figura 2.3.14

Dalja prej programit është

```
         x     y=3x^2-2x+4

       -30            2764
       -26            2084
       -22            1500
       -18            1012
       -14             620
       -10             324
        -6             124
        -2              20
         2              12
         6             100
        10             284
        14             564
        18             940
        22            1412
        26            1980
        30            2644
```

Operatorët për inkrementim dhe dekrementim ++ , —

Në C++ shfrytëzohen operatorët për zmadhimin ose për zvogëlimin e vlerës së ndonjë ndryshore për 1. Ato quhen **operator për inkrementim** (angl. increment operator)dhe **operator për dekrementim** (angl. decrement operator). Operatori për inkrementim është ++, por për dekrementim është – –. Inkrementimi ose dekrementimi i vlerës së ndryshores x mund të kryhet në formën prefikse (++x ose – –x) ose posfikse (x++ ose x– –). Në rastin e parë, inkrementimi ose dekrementimi realizohet para, por në rastin e dytë sipas njehsimit të shprehjes (postinkrement).

Operatori	Forma	Inkrement	Dekrement
++	++x	prefiks	
	x++	postfiks	
– –	– –x		prefiks
	x– –		postfiks

Shembulli

Vlera e x para njehsimit njehsimit	Shprehja postfiks	Vlera e shprehje	Vlera e x pas njehsimit
5	++x	6	6
5	x++	5	6
5	– –x	4	4
5	x– –	5	4

Inkrementimi dhee dekrementimi mund të shfrytëzohet si urdhër.

Shembuj

Shembulli 2.3.5

Shuma e 10 numrave të parë natyror prej shembujve paraprak mund të njehsohet me këtë segment programor:

```
int numër  = 1;
int shuma  = 0;
for (int numërues = 1; numërues <= 10; numërues ++) {
       shuma  += numër;
       ++ numër      // njëjtë me numër = numër + 1; ose numër += 1;
}
```

Shembulli 2.3.6

Segmenti programor vijues ilustron përdorimin e operatorit për inkrementim:

```
int a, b, c;
a = b = c = 1;
cout << "a = " << a << ", b = " << b << ", c = " << c << endl;
b = ++a;
cout << "b = ++a \na = " << a << ", b = " << b << ", c = " << c << endl;
c = a++;
cout << "c = a++ \na = " << a << ", b = " << b << ", c = " << c << endl;
c = ++ ++b;
cout << "c = ++ ++b \na = " << a << ", b = " << b << ", c = " << c << endl;
```

Dalja e tij është:

```
a = 1, b = 1, c = 1
b = ++a
a = 2, b = 2, c = 1
c = a++
a = 3, b = 2, c = 2
c = ++ ++b
a = 3, b = 4, c = 4

Press any key to continue . . .
```

Operatorët për inkrementim dhe për dekrementim mund të shfrytëzohen vetëm për bashkësi lineare të renditura, sikurse janë shenjat ASCII dhe numrat e plotë. (Bashkësi lineare të renditura janë ato te të cilat çdo element ka paraardhësin e tij (përveç të parit) dhe pasardhsin e vet (përveç të fundit)).

Te shembujt paraprak, në vend të urdhërave

```
numërues = numërues + 1
numërues = numërues - 1;
```

mund të shfrytëzohen urdhërat

```
numërues ++;   ose    ++ numërues;
numërues --;   ose    -- numërues
```

por në vend të urdhërave

```
shkronja = shkronja + 1;
shkronja = shkronja - 1;
```

mund të shfrytëzohen urdhërat

```
shkronja ++;  ose     ++ shkronja;
shkronja --;  ose     -- shkronja;
```

Shfrytëzimi i numëruesit te trupi i urdhrit kontrollues for

Te program për shumën e 10 numrave të parë natyror prej 1 deri 10, mund të vërehet se ndryshorja numër fton vlerë fillestare 1 dhe inkrementohet për 1 në çdo cikël. Gjithashtu, edhe numëruesi (numërues) inicializohet në 1 dhe në çdo cikël inkrementohet për 1. Nëse i shtypim vlerat e tyre në çdo cikël, do të vërejmë se janë të njëjtë.

```
numërues, numër
 1       1
 2       2
 3       3
 4       4
 5       5
 6       6
 7       7
 8       8
 9       9
 10      10
Shuma e 10 numrave të parë natyror është 55
```

Në rastet e këtilla, ndryshorja numërues mund të shfrytëzohet në vend të ndryshores numër. Megjithatë, fillestarët e programimit duhet të jenë shumë të kujdesshëm gjatë shfrytëzimit të numëruesit te trupi i urdhrit kontrollues për përsëritje pasi lehtë bëhen gabime. Edhe, akoma diçka. Numëruesi nuk mund gjithmonë të shfrytëzohet në trupin e urdhërave kontrolluese për përsëritje.

Programi për shumën e 10 numrave të parë natyror, me shfrytëzimi e numëruesit te trupi i urdhrit for, do të jepet si te ***figura 2.3.15*.**

Gjithashtu, te ai është treguar se deklarimi i numëruesit mund të kryhet edhe te pjesa për inicializim.

```
1   #include <iostream>
2   using namespace std;
3
4   int main() {    // Shuma e 10 numrave të parë natyror me
5
6       int shuma  = 0;
7       for( int numërues = 1;numërues= 10; numërues ++ ) {
8         shuma =shuma+ numërues;
9       }
10      cout << "Shuma e 10 numrave të parë natyror është" <<shuma<< endl;
11
```

Figura 2.3.15

```
12      cout << endl;
13      system( "Color 17" );
14      system( "pause" );
15      return 0;
16  }
```

Figura 2.3.15 (vazhdim)

Specifikat e urdhrit kontrollues for

a) Inicializimi dhe azhurimi i më shumë ndryshoreve

Urdhri kontrollues **for** në C++ lejon inicializimin dhe azhurimin e më shumë ndryshoreve. Poashtu atë ndahen me presje.

Shembulli 2.3.7

Të kontrollohet se shuma e nurave prej 1 deri n dhe prej n deri 1 a është i njëjtë?

Te programi ***(figura 2.3.1***6), te pjesa për inicializim edhe te pjesa për azhurim të urdhrit for, inicializohet dhe azhurohen dy ndryshore.

Kushti për ndërprerje të përsëritjeve mund të jetë çfarëdo shprehje logjike ku mund të shfrytëzohen operator të relacionit dhe logjik. Në këtë program kushti është i <= n && j >= 1.

```
1   #include <iostream>
2   using namespace std;
3
4   int main() {
5       //     Se shuma 1+2+...+n a  është e njëjtë me shumën     n+(n-1)+(n-2)+...+2+1?  me (for)
6
7       int n, shuma1deriN   = 0, shumaNderi1  = 0;
8       cout <<Deri te cili numër n=";
9       cin >> n;
10      for( int i = 1, j = n; i <= n && j >= 1; i++, j-- ) {
11       shuma1deriN += i;
12       shumaNderi1 += j;
13      }
14      cout <<   "Shuma e numrave natyrorë prej 1 deri"   << n << " është  " << shuma1deriN << endl;
15      cout <<    "Shuma e numrave natyrorë prej "  << n << "  deri 1 është     " << shumaNderi1  << endl;
16
17      cout << endl;
18      system( "Color 17" );
19      system( "pause" );
20      return 0;
21  }
```

Figura 2.3.16

Një dalje prej realizimit të programit është:

```
Deri te cili numër n=100
Shuma e numrave natyrorë prej 1 deri 100 është 5050
Shuma e numrave natyrorë prej 100 deri 1 është 5050

Press any key to continue . . .
```

b) **Pjesa e inicializimit dhe azhurimit mund të jetë edhe i zbrazët**

Shembulli 2.3.8

Programi prej **Shembulli 2.3.7** mund të shkruhet edhe si te ***figura 2.3.17***. Vërejmë se inicializimi kryhet para fillimit të urdhrit for, por azhurimi kryhet te trupi i urdhrit for.

```
1   #include <iostream>
2   using namespace std;
3
4   int main() {
5       //      Shuma 1+2+...+n a është e njëjtë me shumën n+(n-1)+(n-2)+...+2+1? (me for)
6
7       int i, j, n, shuma1deriN = 0, shumaNderi1 = 0;
8       cout << " Deri te cili numër n=";
9       cin >> n;
10      i = 1; j = n;
11      for( ; i <= n && j >= 1;) {
12       shuma1deriN += i;
13       shumaNderi1 += j;
14          i++;
15          j--;
16      }
17      cout << "  Shuma e numrave natyrorë prej 1 deri  " << n << " është" << shuma1deriN  << endl;
18      cout << "  Shuma e numrave natyrorë prej  " << n << "  deri 1 është  " << shumaNderi1 << endl;
19
20      cout << endl;
21      system( "Color 17" );
22      system( "pause" );
23      return 0;
24  }
```

Figura 2.3.17

```
Deri te cili numër n=99
Shuma e numrave natyrorë prej 1 deri 99 është 4950
Shuma e numrave natyrorë prej 99 deri 1 është 4950

Press any key to continue . . .
```

Ushtrime

Ushtrimi 2.3.1

Çka bën ky segment programor?

```
shuma = 0;
for(int numër = 2, numër <= 10; numër += 2)
	shuma += numër;
```

Ushtrimi 2.3.2

Të konstatohet çka do të shtypet si rezultat i realizimit të segmentit programor vijues:

```
for(int x = 1, i = 0; x <= 10; x++)
	i += x;
cout << x << endl;
```

Ushtrimi 2.3.3

Të konstatohet çka do të shtypet si rezultat i realizimit të segmentit programor vijues:

```
for(int i = 0, j = 0; i < 5; i++, j--)
	cout << i + j << endl;
```

Detyra të zgjidhura

Detyra 2.3.1

Të gjenden të gjitha Numrat e Pitagorës më të vegjël prej numrit natyror n.

Sqarim: Numrat e Pitagorës janë çdo treshe e numrave natyrorë x, y dhe z që e kënaqin barazimin $x^2 + y^2 = z^2$. Për të mos përsëriten treshat, sikurse 3, 4, 5 dhe 4, 3, 5, ndryshorja x do të ndryshojë prej 1 deri te vlera jo më e madhe prej y, d.m.th., deri (nëse x = y) $\left[\sqrt{\frac{n^2}{2}}\right]$. Për të mos përsëriten treshat, sikurse 3, 4, 5 dhe 4, 3, 5, ndryshorja x do të ndryshojë prej 1 deri te vlera jo më e madhe prej y, d.m.th., deri (nëse x = y).

Kllapat e mesme shënojnë pjesën e plotë prej numrit dhjetor. Për shembull, [3.56] = 3.

Vërejtje 1: Te program vijues (figura 2.3.18) shfrytëzohen dy ndryshore ndihmëse nd1 dhe nd2 me të cilat njehsohet vlera e $\left[\sqrt{\frac{n^2}{2}}\right]$ dhe x2 + y2. Pasi vlera $\left[\sqrt{\frac{n^2}{2}}\right]$. Pasi vlera është konstanta, nëse e lejmë te urdhri for, do të njehsohet te çdo cikël, që është e panevojshme. Gjithashtu, shprehja $x^2 + y^2$ njehsohet dy here te çdo cikël, por me futjen e nd2, vetëm njëherë. Në këtë mënyrë, koha për njehsim të shprehjes $x^2 + y^2$ shkurohet dyfish.

Vërejtje 2: Pasi rezltati prej rrënjës katrore të numrit real është numr real, port e cikli na duhet numër i plotë, me (int) sqrt(n * n / 2), kryejmë klonversion të detyrueshëm (të quajtur hedhje) të numri real në numr të plotë.

```
#include <iostream>
#include <iomanip>
using namespace std;

int main() {
    //    Treshet e Pitgorës (me for)

    int n, x, y, z,    nd1, nd, numërues  = 0;
    cout << "Deri te cili numër natyror:";    cin >> n;
    cout << "\nTreshet e Pitagorës " << n << "janë:" << endl;
    nd1 = ( int ) sqrt( n * n / 2 );
    for( x = 1; x <= nd1 ; x++ ) {
        for( y = x + 1; y <= n; y++ ) {
             nd2 = x * x + y * y;
            z = ( int ) sqrt( nd2  );
            if( ( z <= n ) && ( nd2  == z * z ) ) {
                ++numërues;
                cout << setw( 10 ) <<numërues;<< ": " << setw( 2 ) << x << ", "
                    << setw( 2 ) << setw( 2 ) << y << ", " << setw( 2 ) << z << endl;
            }
        }
    }

    cout << endl;
    system( "Color 17" );
    system( "pause" );
    return 0;
}
```

Figura 2.3.18

Një dalje prej programit është:

```
Një dalje prej programit është: 33

Treshet e Pitagorës deri te numri 33janë:
         1:  3,  4,  5
         2:  5, 12, 13
         3:  6,  8, 10
         4:  7, 24, 25
         5:  8, 15, 17
         6:  9, 12, 15
         7: 10, 24, 26
         8: 12, 16, 20
         9: 15, 20, 25
        10: 18, 24, 30
        11: 20, 21, 29

Press any key to continue . . .
```

Detyra 2.3.2
Zë gjenden të gjithë numrat e përsosur më të vegjël se numri natyror n.

Sqarim: Numra natyrorë të cilt janë të barabartë e shumën e pjesëtuesve të tij, pa vet numrin, quhen numea të përsosur. Numrat e përsosur janë: 6, 28, 496 etj.

```
#include <iostream>
#include <iomanip>
using namespace std;

int main() {
    // Numrat e përsosur (me for)

    int n, numër, pjesëtues, shuma;
    cout << " Deri te cili numër  n=":  cin >> n;
    cout << "\nNumrat e përsosur deri   " << n << "jane:" << endl;
    for(numër= 2; numër<= n; numër  ++ ) {
       shuma = 1;
        for(pjesëtues  = 2;pjesëtues <= numër/ 2;pjesëtues++ ) {
            if(numër %pjesëtues == 0 )
               shuma +=pjesëtues;
        }
        if(shuma== numër)
            cout <<numër<< ", ";
    }
    cout << endl;

    cout << endl;
    system( "Color 17" );
    system( "pause" );
    return 0;
}
```

Figura 2.3.19

Rezultati prej realizimit të programit është dhënë te ***figura 2.3.19*** është:

```
Deri te cili numër n =12345

Numra të përsosur deri 12345 janë:
6, 28, 496, 8128,

Press any key to continue . . .
```

Detyra për ushtrime

Për këto detyra të shkruhen programe me shfrytëzimin e urdhrit kontrollues for:

1. Të njehsohet shuma $1 + 4 + 7 + 11 + \ldots + n$.
2. Të njehsohet shuma $1^2 + 2^2 + 3^2 + \ldots + n^2$.
3. Të njehsohet shuma $1 + \frac{1}{2} + \frac{1}{3} + \ldots + \frac{1}{n}$.
4. Të njehsohet mesi aritmetik i numrave natyror prej 1 deri n.
5. Të njehsohet $n! = 1 \cdot 2 \cdot 3 \cdot \ldots \cdot n$. Sipas përkufizimit $0! = 1$ dhe $1! = 1$. (Shënimi n! lexohet „n faktoriel“).
6. Të njehsohet prodhimi: $1 \cdot \frac{1}{2} \cdot \frac{1}{3} \cdot \ldots \cdot \frac{1}{n}$.
7. Të shtypen shkronjat prej alfabetit prej A deri te ZH dhe prej ZH deri te A.
8. Të shtypen shkronjat këto tri forma:

```
*
**
***
****
*****
******
*******
********
*********
```

```
1
2 1
3 2 1
4 3 2 1
5 4 3 2 1
6 5 4 3 2 1
7 6 5 4 3 2 1
8 7 6 5 4 3 2 1
9 8 7 6 5 4 3 2 1
```

```
                1
              1 2
            1 2 3
          1 2 3 4
        1 2 3 4 5
      1 2 3 4 5 6
    1 2 3 4 5 6 7
  1 2 3 4 5 6 7 8
1 2 3 4 5 6 7 8 9
```

9. Të njehsohet shuma:
   $1 + (1 + 2) + (1 + 2 + 3) + (1 + 2 + 3 + 4) + \ldots + (1 + 2 + \ldots + n)$.
10. Të gjendet faktoriel i dyfishtë i numrit jonegativ n.
    $n!! = n(n-2)(n-4) \cdot \ldots \cdot 5 \cdot 3 \cdot 1$ për n tek, ,
    $n!! = n(n-2)(n-4) \cdot \ldots \cdot 6 \cdot 4 \cdot 2$ për n çift.
    Sipas përkufizimit $0!! = 1$ dhe $1!! = 1$.
11. Të futen n numrat dhe të numërohet sa prej tyre janë çift, por sa janë tek.
12. Të gjenden pjesëtuesit e numrit natyror n.

Struktura kontrolluese algoritmike për përsëritje me dalje në fillim të ciklit derisa–realizo dhe urdhri kontrollues while

Te detyra për gjetjen e shumës së 10 numrave të parë natyror prej nëntitullit paraprak, theksuam se përsëriten vetëm dy veprime:

- Shtuarja numër shumës.
- Zmadhimi i numrit për 1.

Ndryshorja numër zmadhohet në çdo cikël deri te vlera 11. Prandaj, mundemi të themi: **derisa** numri ka vlerë më të vogël ose të barabartë me 10, **realizohen** cikle me këto veprime. Struktura kontrolluese algoritmike e këtillë quhet **deri–realizo.**

```
shuma ← 0;
numër ← 1;
 deri numër ≤ 10 realizo
        – shto numër shumës;
        – zmadhonumrin për 1;
– fund_ deri {numër ≤ 10}
```

Figura 2.3.20

Ajo është paraqitur te ***figura 2.3.20.***

```
deri kusht realizo
        hapi A;
        hapi B;
          ...
        hapi M;
fund_deri {kusht}
```

Figura 2.3.21

Struktura përbëhet prei hapave A, B... M. Një realizim i hapave prej A deri M është një cikël. Para fillimit të çdo cikli, shqyrtohet a është plotësuar kushti (*kusht)*, i cili paraqet shprehje logjike me dy vlera: *saktë* (true) ose pasaktë (false). Derisa është plotësuar (saktë) kushti, realizohen hapat prej ciklit dhe veprimi kthehet në fillim të ciklit.

Kur te ndonjë shqyrtim të kushtit, do të konstatohet se ai nuk është plotësuar (nuk është i saktë), kapërcehet struktura kontrolluese dhe veprimi vazhdon me hapin vijues ose me strukturën kontrolluese algoritmike vijuese **fund_deri** {kusht}.

Pasi *kusht* shqyrtohet para fillimit të çdo cikli, mund të ndodh *kushti* të mos jetë plotësuar qysh gjatë shqyrtimit të parë dhe poashtu, ë*shtë e mundshme të mos realizohet asnjë cikël.*

Paraqitja grafike e strukturës kontrolluese algoritmike dhënë te ***deri–realizo është figura 2.3.22***.

Për realizimin e strukturës kontrolluese algoritmike pa **deri–realizo**, në C++ shfrytëzohet urdhri kontrollues while. Shënimi i tij është dhënë te ***figura 2.3.23.***

```
while(kusht)
        hapi A;
        hapi B;
        ...
        hapi M;
}
```

Figura 2.3.23

Për urdhrin kontrollues while vlen se nëse *kushti* nuk është plotësuar para ciklit të parë, atëherë urdhri while nuk realizohet asnjëherë.



Figura 2.3.22

Shembuj

Shembulli 2.3.9

Me shfrytëzimin e strukturës kontrolluese algoritmike **deri–realizo**, algoritmi për detyrën për gjetjen e shumës së 10 numrave të parë natyror prej nëntitullit paraprak, do të jetë si te ***figura 2.3.24***, por program i shkruar me urdhrin while është dhënë te ***figura 2.3.25***.

algoritëm *ShumaDeri10*
fillimi
shuma ← 0;
numër ← 1;
deri numër ≤ 10 **realizo**
shuma← shuma + numër;
numër ← numër + 1;
fund_deri {numër ≤ 10}
shtyp shuma
fund {*ShumaDeri10*}

Figura 2.3.24

```
1   #include <iostream>
2   using namespace std;
3
4   int main() {     // Shuma e 10 numrave të parë natyror  (me while)
5
6       int numër, shuma;
7      shuma = 0;
8      numër = 1;
9       while(numër <= 10 ) {
10         shuma =shuma+ numër;
11         numër =numër + 1;
12      }
13      cout << " Shuma e 10 numrave të parë natyror është " <<shuma<< endl;
14
15      cout << endl;
16      system( "Color 17" );
17      system( "pause" );
18      return 0;
19  }
```

Figura 2.3.25

Një dalje prej realizimit të programit është:

```
Shuma e 10 numrave të parë natyror është 55
Press any key to continue . . .
```

Shembulli 2.3.10
Të njehsohet sa para kemi shpenzuar në treg.

Pasi është e nevojshme të dimë sa prodhime kemi blerë, për çdo prodhim do të futim sasinë e shumës që e kemi paguar. Për në fund futja, duhet të vendosim ndonjë kontrollë. E dimë se për çdo prodhim kemi paguar shumë të caktuar, që është numër pozitiv. Prandaj, në fund të futjes do t futim ndonjë numër i cili nuk mund të paraqet sasi të paguar për ndonjë prodhim. Për shembull, për sasinë do të futim –1, –99 ose 9 999 (e vogël është gjasa të kemi paguar saktë këtë sasi për ndonjë prodhim) dhe të ngjashme. Kontrolli i këtillë i përsëritjes me ndonjë vlerë përpara të njohur quhet *përsëritje kontrollim me roje* (angl. Sentinel-Controlled Repetition).

Program ii shprehr me urdhrin while, është dhënë te ***figura 2.3.26.***

```
1   #include <iostream>
2   using namespace std;
3
4   int main() {
5       // Treg  (me while)
6
7       double  sasiELlogarisë, gjithsejShpenzim   = 0:
8       cout << " Për në fund, fut sasinë e llogarisë -99" << endl;
9       cout << "\nFutni sasinë e llogarië së parë";
10      cin >> sasiELlogarisë ;
11      while(  sasiELlogarisë != -99 ) {
12          sasiELlogarisë += gjithsejShpenzim ;
13          cout << " Futni sasinë e llogarisë vijuese ";
14          cin >> sasiELlogarisë ;
15      }
16      cout << "\nGjithsej është shpenzuăr<< gjithsejShpenzim  << " denarë " << endl;
17
18      cout << endl;
19      system( "Color 17" );
20      system( "pause" );
21      return 0;
22  }
```

Figura 2.3.26

Pas realizimit të programit, fitohet:



Ushtrime

Ushtrimi 2.3.4

Të gjendet gabimi në segmentin programor vijues:

```
float x = 5, suma = 0;
while(x >= 0)
	suma = suma + x;
```

Ushtrimi 2.3.5

Të konstatohet çka do të shtypet pas realizimit të segmentit programor vijues:

```
int i = 0;
while(i < 5) {
	i = i + 2;
	cout << i << "\n";
}
```

Ushtrimi 2.3.7

Çka shtyp program vijues?

```
#include <iostream>
using namespace std;

int main() {
	int n, s = 0, i = 1;
	double x;
	cout << "Futni numrin natyror:"; cin >> n;
	while(i <= n) {
		cout << "Futni numrin dhjetor:"; cin >> x;
		s += x;
		i++;
	}
	cout << "s = " << s << endl;
	return 0;
}
```

Detyra të zgjidhura

Detyra 2.3.3
Të konstatohet sa shifra ka ndonjë numër natyror.

Sqarim: Le të jetë dhënë numri n = 174.
Nëse n (= 174) e pjesëtojmë me 1, herësi do të jetë 17, por mbetja 4.
Herësin do t'ia shoqërojmë te n (n = 17).
Nëse n (= 17) e pjesëtojmë me 1, herësi do të jetë 1, por mbetja 7.
Herësin do t'ia shoqërojmë te n (n = 1).
Nëse n (= 1) e pjesëtojmë me 1, herësi do të jetë , por mbetja 1.
Herësin do t'ia shoqërojmë te n (n =).
Vërejmë se mund të formojmë cikël me dy veprime:

- Pjesëtimi i n me 10.
- Shoqërimi i herësit të fituar te n.

Përsëritje ndërpritet kur mbetja prej pjesëtimit do të jetë 0 (n = 0).
Me këtë mënyrë humbet vler fillestare (e future) e n.
Nëse është nevojshme edhe pas realzimit të algoritmit të shfrytëzohet vlera fillestare e n, është e nevojshme pas futjes të mbahet mend te ndryshorja tjetër.

```
#include <iostream>
using namespace std;

int main() {
    // Numri i shifrave të numrit të plotë (me while)

    int numriPlotë, numriShifra, herës;
    cout << "Futni numër të plotë, n=";
    cin >> numriPlotë;
    cout << "Numrit të plotë" <<numriPlotë<< " ka ";
        herës = numriPlotë / 10;
    numriShifra = 1;
    while( herës != 0 ) {
      numriPlotë = herës ;
           herës = numriPlotë / 10;
       numriShifra ++;
    }
    cout << numriShifra << " shifra." << endl;

    cout << endl;
    system( "Color 17" );
    system( "pause" );
    return 0;
}
```

Figura 2.3.27

Pas realizimit të programit, fitohet:

```
Futni numër natyror   n=2123456789
Numri natyror 2123456789 ka 10 shifra

Press any key to continue . . .
```

Detyra 2.3.4

Të gjendet pjesëtuesi më i madh i përbashkët për dy numra natyrorë.

Sqarim: Pjesëtuesi më i madhi përbashkët (PMP) për dy numra natyrorë mund të jetë më i vogli prej tyre nëse numrat plotpjesëtohen me pjesëtuesin e përbashkët (PMP) për dy numra natyrorë mund të jetë më i vogli prej tyre nëse numrat plotpjesëtohen njëri me tjetrin ose numri i parë më i vogël prej më të voglit, me të cilin plotpjesëtohen të dy numrat. Prandaj, supozojmë se PMP është më i vogli prej tyre, por nëse nuk është, atëherë e zvogëlojmë PMP për 1 në çdo cikël deri sa nuk gjejmë numër me të cilin plotpjesëtohen të dy numrat e dhënë.

```
1   #include <iostream>
2   using namespace std;
3
4   int main() {
5       // PMP u dy nurave    (me while)
6
7       int a, b,pmp;
8       cout << "Futni dy numra natyrorë" << endl;
9       cout << "a = "; cin >> a;
10      cout << "b = "; cin >> b;
11      if( a < b )
12          pmp=a ;
13      else
14          pmp=b ;
15      while( ( a % pmp != 0 ) || ( b % pmp != 0 ) )
16        pmp --;
17      cout <<"Pjesëtuesi më i madhi përbashkët për numrat"
12      cout << "Ky vit është " << kyVit << ",por vjet ishte" << vjet<< endl;
13       funksionilm ();
14      // Deri te ndryshorja 'vitiArdhshëm'  nuk ka qasje në main()
15      // pasi është lokale në funksioniIm
16
17      cout << endl;
18      system( "Color 17" );
19      system( "pause" );
20      return 0;
21  }
22
23  void funksioniIm ()  {
24      int vitiArdhshëm = 2021;; // Ndryshore lokale
25      cout << "\n\tShtyp prej funksionit kryesor funksioniIm" << endl;
26      cout << " Ky vit është   " <<  kyVit      << ", por vitin e ardhshëm "
27          <<vitiArdhshëm << endl;
28      int vitiArdhshëm = 2030;
29      cout << " Prej këtu deri në fund funksionit  ndryshorja globale  'kyVit' "
30          << "\n është mbuluar me ndryshoren lokale 'kyVit' " << endl;
```

Figura 2.5.23

```
31      cout << "Këtë vit është " <<  kyVit  << "por vitin e ardhshëm eshtë "
32          <<vitiArdhshëm << endl;
33
34      cout << "Megjithatë, qasja deri te ndryshorja e mbuluar globale      'kyVit '  "
35          << "\nnuk mund me operatorin ::" << "\nKëtë vit është "
36          << ::kyVit << endl;
37      //  deri te ndryshorja 'vjet' nuk ka qasje prej funksionilm()
38      //  pasi është lokale te main()
39  }
```

Figura 2.5.23 (vazhdim)

Te shembulli, ndryshorja globale kyVit me vlerë 2020 është mbuluar (fshehur) te funksioniIm() pasi është përsëri e deklaruar si ndryshore lokale me vlerë 2030. E gjithë kjo është e qartë prej daljes së programit:

```
          Shtyp prej funksionit krysor main ()
Ky vit është 2020, por vjet ishte 2019

          Shtyp prej funksionit funksionilm ()
Ky vit është 2020, por viti ardhshëm është 2021
Prej këtu deri në fund të funksionit ndryshorja globale, 'kyVit'
është mbuluar me ndryshoren lokale, 'kyVit'
Ky vit është 2030, por viti ardhshëm është 2021
Megjithatë, qasja deri te ndryshoria e mbuluar globale 'kyVit'
është i mundshëm me operatorin ::
Ky vit është 2020

Press any key to continue . . .
```

Është interesante se ndryshorja globale kyVit(= 2020), që është mbuluar te funksioni funksioniIm() me ndryshoren lokale me të njëjtin emër kyVit(= 2030), i qaset me të ashtuquajturën **operator për zgjidhjen e fushës së dukshmërisë** (angl. scope resolution operator), shenja e të cilit është **::**.

Koha e krijimit të një ndryshore te memoria (menjëherë pas realizmit të urdhrit për deklarim) deri te zhdukja (fundi i bllokut, fundi i funksionit ose fundi i programit) quhet **jeta e ndryshores** (angl. lifetime).

Ndryshoret globale jetojnë gjithë kohën deri sa realizohet aplikimi.

Ndryshoret lokale jetojnë prej momentit të krijimit deri në fund të fushës së dukshmërisë, që mund të jetë gjithë funksioni ose vetëm blloku ndërmjet dy kllapave {}.

Mund të vendoset n këto rregulla për fushën e dukshmërisë së ndryshoreve:

- Ndryshoret lokale nuk mund të shfrytëzojnë jashtë prej fushës së dukshmërisë.
- Ndryshoret globale mund të shfrytëzohen në gjithë aplikimin
- Ndryshoret të deklaruara në një bllok (funksioni, trupi i urdhrit – for, while, do-while) mund të shfrytëzohen vetëm te ai.

- Ndryshorja e deklaruar në një funksion nuk mund të shfrytëzohet në funksion tjetër.
- Ndryshorja mund të jetë e fshehur në ndonjë pjesë prej fushës së saj të dukshmërisë nëse te ajo pjesë është deklaruar përsëri me emrin e njëjtë.
- Dy funksione me emrin e njëjtë mund të kenë fushë të njëjtë të dukshmërisë vetëm nëse kanë lista të ndryshme të argumenteve.

Ndryshoret statike

Ndryshoret mund të jenë edhe **statike** (angl. statik). Ato deklarohen me fjalën **statik.**

Për shembull:

```
static int numri = 7;
static double sasia;
sasia = 123.45;
```

Ndryshoret statike lokale qëndrojnë sikurse ndryshoret globale. Ato jetojnë prej deklarimit të tyre deri në mbarimin e aplikimit.

Poashtu, inicializohen vetëm njëherë gjatë deklarimit ose gjatë shoqërimit vlerë në thirrjen e parë të funksionit te i cili janë ndryshoret lokale. Pas realizimit të funksionit te i cili janë deklaruar edhe kthimi i veprimit te thirrësi (në main() ose tjetër funksion), ndryshoret statike lokale e ruajnë vlerën e fituar, d.m.th., nuk zhduken si ndryshore jo statike lokale. Gjatë çdo thirrje vijuese të funksionit, e kanë gjendjen (vlerën) e fituar te thirrja paraprake.

Ndryshoret globale dhe ndryshoret statike lokale fillojnë të jetojnë me realizimin e parë të përkufizimit të tyre.

Shembulli 2.5.8

Te aplikimi prej ***figura 2.5.24***, funksioni f() thirret 5 herë.

Te thirrja e parë e funksionitf(), ndryshorja statike fillimi inicializohet në vlerën 0, ndryshorja jo statike numëruesi i vlerës 100. Me urdhërat për inkrementimin, ato fitojnë vlerë 1 dhe 101.

Gjatë thirrjes së dytë të funksionit f(), ndryshorja statike fillimi nuk incicializohet përsëri (edhe pse realizohet urdhri për deklarim dhe inicializim), por (pasi është statike) e ruan vlerën 1 prej thirrjes së parë të funksionit. Prandaj, me urdhrin për inkriminim, fiton vlerë 2. Ndryshorja jo statike numëruesi përsëri inicializohet në vlerën 100 dhe pastaj inkrementohet në 101.

E njëjta përsëritet gjatë çdo thirrje të funksionit f(). Kjo do të thotë se ndryshorja statike numërues inicializohet vetëm një here (gjatë thirrjes së parë të funksionit f()) dhe jeton si ndryshore globale deri në mbarimin e aplikimit.

```
1   #include <iostream>
2   using namespace std;
3
4   void f();
5
6   int main() {
7       for( int k = 1; k <= 5; k++ )
8           f();
9
10      cout << endl;
11      system( "Color 17" );
12      system( "pause" );
13      return 0;
14  }
15
16  void f() {
17      static int fillimi = 0; // fillimi është ndryshore statike
18      int numërues = 100;
19
20      fillim += 1;
21      numërues += 1;
22      cout << "fillim =" <<fillim << " brojac=" <<numërues<< endl;
23  }
```

Figura 2.5.24

Dalja prej realizimit të aplikimit është:

```
fillimi   =1 numërrues=101
fillimi   =2 numërrues=101
fillimi   =3 numërrues=101
fillimi   =4 numërrues=101
fillimi   =5 numërrues=101

Press any key to continue . . .
```

Nëse ndryshorj numërues nuk është statike, atëherë dalja do të jetë:

```
fillimi   =1 numërrues=101
fillimi   =1 numërrues=101
fillimi   =1 numërrues=101
fillimi   =1 numërrues=101
fillimi   =1 numërrues=101

Press any key to continue . . .
```

Shfrytëzimi i ndryshoreve globale dhe statike duhet të jetë e kujdesshme pasi ato janë të qasura në të gjitha funksionet e aplikimit. Është e mundshme të vjen deri te ndryshimi i përmbajtjes së tyre të nj funksioni, port e tjetri ai të shkakton gabim.

Funksionet e integruara

Gjatë realizimit të një aplikimi, për të gjitha funksionet te ai bëhet nga një kopje te mmemoria. Është e njohur dr realizimi i çdo aplikimi fillon me funksionin main(). Nëse te ai thirret tjetër funksion, atëherë veprimi ndërpritet te vend ii thirrjes dhe kapërcen te lokacioni i memories ku gjendet funksioni i thirrur. Pas realizimit të tij, veprimi kthehet në main() dhe vazhdon me urdhrin vijues pas urdhrit për thirrje të funksionit.

Ky mekanizëm për thirrje të funksionit dhe kthimi te thirrësi (i cili mund të jetë edhe tjetër funksion përveç main()), kërkon kohë të caktuar për realizim. Në rastin kur funksioni i thirrur është i vogël, mund të ndodh koha e thirrjes së funksionit dhe kthimi prej atij të jetë më i madh prej kohës së realizimit të vet funksionit. Humbja e kohës është më e shprehur nëse funksioni i vogël thirret më shpesh, për shembull, te urdhri për përsëritje.

Në rastet e këtilla, më praktike është funksioni të integrohet në kodin e thirrësit (për shembull në main()) gjatë përkthimit të tij. (Përmendëm se funksionet e bibliotekës në C++ janë integruar funksionet).

Për këtë qëllim, në C++ shfrytëzohet kualifikatori **inline,** i cili vendohet para përkufizimit të funksionit për t'i treguar përkthyesit ta integron te programet të cilët e thirrin, në vendet te të cilët thirren.

Shembulli 2.5.9

Te program te ***figura 2.5.25*** funksioni luanBonus() është i vogël dhe realizohet shumë herë, prandaj mund të kualifikohet si funksion i integruar.

```
1   #include <iostream>
2   #include <string>
3   #include <ctime>
4   using namespace std;
5
6   inline int luanBonis ( string emriDheMbiemri) {
7       srand( time( 0 ) );
8       int bonus = 1 + rand() % 100;
9       return bonus;
10  }
11
12  int main() {
13      string emriDheMbiemri ;
14      for( int i = 1; i <= 3; i++ ) {
15          cout << "Futni emrin dhe mbiemrin tuaj";
16          getline( cin,emriDheMbiemri);
```

Figura 2.5.25

```
17          cout << "\t I nderuar " << emriDheMbiemri
18              << " bonusi juaj për këtë lojë është "
19              << igraBonus(emriDheMbiemri ) << endl;
20      }
21
22      cout << endl;
23      system( "Color 17" );
24      system( "pause" );
25      return 0;
26  }
```

Figura 2.5.25(vazhdim)

Një dalje prej programit është:

```
Futni emrin dhe mbiemrin tuaj:Aleksandar Makedonski
        I nderuar Aleksandar Makedonski bonusi juaj për këtë lojë është 41
Futni emrin dhe mbiemrin tuaj:Car Samoil
        I nderuar Car Samoil bonusi juaj për këtë lojë është 67
Futni emrin dhe mbiemrin tuaj:Goce Delçev
        I nderuar Goce Delçev bonusi juaj për këtë lojë është 90
Press any key to continue . . .
```

Detyra për ushtrime

Të shkruhen të gjitha aplikimet dhe funksionet n për këto detyra:

1. Të njehsohet shuma $S_n = a_1 + (a_1 + a_2) + (a_1 + a_2 + a_3) + ... + (a_1 + a_2 + ... + a_n)$. Të shfrytëzohet funksioni për njehsimin e shumës $S_k = a_1 + a_2 + ... + a_k$.
2. Të njehsohet shuma $S_n = \frac{1}{1!} + \frac{1}{2!} + \frac{1}{3!} + \frac{1}{4!} + \cdots + \frac{1}{n!}$ e shfrytëzimin e funksionit për njehsimin k!.
3. Të shkruhen funksionet e veçanta për njehsimin e numrit dhe të shumës së shifrave të numrit natyror n.
4. Të gjenden numrat e thjeshtë më të vegjël se n. Të shkruhen funksionet për caktimin ndonjë numër natyror a është i thjeshtë ose jo.
5. Të shkruhet funksioni i llojit void për konversionin e numrit real dekad në binar.
6. Të shkruhet funksioni i llojit void për zgjidhjen e barazimit katror $ax^2 + bx + c = 0$.
7. Të shkruhet funksioni i llojit void për gjetjen e shënimit binar, oktal dhe heksadhjetor të numrit dekad n.
8. Të shkruhet funksioni i llojit void për gjetjen e numrit më të madh dhe më të vogël të cilët mund të formojnë prej shifrave numrin natyror n.

9. Të gjenden të gjithë numrat treshifror të cilët janë të barabartë me shumën e faktorielëve të shifrave të tij. Për njehsimin e faktorielëve të shifrave, të shfrytëzohet funksioni i veçantë.
10. Të gjenden të gjithë numrat miqësor në intervalin m deri në n. (Për dy numra themi se janë numra miqësor nëse shuma e pjesëtuesve të numrit të parë është i barabartë me numrin e dytë, por shuma e pjesëtuesve të numrit të dytë është e barabartë me numrin e parë). Për shumën e pjesëtuesve të numrit të shkruhet funksion i veçantë.

Pyetje për kontroll të njohurive

1. Si quhet biblioteka me funksioneve në C++?
2. Përmend ndonjë heder-datotekë prej bibliotekës së C++.
3. Çka duhet të kyçet te program nëse duam të shfrytëzojmë funksion prej ndonjë hder-datoteke?
4. Në cilën bibliotekë të C++ gjenden funsionet për lexim të të dhënave të future nëpërmjet tastaturës?
5. Me cilin funksion të bibliotekës njehsohet x^n, por me cilën $\sqrt{x}$?
6. Cili është funksioni në C++ për gjenerimin e numrit të rastit?
7. Me cilin funksion shndërrohen të gjitha shkronjat prej një fjale në të mëdha?
8. Me cilin funksion kontrollohet ndonjë shenjë a është shifër, por me cilën a është shkronjë?
9. Me cilin operator caktohet madhësia e memories që e zen ndonjë ndryshore?
10. Cila është përparësia e të shkruarit të pjesve të algoritmeve te nënalgoritmet?
11. Si mund të jenë nënalgoritmet? Cila është karakteristika kryesore e tyre?
12. Si thirren nënalgoritmet funksionale, por si proceduralet?
13. Çka do të thotë
    ktheje ←100;
    nëse është shkruar në nënalgoritëm funksional?
14. Çfarë lloje të funksioneve ekzistojnë në C++, sipas asaj a kthejnë një ose më shumë vlera?
15. Shkruani formën e përgjithshme të përkufizimit të funksionit me vlerë kthyse.
16. Si kryhet deklarimi i funksionit me vlerë kthyese? Shkruani formën e përgjithshme.
17. Çfarë është lloj i funksionit?
18. Cili është roli i prototipit funksional?
19. Prej çka përbëhet nënshkrimi funksional?
20. Funksionet të përkufizuara para funksionit main() a duhet të përmendet prototipi funksional?
21. Përmend disa shembuj të prototipit funksional.
22. Përmend disa shembuj të nënshkrimit funksional.

23. Në çfarë mënyrash mund të thirren funksionet me vlerë kthyese?
24. Çka do të ndodh nëse numri i argumenteve te thirrja e funksionit me vlerë kthyese është i ndryshëm prej numrit të parametrave te përkufizimi i funksionit?
25. Çka ndodh nëse lloj i ndonjë argument te thirrja nuk bënë pjesë me llojin e prametrit përkatës te përkufizimi i funksionit?
26. Ku është gabimi te këto segment programor:

```
int f(void) {

   cout << "Thirrje e funksionit f()";
   int g(void) {
          cout << "Thirrje e funksionit ()";
   }
}
```

27. Shkruani funksion me vlerë kthyese e cila për futjen e anës e njehson vëllimin e kubit.
28. A mund funksioni me vleë kthyese të thirret në urdhër për shtypje cout?
29. Çfarë parametra mund të kenë funksionet pe vlerë kthyese?
30. Prej cilit lloj janë funksionet në C++ cilët nuk kthejnë vlerë?
31. Funksionet pa vlerë kthyese a mund ta përmbajnë urdhrin return?
32. Në çfarë mënyra mund të kryhet thirrja e funksioneve me vleë kthyese, por me cilët funksione pa vlerë kthyese?
33. Sqaro se si barten në funksion argumentet sipas vlerës, por si sipas referencës.
34. Si shënohen parametrat e referencës?
35. Te prototipi i funksionit pa vlerë kthyese patjetër të shënohen parametrat referent?
36. Cili është ndryshimi ndërmjet argumentit të bartur sipas referencës dhe parametrit referent përkatës?
37. Funksioni a mund të ketë parametra referente?
38. Në cilat raste shfrytëzohen funksionet me vlerë kthyese, por në cilat funksione pa vlerë kthyese?
39. Ku është gabimi te ky funksion pa vlerë kthyese?

```
void P(int a) {

   int b;
   b = a++;
   return b;
}
```

40. Çka do të ndodh nëse përpiqemi ta ndryshojmë vlerën e parametrit konstant te funksioni?
41. A mund një funksion të thirr tjetër funksion?
42. A mund te një funksion të përkufizohet tjetër funksion?

43. Çfarë janë ndryshoret globale, kurse çka janë lokale?
44. Cila është fusha e dukshmërisë së ndryshoreve globale, por cila e ndryshoreve lokale?
45. Çfarë ndryshore janë emrat e funksioneve në një aplikim, globale ose lokale?
46. Cila është fusha e dukshmërisë së parametrave të funksionit?
47. Sqaro si mund ndonjë ndryshore globale të fshihet (të mos jetë e qasur) te ndonjë funksion? A ka mënyrë, megjithatë, të shikohet?
48. Çfarë është jeta e ndryshores?
49. Cili është ndryshimi në sjelljen e ndryshores globale dhe të ndryshores statike?
50. Me cilën fjalë shënohen funksionet e integruara?

Detyra

Të zgjidhen të gjithë shembujt dhe detyrat prej pikës **2.3 Struktura kontrolluese algoritmike për pëesëritje dhe urdhëra kontrollues për përsëritje**, me shfrytëzimin e funksioneve.

Për këto detyra të shkruhen programe me shfrytëzimin e funksioneve:

1. Të gjenden sa ka shkronja të mëdha, shkronja të vogla dhe shenja të interpuksionit te një fjali.
2. Të shndërrohen koordinatat e Dekartit në pikë (x, y) në polare (ρ, φ), sipas formulave: $\rho = \sqrt{x^2 + y^2}$, $\varphi = arctg\,\frac{y}{x}$.
3. Të gjendet PMP për dy numra.
4. Të gjendet ekuivalenti binary i numrit të plotë dekad negativ.
5. Të shkruhet funksioni me të cilin do të futen n numra dhe të gjendet numri më i vogël dhe më i madh prej tyre.
6. Të gjendet numri i thjeshtë më i madh dhe më i vogël prej numri natyror të dhënë n.
7. Të shkruhet funksioni për mbledhje të dy kohërave, të shprehura nëpërmjet orëve (0 – 23), minuta (0 – 59) dhe sekonda (0 – 59).
8. Të shkruhet funksion të llojit void për njehsimin e moshës së njeriut (ndryshimi prej dates së sotshme të lindjes). Datat të futen si ndryshore numra të plotë: dita (1 – 31), muaj (1 – 12), viti (1– 2345).

Termine

- **Struktura kontrolluese (menaxhuese) algoritmike** shërbejnë për kontrollë të realizimit të algoritmit.
- **Struktura kontrolluese algoritmike rendore** ose **sekuenca** është strukture algoritmike te e cila hapat realizohen sipas asaj renditje sipas të cilës janë përmendur.
- Struktura kontrolluese algoritmike rendore quhet **fillim–fund.**
- **Struktura kontrolluese algoritmike për zgjedhje prej dy bashkësive** është struktura për zgjedhje të njërës prej dy kaheve të mundshme të vazhdimit të veprimit në algoritëm, varësisht prej ndonjë kushti (shprehje logjike).
- **Bllok algoritmik** është bllok prej më shumë hapave të shënuara me fjalët **fillim** dhe **fund.**
- **nëse–atëherë–ndryshe** është strukturë kontrolluese algoritmike për zgjedhje prej dy mundësive.

∇ **nëse–atëherë** është strukturë kontrolluese algoritmike për zgjedhje prej dy mundësive, ku njra prej mundësive nuk ka hap realizues.

∇ **if** është urdhër kontrollues në C++ për realizimin e strukturës kontrolluese algoritmike **nëse–atëherë.**

∇ **if-else** është urdhër kontrollues në C++ për realizimin e strukturës kontrolluese algoritmike nëse–atëherë–ndryshe.

∇ **?:** quhet operator i kushtëzuar.

∇ **Struktura kontrolluese algoritmike për zgjedhje prej më shumë mundësive** është struktura te e cila kryhet zgjedhje e njërit prej më shumë rasteve të mundshme të vazhdimit të veprimit në algoritëm, varësisht prej vlerës së ndonjë datoteke ose të ndonjë shprehje aritmetike.

∇ **rasti** është strukturë kontrolluese algoritmike për zgjedhje prej më shumë mundësive.

∇ **switch** është urdhër kontrollues në C++ për realizimin e strukturës kontrolluese algoritmike për zgjedhje prej më shumë mundësive **rast.**

∇ **Cikël** është një realizim i grupit të hapave algoritmik.

∇ **Përsëritja ciklike** është realizimi i grupit të njëjtë të hapave algoritmike shumë herëshe.

∇ **për–deri–hap** është strukturë kontrolluese algoritmike te e cila ciklet numërohen prej vlerës së fillimit deri në fund me sasi të hapit.

∇ Nëse te struktura kontrolluese algoritmike **për–deri–hap** sasia është +1, struktura quhet **për–zmadho–deri.**

∇ Nëse te struktura kontrolluese algoritmike **për–deri–hap** sasia është –1, struktura quhet **për–zvogëlo–deri**.

∇ **for** është urdhër kontrollues në C++ për realizimi e strukturave kontrolluese për–zmadho–deri, për–zvogëlo–deri dhe për–deri–hap, me inkrementim të

numëruesit sipas 1, dekrementimi i numëruesit sipas 1 dhe zmadhimi/ zvogëlimi i numëruesit për sasi të caktuar.

- ++ është operator për inkrementim.
- – – është operator për dekrementim.
- **deri–realizo** është strukturë kontrolluese algoritmike te e cila përsëritja e cikleve kryhet deri sa është plotësuar ndonjë kusht, i cili shqyrtohet para fillimit të çdo cikli.
- **while** është urdhër kontrollues në C++ për realizimi e strukturës kontrolluese algoritmike deri–realizo.
- **realizo–deri** është strukturë kontrolluese algoritmike te e cila përsëritje e cikleve kryhet deri sa është plotësuar ndonjë kusht, që shqyrtohet në fund prej çdo cikli.
- **do-while** është urdhër kontrollues në C++ për realizimin e strukturës kontrolluese algoritmike realizo–deri.
- **vazhdo** është strukturë kontrolluese algoritmike për kapërcim në fund të ciklit dhe vazhdimi me ciklin vijues.
- **continue** është urdhër kontrollues në C++ për realizimin e strukturës kontrolluese algoritmike **vazhdo.**
- **ndërprerje** është strukturë kontrolluese algoritmike për kapërcim në fund të strukturës kontrolluese dhe ndërpritja e përsëritjes.
- **break** është urdhër kontrollues në C++ për realizimin e strukturës kontrolluese algoritmike **ndërprerje.**
- **dalje** është strukturë kontrolluese algoritmike për kapërcim në fund të algoritmit.
- **exit**() është urdhër kontrollues në (funksion) në C++ për realizimin e strukturës kontrolluese algoritmike **dalje.**
- **kapërcim** është strukturë kontrolluese algoritmike për kapërcim të çfarëdo hapi te algoritmi.
  goto është urdhër kontrollues në C++ për realizimin e strukturës kontrolluese algoritmike kapërcim.
- **Biblioteka standard** e C++ është biblioteka e cila përmban funksione matematikore, funksione për hyrje dhe dalje, për operacione me shenja, me stringe etj.
- **Funksione me vlerë kthyese** janë ato funksione të cilat pas realizimit kthejnë vlerë në vendin prej ku janë thirrur.
- **Funksione pa vlerë kthyese** janë ato funksione të cilat pas realizimit kthejnë vlerë në vendin prej ku janë thirrur.
- **Programimi prej lart poshtë** është teknika e zbërthimit të detyrës në detyra më të thjeshta, të quajtura **nëndetyra.**
- **Programimi modular** është teknika për përpunimin e programeve (moduleve) për nëndetyrat dhe realizimi i tyre sekuenciale.
- **Nënalgoritme** është algoritëm i cili nuk mund të realizon (sipas kodimit) në mënyrë të pavarur.

- **Nënalgoritmet funksionale** të quajtura edhe **funksione** kanë vetëm *një rezultat dalës*.
- **Nënalgoritmet procedurale** të quajtura edhe **procedura** kanë *më shumë rezultate dalëse*.

- **Parametra (argumente formale**) shfrytëzohen te përkufizimi i nënalgoritmeve.
- Argumente (argument të vërteta) janë ndryshore të cilat shfrytëzohen gjatë thirrjes së nënalgoritmeve.
- **Parametrat hyrëse (argument formale hyrëse)** janë ato nëpërmjet të cilëve barten vlerat prej thirrësit (algoritëm ose nënalgoritëm) te nënalgoritmet. Ato shënohen me shenjën ↓.
- **Parametra dalës (argument formale dalëse)** janë ato nëpërmjet të cilëve barten vlerat prej nënalgoritmit deri te thirrësi (algoritëm ose nënalgoritëm). Ato shënohen me shenjën ↑.
- **Parametra hyrëse-dalëse (argument formale hyrëse-dalëse**) janë ato nëpërmjet të cilëve barten vlerat prej thirrësit (algoritëm ose nënalgoritëm) në nënalgoritëm dhe e kundërta. Ato shënohen me shenjën ↕.
- **kthej** është hapi me të cilin kthehet rezultati prej nënalgoritmit funksional.
- **Lista e parametrave** është lista e titullit të përkufizimit të nënalgoritmeve.
- **Lista e argumenteve është lista te thirrja e nënalgoritmit.**
- **Nënprogrami funksional** i quajtur **funksion** është program te gjuha programore e shkruar për nënalgoritmin funksionale.
- **Funksione të përkufizuara shërbyese** ose vetëm **funksion shërbyes** janë funksione të shkruara prej programuesve
- **Përkufizimi i funksionit** në C++ përbëhet prej titullit (i cili përbëhet prej llojit tëvlerë kthyese, emri i funksionit dhe lista e parametrave) dhe trupi (në kllapa tëmëdha).
- **Deklarimi i funksionit** me vlerë kthyese në C++ përbëhet prej llojit (të vlerës kthyese), emri (i funksionit) dhe lista e parametrave.
- **Prototip funksional** quhet deklarimi i funksionit, por përbëhet prej llojit, emri dhe lista e parametrave.
- **Nënshkrimi funksional** përbëhet prej emrit të funksionit dhe liste e parametrave.
- **Parametrat konstant** janë ato vlerat e të cilave nuk mund të ndryshojnë te funksioni.
- **void** është lloj i funksionit në C++ të cilët nuk kthejnë vlerë.
- **Argumentet e bartura sipas** vlerës janë ato të cilët nuk barten te funksioni me thirrje, por vlera e tyre te thirrësi (funksioni main() ose tjetër funksion) nuk ndryshon. Mekanizimi quhet bartja e argumenteve.
- **Referencimi** është shqërimi i emrit tjetër të ndryshores
- **Referenca** ose **ndryshorja referente** është tjetër emër e ndonjë ndryshore

- **Argumetet të bartur sipas referencës** janë ato të cilët barten në funksion me thirrje, ku ato janë meër tjetër të parametrave referentë përkatës. Mekanizimi quhet **bartje të argumenteve sipas referencës.**
- **Fusha e dukshmërisë** të quajtur edhe **fusha e qasjes** është ajo fushë te e cila ka qasje deri te ndryshoret, d.m.th., mund të kryejnë operacione me atë.
- **Ndryshore globale** janë ato deri te të cilat ka qasje prej gjithë aplikimit, d.m.th., prej funksionit kryesor dhe prej të gjitha funksioneve të përkufizuara shërbyese në datotekën e njëjtë te e cila është funksioni kryesor.
- **Ndryshoret lokale** janë ato të cilat kanë fushë të qasjes vetëm trupi i funkionit te e cila janë deklaruar ose vetëm titulli i funksionit ose vetëm blloku te i cili janë deklaruar.
- **Ndryshorja e fshehur** (e mbuluar me ndryshore tjetër) te ndonjë bllok ose te gjithë funksioni është ajo e cila nuk është dukshme (nuk mund të shfrytëzohet) në atë bllok ose në atë funksion.
- **::** është **operator për zgjidhje të fushës së dukshmërisë.**
- **Jeta e ndryshores** është koha prej krijimit në memorien (menjëherë pas realizimit të urdhrit për deklarim) deri te zhdukja e tij (fund ii bllokut, fund ii funksionit ose fundi i aplikimit).
- **Ndryshorja statike** është ajo e cila prej momentit të deklarimit sillet si ndryshore globle.
- **Funksion i integruar** është a ii cili përkthen së bashku me thirrësin (main() ose tjetër funksion) dhe integrohet në kodin e tij.
- **inline** është kualifikator për funksione të integruara.

Përmbledhje

- Për përshkrim të rrjedhës së algoritmeve gjatë programimit të strukturuar, shfrytëzohen të veçanta të ashtuquajtura struktura kontrolluese (menaxhuese) algoritmike me të cilat menaxhohet me renditjen e realizimit të hapave algoritmik.
- Rrjedha e çdo algoritmi mund të kontrollohet me shfrytëzimin e strukturës kontrolluese algoritmike: **rendore** ose **sekuenca, zgjedhje** ose **selektim** dhe përsëritje ose **iterim.**
- Te strukturës kontrolluese algoritmike rendore hapat realizohen sipas renditjes sikurse është përmendur. Ajo quhet **fillim–fund.**
- **nëse–atëherë–ndryshe** është struktura kontrolluese algoritmike për zgjedhje prej dy mundësive, por në C++ realizohet me urdhrin kontrollues if-else.
- **nëse–atëherë** është struktura kontrolluese algoritmike për zgjedhje prej dy mundësive nuk përmban hap realizues, por në C++ realizohet me urdhrin kontrollues if.

- Urdhërat kontrollues if dhe if-else mund të folezohen edhe në zgjedhjen if dhe në zgjedhjen else. Urdhri kontrollues i folezuar te zgjedhja else quhet if-else-if.
- Operatori i kushtëzuar?: shfrytëzohet për paraqitjen e urdhërave të zakonshëm if-else.
- Ku ka më shumë mundësi për vazhdimin e veprimit te algoritmi, shfrytëzohet struktura kontrolluese algoritmike për zgjedhje prej më shumë mundësive **rasti.**
- Zgjedhja e njërit prej mundësive kryhet, varësisht prej vlerës të ndonjë të dhëne ose të ndonjë shprehje algoritmike
- Struktura kontrolluese algoritmike për zgjedhje prej më shumë mundësive **rasti**, në C +
  realizohet me urdhrin kontrollues switch.
- Struktura kontrolluese algoritmike për përsëritje shfrytëzohet atëherë kur është e nevojshme një grup të hapave algoritmik të kryhen më shumë here, e cila quhet përsëritje ciklike. Një realizim i hapave quhet një cikël.
- Dallojmë tri struktura kontrolluese algoritmike për përsëritje, edhe atë: përsëritje me numërim të cikleve (**për–deri–hapi)**, përsëritja me dalje në fillim prej ciklit (deri–realizo) dhe përsëritja me dalje në fund prej ciklit (**realizo–deri)**.
- Te struktura kontrolluese algoritmike **për–deri–hapi**, ciklet numërohen e numërues të veçantë, me ndonjë sasi të hapit prej vlerës fillestare deri në fund.
- Nëse sasia e hapit është +1, struktura quhet **për–zmadho–deri**, nëse sasia është –1, struktura quhet **për–zvogëlo–deri.**
- Për realizimin e strukturës kontrolluese algoritmike **për–deri–hapi** (**për–zmadho–deri** dhe **për–zvogëlo–deri**), në C++ shfrytëzohet urdhri kontrollues for.
- Urdhri kontrollues for ka pjesë për inicializimin, pjesë për kusht dhe pjesë për azhurim.
- Urdhri Urdhri kontrollues for ka pjesë për inicializimin, pjesë për kusht dhe pjesë për azhurim. kontrollues for në C++ lejon inicializimin dhe azhurimin e më shumë ndryshoreve.
- Te urdhri kontrollues for pjesa për inicializim dhe azhurimin mund dtë jetë edhe e zbrazët.
- Struktura kontrolluese algoritmike **deri–realizo,** në C++ realizohet, me urdhrin kontrollues while. Deri sa është plotësuar ndonjë kusht logjik në while, ciklet realizohen, Kushti shqyrtohet para fillimit të çdo cikli.
- Me urdhrin kontrollues while mund të mos realizohet asnjë cikël nëse kushti nuk është plotësuar qysh para fillimit të ciklit të parë.
- Kontrollimi i përsëritjet me ndonjë vlerë prej përpara të njohur quhet *përsëritje e kontrolluar me roje.*

- Struktura kontrolluese algoritmike **realizo–deri,** në C++ realizohet me urdhrin kontrollues do-while. Ciklet në do-while realizohen deri sa është plotësuar ndonjë kusht logjik. Kushti shqyrtohet pas barimit të ndonjë cikli.
- Me urdhrin do-while, patjetër të kryhet të paktën një cikël.
- Gjatë folezimit të urdhërave kontrollues për përsëritje (for, while, do-while), të gjitha urdhërat e njërit urdhër kontrollues patjetër të gjendet te tjetra, përkatësisht nuk guxon të ketë prerje (mbivendosje) të urdhërave kontrollues.
- Te gjuhët programore ekzistojnë katër lloje të strukturave kontrolluese algoritmike për kapërcim, edhe atë: kapërcim në fund të ciklit – **vazhdo,** kapërcim në fund të strukutrës kontrolluese – ndërprerje, kapërcim në fund të algoritmit – **dalje dhe kapërcim të çfarëdo vendi – kapërcim.**
- Struktura kontrolluese algoritmike për kapërcim, në C++ realizohet për urdhërat kontrollues: continue, break, exit() dhe goto.
- Shmanget shfrytëzimi i urdhrit kontrollues goto në programimin e strukturuar.
- Në programimin e strukturuar shfrytëzohen dy teknika për programim, edhe atë: programim prej lart dhe programim modular. Programimi prej lart poshtë kryhet me ndarje (zbërthim) të detyrës në nëndetyra. Për çdo nëndetyrë mund të shkruhet algoritëm i veçantë, i cili quhet nënalgoritëm.
- Thelbi i nënalgoritmeve është në atë që atom und të shfrytëzohen në algoritme të ndryshme ose nënalgoritme, por edhe në shumë vende në algoritmine njëjtë dhe /ose nënalgoritëm.
- Shfrytëzimi i nënalgoritmeve është mundësuar nëpërmjet mekanizmit të parametrave (argument formal) dhe argument (argument të vërtet).
  Parametrat mund të jenë hyrës, dalës dhe hyrës-dalës.
- Sipas numrit të rezultateve dalëse, ekzistojnë dy nënalgoritme, edhe atë: nënalgoritme funksionale (të cilët kthejnë vetëm një rezultat) dhe nënalgoritme procedural (të cilët mund të kthejnë më shumë rezultate).
- Nënalgoritmet te gjuhët programore realizohen e nënprograme. Nënprogramet mund të jenë funksionale (kur kthejnë një vlerë) dhe procedural (kur kthejnë më shumë vlera).
- Nënprogramet në C++ realizohen me funksione. Nënprogramet funksionale realizohen me funksione me vlerë kthyese, por nënprogramet procedural realizohen me vlerë kthyese funksionale.
- Funksionet në C++ mund të jenë: funksione biblioteke dhe funksione të përkufizuara shërbyese.
  Gjatë përkufizimit të funksionit me vlerë kthyese në C++, duhet të dihet se:

- titulli i funksionit nuk mbaron me ; (pikëpresje),
- lista e parametrave patjetër t'i përmban edhe emrat dhe llojet e parametrave,
- vlera kthyese është rezultat prej funksionit i cili mund të jetë shprehje (prej ndryshoreve dhe/ose konstantave dhe/ose funksioneve) ose një ndryshore dhe e cila patjeër të jetë i llojit të njëjtë me llojin e funksionit. .

- Për deklarimin e funksionit në C++, duhet të dihet:
- Nëse nuk përmendet lloj i funksionit, nënkuptohet lloj int.
- Emrat e funksioneve (sipas konventës) shkruhen me shkronjë të vogël fillestare. Nëse emri përbëhet prej më shumë fjalëve çdo fjalë vijuese shkruhet me shkronjë të madhe.
- Lista e parametrave patjetër t'i përmban llojet e parametrave, por emrat jo patjetër.
- Deklarimi i funksionit mbaron me shenjën ; (pikëpresje).
- Gjatë thirrjes së funksionit, lista me argument dhe lista me parametra të funksionit patjetër të kenë:
- numër të njëjtë të argumenteve dhe parametrave,
- renditje të njëjtë të argumenteve dhe parametrave,
- të njëjtë ose lloj konvertibil të argumenteve dhe parametrave përkatës.
- Funksioni me vlerë kthyese në C++ thirret me emrin dhe lista e argumenteve ose me urdhër për shqërim ose me urdhër tjetër ose shprehje.
- Funksioni pa vlerë kthyese në C++ thirret vetëm me emrin e vet dhe lista e argumenteve.
- Funksionet të cilët janë përkufizuar sipas programit kryesor, deklarohen (duke përmendur prototipin e tyre) para funksionit kryesor main().

- Një funksion mund vetëm njëherë të përkufizohet në programin e njëjtë.
- Për t'u mbrojtur parametrat e funksionit prej ndryshimeve në arë, ato shënohen si konstante me kualifikatorin const.
- Funksionet pa vlerë kthyese në C++ kanë llojin **void.**
- Prej funksionit me vlerë kthyese dilet me urdhrin return me parametër, deri sa prej funksionit pa vlerë kthyese dilet automatikisht pas realizimit të tij ose prej çfarëdo vendi te trupi i funksionit me urhërin return pa parametër.
- Gjatë thirrjes së funksionit, shfrytëzohet mekanizmi për bartjen e argumenteve sipas vlerës ose sipas referencës.
- Gjatë bartjes së argumenteve sipas vlerës, ato nuk ndryshojnë te funksioni, m.th., ngelin të njëjtë edhe pas kthimit te thirrësi (funksioni kryesor main() ose tjetër funksion).
- Gjatë bartjes së argumenteve sipas referencës, atom und të ndryshojnë te funksioni dhe ps kthimit te thirrësi (funksioni kryesor main() ose tjetër funksion) mund të jenë të ndryshueshëm.

- Gjatë bartjes së argumenteve sipas referencës, nk krijohen ndryshore të reja për argument, por argumentet prej thirrësit paraqesin emra të tjerë të parametrave referent të funksionit. Të gjitha ndryshimet te parametrat e referencës, në realitet, kryhen mbi argumentet përkatës pasi ato janë emra të ndryshëm të lokacionit të memories së njëjtë.
- Nëse nuk duam të ndryshojë ndonjë argument te funksioni, pavarësisht a është bartur sias vlerës ose sipas referencës, duhet të shënohet si konstant me kualifikatorin const.
- Funksionet me vlerë kthyese mund të jenë argument të funksioneve të tjera.
- Ndryshoret globale janë ato të cilat janë të qasura në gjithë aplikimim dhe te funksionet të cilat thirren te ajo.
- Emrat e funksioneve të përkufizuara shfrytëzuese në një aplikim trajtohen si ndryshore globale.
- Ndryshoret lokale janë ato të cilat janë të qasura (të dukshme) dhe mund të shfrytëzohen vetëm te funksioni ose blloku në të cilin janë deklaruar.
- Dukshmëria e ndryshores lokale fillon me deklarimin e vet.
- Parametrat e funksionit trajtohen si ndryshore lokale në gjithë funksionin.
- Ndryshoret e deklaruara në një bllok funksioni, trupi i urdhrit – if, switch, for, while, do-while etj.) mund të shfrytëzohen vetëm te ati pasi janë ndryshore lokale.
- Ndryshorja e deklaruar në një funksion nuk mund të shfrytëzohet te funksioni tjetër.
- Dy funksione me ermine njëjtë mund të kenë fushë të njëjtë të dukshmërisë vetëm nëse kanë lista të ndryshme të parametrave.
- Gjatë realizimit të një aplikimi, për të gjitha funksionet bëhet nga një kopje te memoria.

MODULI

LLOJET E TË DHËNAVE TË PËRBËRA NË C++

3

Në këtë kapitull do të njiheni me këto:

- Vargjet dhe domethënia e tyre te programimi.
- Deklarimi, inicializimi dhe shoqërimii vlerave të elementev të vargut njëdimensional.
- Urdhri for i bazuar në vargun dhe shfrytëzimi i tij.
- Deklarimi, inicializimi dhe shoqërimii vlerave të elementev të vargut dydimensional.
- Njehsimi i dimensioneve të vargut dydimensional.
- Treguesë dhe rëndësia e tyre te programimi.
- Shfrytëzimi i operatorit të adresës & dhe operacioni për dereferencim *.
- Lidhja ndërmjet vargjeve dhe treguesve.
- Shfrytëzimi i urdhërave new dhe delete.
- Fuksionet për punë me stringe.
- Funksionet për konvertim të string te numri dhe për konvertimin e numrit të stringëve.

Fjalë kyçe

#define.	Konstanta e emërtuar
<string>	Operatori indirekt (operator për dereferencim)*
delete	Matricaa
new	Lista inicializuese
stoi, stol, stoll, stoul, stoull, stof, stod, stold	Urdhri for i bazuar në varg
to_string()	Vargu
Operatori i adresësë &	Tregues
Vargu dydomenzional	Ndryshorja e treguesit
Vargu njëdimensonal	Konstanta simbolike
Vargu njëdimensonal	

3.1 Vargjet njëdimensionale

Ekzistojnë provleme për zgjidhjen e të cilave është e nevojshme të futet numër i madhi ndryshoreve. Për shembull, për të njehsuar suksesin mesatar të një nxënësi, është nevojshme të futen notat nga të gjitha lëndët dhe për çdo note të futet nga një ndryshore numër të plotë, sikurse

nota_1 nota_2 . . . nota_n

Nëse supozojmë se ka 12 lëndë, janë të nevojshme 12 ndryshore për notat e një nxënësi. Nëse në klasë ka 30 nxënës, atëherë janë të nevojshme 12 x 30 = 360 ndryshore për notat e të gjithë nxënësve. Programi me kaq numër të ndryshoreve jo vetëm që është e pa shqyrtuar por do të jetë shumë e gjatë. Gjatë të shkruarit e tij, shumë kohë do të shpenzohet për të shkruar emrat e ndryshoreve se sa për vet aplikimin.

Në rastet e këtilla, kur punohet me numër të madh të të dhënave të llojit të njëjtë, ato organizohen në struktura të veçanta rë quajtura **vargje** (angl. arrays). Elementet e vargut mund të jenë i cilit do lloj, por të gjitha elementet patjetër të jenë të llojit të njëjtë. Për shembull, të gjitha notat e nxënësve te vargu i emërtuar me nota, te shembulli i përmendur, patjetër të jenë të llojit numër i plotë.

Çdo element te vargu ka numrin e tij rendor. Për shembull, te vargu nota, emrat e elementeve janë: nota_1, nota_2… nota_n. Ato dallohen vetëm sipas numrave rendor 1, 2, 3... n. Madhësitë e këtilla në matematikës shkruhen në atë mënyrë që numrat rendor vendohen si indekse: nota1, nota2... notan. Indeksi e paraqet numrin rendor të elementeve te vargu: 1 – elementi i parë, 2 – elementi i dytë etj. n e paraqe elementi n.

Të përkujtohemi për vargjet aritmetike he gjeometrike. Vargu a_1, a_2... a_n quhet varg aritmetik nëse ndryshimi i çfarëdo dy elementeve fqinje është i njëjtë, port e vargu gjeometrik herësy i çfarëdo dy elementeve fqinje është i njëjtë. Gjithashtu, vërejmë se të gjithë elementet kanë emrin e njëjtë, por indeksat i kanë 1, 2, 3... n.

Indeksat mund të hënohen si pika në boshtin numerik, d.m.th., në një drejtim, një dimension. Gjatësia është një dimension. Syprina (drejtkëndëshit) ka gjatësi dhe gjerësi, domethënë dy dienzione. Hapësira (ndërtesa) ka tre dimensione: gjatësia, gjerësia dhe lartësia.



Prandaj, vargjet me një indeks (një dimension) quhen **vargje njëdimensionale** (angl. one dimensional arrays).

Nëse e dimë se vargu ka n elemente, atëherë shkruhet me: a_1, a_2... a_n. Ose, shkurt me $a[_i]_n$ ose vetëm me $a[]_n$, që do të thotë se indeksi i ka vlerë prej 1 deri n. Shfrytëzohet edhe shenja vijuese $[a]_n$, ku me n shënohet se vargu është njëdimensional sge se indeksat prej 1 deri n. Në literaturl shfrytëzohet edhe shënimi a[1..n]. Shënimin e fundit do ta shfrytëzojmë te algoeiret.

Në gjuhët programore, ndryshoret që fitojnë vlera të të hënave prej vargut njëdimensional shkruhen në atë mënyrë që indeksi vendohet në kllapa tmesme: a[1], a[2]... a[n] ose nota[1], nota[2]... nota[n]. Edhe pse emri i të gjitha elementeve është i njëjtë, ato janë ndryshore të ndryshme të cilat dallohen sipas indeksit.

Te shumë gjuhë programore indekset fillojnë prej 0 deri te n – 1. Vargjet teo C++ shënohen në të njëjtën mënyrë, ku indekset janë numra të plotë jonegativ, por indeksi i parë gjithmonë është 0. Për vargun prej n elementeve, indekset janë 0, 1, 2, 3... n – 1. Për shembull, për vargun prej n elementeve, shenja është a[]n, por elementet janë: a[0], a[1]... a[n – 1]. Nëse duam ta shënojmë vetëm vargun, pa numrin e elementeve, atëherë do të shfrytëzojmë shënimin a[] për të dalluar prej ndryshores me emrin e njëjtë.

Deklarimi i vargjeve njëdimensional

Vargjet njëdimensionale si ndryshore në C++ deklarohen në këtë mënyrë

```
lloj emri[numër];
```

lloj – është lloj i elementeve të vargut (short, int, long, long long, float, double, char, boolean, string etj.). emri – është emri i vargut.
emri – është emri i vargut.
numër – është numri i elementeve të vargut dhe ai patjetër të jetë literal ose konstante e emërtuar më e madhe se 0.

Shembuj

Shembulli 3.1.1

```
int a[5];
```

Vargu a[] ka 5 elemente dhe atë: a[0], a[1], a[2], a[3] dhe a[4]. Lloj i elementeve të vargut është int dhe te ato mund t'u shoqëroj vetëm vlera numra të plotë.

Shembulli 3.1.2

```
float br[25];
```

float nr[25]; Vargu nr[] është i llojit float dhe ka 25 elemente. Elementi i përgjithshëm k shënohet me nr[k], por indeksi k mund të ketë vlera 0, 1... 24. Domethënë elementet janë: nr[0], nr[1]... nr[24].

Shembulli 3.1.3

```
string embri[15], mbiemri[30];
```

Deklarohen dy vargje emri[] dhe mbiemri[] elementet e të cilit mund të kenë vlera vetëm stringa.

Shembulli 3.1.4

```
const int NUMRIELEMENTEVE = 100;
char c[NUMRIELEMENTEVE];
```

Te shembulli, numri i elementeve të vargut c[] është paraprakisht i dhënë si konstante e emërtuar (angl. named konstant), të quajtur edhe ndryshorja konstante (angl. konstant variable), `NUMRIELEMENTEVE`.

Kjo mënyrë e dhënies së numrit të elementeve shfrytëzohet më së shpeshti pasi konstanta e emërtuar inicilizohet njëherë dhe nuk mund të ndryshojë më tej te aplikimi.

Shembulli 3.1.5

```
int k = 10;
float u[k];
```

Kjo deklaratë është e gabuar pasi numri i elementeve patjetër të jetë konstante.

Për të shënuar elementin specifik të vargut, i japim emrin e vargut dhe pozitën e atij elementi te vargu.Te ***tabela 3.1*** është dhënë vargu numër të plotë me emrin d. Ky varg përbëhet prej 10 elementeve. Deri te çdonjëri prej këtyre elementeve mund të qaset nëpërmjet emrit të vargut dhe indeksit të vendosur në kllapa të mesme

Kështu, elementii i parë është d[0], por elementi i është d[i – 1].

0 është indeks i elementit të parë të vargut

Element	Vlera e elementit
d[0]	–567
d[1]	8
d[2]	9
d[3]	72
d[4]	345
d[5]	–78
d[6]	78
d[7]	9
d[8]	10
d[9]	987

9 është indeks i elementit të fundit të vargut. d[9] 987

Tabela3.1.1

Indeksi i elementit të vargut mund të jetë konstanta, ndryshorja ose shprehja vlera e të cilës është jonegative dhe te vargu i indekseve prej 0 deri n – 1 (nëse gjatësia e vargut është n). Kështu, për a = 7 dhe b = 2 elementi d[a + b – 1] është, në realitet,

```
d[a + b - 1]
```

elementi d[8].

Inicializimi i vargut dhe shoqërimi i vlerave të elementeve

Elementeve të vargut mund t'u shoqërohen vlera me urdhër për shoqërim ose gjatë inicializimit.

Te shembujt vijues janë ilustruar mënyra të ndryshme të shoqërimit vlera të elementeve të vargut..

Shembulli 3.1.6

Shoqërimi i vlerave mund të kryhet veçanërisht çdo elementi

```
int a[10];
a[0] = 1; a[9] = 10; a[3] = -4; a[5] = 5;
```

Shembulli 3.1.7

Shoqërimi i vlerave mund të kryhet edhe nëpërmjet shprehjeve te të cilat njehsohet vlera e indekseve të vargut. Për shembull, nëse elementi a[5] = 24, me urdhërat:

```
int c = 3;
int d = 2;
a[c + d] += 6;
```

të elementit a[5] i zmadhohet vlera për 6, d.m.th., vlera e tij tani do të jetë 30

Shembulli 3.1.8

Shoqërimi i vlerave të elementeve të vargut mund të kryhet edhe gjatë deklarimit, d.m.th., me ***listë të inicializimit*** (angl. initializer list):

```
 int a[] = {5, -2, 7, -3, 6};
```

Vlerat e elementeve do të jenë: a[0] = 5, a[1] = –2, a[2] = 7, a[3] = –3, a[4] = 6. Gjatësia e vargut (numri i elementeve) gjatë inicializimit të këtillë e cakton vet përkthyesi.

Pas deklarimit dhe inicializimit të vargut

```
char shkronja[] = {'a', 'b', 'c'};
```

vlerat e elementeve do të jenë: a[0] = 'a', a[1] = 'b', a[2] = 'c'.

Shembulli 3.1.9

Nëse ka më pak vlera te lista e inicializimit se sa që ka elemente te vargu, elementet e të tjera janë inicializuar në zero.

Me këtë deklarim dhe inicializim

```
int disa[10] = {3, -1, 4};
```

elementet e vargut do të inicializohen me këto vlera: : 3, –1, 4, 0, 0, 0, 0, 0, 0, 0. Zerot i plotëson përkthyesi.

Ngjashëm, me

```
int zero[100] = {};
```

deklarohet vargu prej elementeve numra të plotë me emrin zero, ku të gjitha elementet janë inicializuar në 0.

Me deklarimin dhe inicializimin

```
char zanore[5] = {'a'};
```

në mënyrë eksplicite vlera 'a' e elementit zero prej vargut, por të gjitha elementet e të tjera automatikisht janë inicializuar në vendet e zbrazëta.

Vërejtje: Te C++ nuk ka inicializim automatik të vargjeve. Patjetër të paktën një element të jetë i inicializuar, që pastaj të gjithë elementet tjerë të jenë të inicializuar.

Shembulli 3.1.10

Dimensioni i vargut mund të njehsohet automatikisht nëse elementet janë dhënë gjatë inicializimit. Gjatë kësaj deklarate dhe inicializimi

```
double këto[] = {2.34, -5.67, 3.45, 7.89};
```

nuk është dhënë gjatësia e vargut, por e cakton përkthyesi, sipas numrit të dhënë të elementeve, d.m.th., vargu këto do të ketë gjatësi 4.

Ngjashëm, me deklarimin dhe inicializimin

```
string ditë[] = {"Hën", ""Mar", "Mër", "Ent", "Pre", "Sht", "Die"};
```

gjatësia e vargut ditët është 7.

Me deklaratën vijuese dhe inicializuese

```
int shifra[] = {1, 2, 3, 4, 5};
```

janë deklaruar vargu me gjatësi 5 dhe janë inicializuar të gjitha elementet.

Nga ana tjetër, me këtë deklarim dhe inicializim të vargut

```
int v[5] = {1, 2, 4, 5, 6, 9};
```

paraqitet sintaksa e gabimit pasi ka 6 vlera të inicializuara, por vargu mund të ketë më së shumti 5 elemente.

Shembulli 3.1.11

Vargjet nuk mund:

- të shoqëron njëri tjetrës:

```
int a[2] = {1,2};
int b[2];
b = a;                          // pasaktë
```

- të inicializohet njëra me tjetrën:

```
int c[2] = a;                   // pasaktë
```

- të shtypen vetëm nëpërmjet :

```
cout [1]<< a;                   // pasaktë
```

- të krahasohen[2]:

```
if(a == b)                      // pasaktë
```

- tëmjenë vlera kthyese prej funksionit[3].

```
return a;                       pasaktë
```

[1] Shtypen adresat e vargut.
[2] Krahasohen adresat e vargjeve.
[3] Kthehet treguesi ni vargut. Për treguesit do të fklasim më vonë.

Specifikimi i gjatësisë së vargut mund të kryhet edhe me **konstante simbolike.** Konstanta simbolike jepet me direktivën paraprocesore #**define**.

Për shembull:

```
#define PI 3.1415;
```

Shembulli 3.1.12

Në këtë shembull shfrytëzohet direktiva paraprocesore #define, me të cilën përkufizohet konstanta simbolike GJATËSIA vlera e të cilës është 10, **figura 3.1.1.**

Programi i inicializon dy elementet e para të vargut me vlerë 1, por të tjerat me 0. Me urdhrin for, elementeve prej të tretit deri te i dhjeti u shoqërohen vlera sipas formulës. (Cila?).

```
1   #include <iostream>
2   #include <iomanip>
3   using namespace std;
4
5   #define GJATËSI 10
6
7   int main() {     // Shfrytëzimi i konstantes simbolike
8
9       int z[GJATËSI ] = { 1, 1 };// Inicializimi i dy elementeve të para me 1,
10                                 //  por të tjerët me 0
11
12      // Shoqërimi i vlerave të elementeve prej të tretit deri te i dhjeti
13      int j;
14      for( j = 2; j < GJATËSI ; j++ )
15          z[ j ] = z[ j - 2 ] + z[ j - 1 ];
16
17      // Shtypja e vargut në mënyrë tabelare
18      cout << setw( 10 ) << "Element" << setw( 10 ) << "Vlera" << endl;
19      for( j = 2; j <GJATËSI ; j++ )
20          cout << setw( 6 ) << "z[" << j << "]" << setw( 8 ) << z[ j ] << endl;
21
22      cout << endl;
23      system( "Color 17" );
24      system( "pause" );
25      return 0;
26  }
```

Figura 3.1.1

Dalja pas realizimit të programit është:

```
   Element      Vlera
     z[0]         1
     z[1]         1
     z[2]         2
     z[3]         3
     z[4]         5
     z[5]         8
     z[6]        13
     z[7]        21
     z[8]        34
     z[9]        55

Press any key to continue . . .
```

Shembulli 3.1.13

Segmenti programor për lexim të elementeve të vargut me numra të plotë prej n elementeve $a[]_n$ e:

```
for(int i = 0; i < n; i++)
       cin >> a[i];
```

Shembulli 3.1.14

Segmenti programor për lexim të elementeve të vargut $b[]_n$ është:

```
for(int i = 0; i < n; i++)
       cout << a[i] << endl;
```

Shembulli 3.1.15

Segmenti programor për gjetjen e shumës së elementeve të vargut prej n elementeve $c[]_n$ është: :

```
shuma = 0;
for(int i = 0; i < n; i++)
       shuma += c[i];
```

I njëjti segment programor mund të shfrytëzohet edhe për njehsimin e prodhimit të elementeve të vargut, vetëm duhet të ndryshojnë urdhërat:

```
shuma = 0;          me     prodhim = 1;
